

**DARIO BETANCOURT**

*Vij të të shëroj:*

**NGRIHU DHE EC**

**Sherbesa e shërimit**

Titulli i origjinalit  
**Dario Betancourt – VENGO A SANAR**

Copyright:  
Publicaciones Kerygma – Mexico  
Apartado 113-106  
03300 Mexico, D. F. MEXICO

Përktheu nga italishtja:  
m. Svetlana Rezo FDC, teologe e diplomuar,  
me fra Eduard Pretashin

Lektoroi:  
Gjon Mirdita

Sponzori:  
Famulija- Virje

Biblioteka:  
BURIMI I JETES

## **Parathënie**

Ja libri i cili rrëmbyeshëm dhe qartë na shpie në misterin e “shërbesës së shërimit”. Jezusi në ndarje nga të vetët... në mënyrë solemne, ju urrdhëroi nxënësve të vet: “Dilni në mbarë botën e predikoni Ungjillin të gjithë njerëzve. Kush do të besojë e do të pagëzohet, do të shëlohet... Shenjat që do t’i përcjellin ata që do të besojnë, janë këto: në emer tim do t’i debojnë djajtë, do të flasin gjuhë të reja; në (duar) do t’i marrin gjarpërinjtë e nëse do të pijnë ndonjë send që sjell vdekjen, nuk do t’u bëjë keq. Do t’i vënë duart mbi të sëmurë, e këta do të shërohen.” (Mk 16, 15-18; Lk 10, 8. 9; Mt 10, 7. 8). Të gjithë jemi nxënësit e pagëzuar të Jezusit. Neve, të gjithëve na është dhënë kjo detyrë:

**TA SHPALLIM UNGJILLIN E SHPËTIMIT TË JEZUSIT DHE TË SHËROJMË VETEN DHE TË TJERËT!**

Ky libër është doracak sistematik i aftësisë më të rëndësishme: shërimi i shpirtit dhe i trupit me anë të mësimin të Jezusit, me anë të dashurisë së tij dhe dashurisë sonë dhe me angazhimin tonë të përzemërt dhe kujdesin e pandërprerë, se si vëllau ynë njeri, të bëhet i përsosur; ti ndihmohet njeriut i cili është i sëmurë, si pasojë e mëkatit të parë dhe atij personal.

Është e vërtetë e pamohueshme se JEZUSI SHËRON! Me anë të këtij ”recepti” (libri) do të shërojë, qetësojë, gëzojë shpirtin dhe trupin e njeriut

sepse ai nuk është i krijuar për dhëmbje dhe vuajtje por për gëzim e lumturi, ashtu si na sugjeron Bibla në shumë vende (krah. Zan 2).

Pasiqë Jezusi më ka shëruar edhe mua nga asmen, e përktheva këtë libër me bashkpunëtorët e mi në gjuhën shqipe që edhe këto anë t'i shijojnë frytet e kishës së përgjithshme.

Kur ati Dario ishte në Zagreb, i tregova se e kemi përkthyer këtë libër, gjë që e gëzojë pamasë dhe menjëherë me zemërgjërësi e dha të drejtën autoriale që të botohet. Për këtë i jam shumë mirënjohëse.

Kështu duke ju falënderuar Kishës kroate ky libër e shëh dritën për të mirë të Kishës Shqipëtare. Të gjithë e lavdërojmë Zotin për veprat e mrrekullueshme që i bën nëpërmes të të zgjedhurve të vet! Libri nuk do të shitet sepse është dhuratë, por do të ndahet nëpër bibliotekat rreglltare dhe famullitare prej nga mund ta marrin besimtarët. Shfrytëzoj rastin që edhe njëherë t'i falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët të cilët kanë punuar vullnetarisht dhe pa pagesë në këtë libër. Le t'ua shpërblejë Zoti të gjithëve njëqindfish me bekimin e tij dhe me gëzimin se me punën e tyre e kanë pasuruar popullin e vet.

Glaviçicë 13. 12. 2003

M. Svjetlana Rezo FDC

## HYRJE

Jetojmë në kohën e privilegjuar të Shpirtit Shenjt, në të cilën përsëriten mrekullitë e Rrëshajëve të para. Hyji e ka shtrirë dorën e vet të fuqishme dhe jep shenja e bën mrekulli. Ne jemi dëshmitarë dhe në këto faqe dëshirojmë të dëshmojmë se fuqia e tij nuk është shteruar dhe se as e djathta e tij e fuqishme nuk është tërhequr.

Jezusi ka ardhur për t'i shëruar të sëmurët dhe tani e vazhdon këtë veprimtari, sepse Ai është i njëjti dje, sot dhe gjithmonë.

Të gjitha ngjarjet e përmendura këtu, i emërtojmë si “bekime”. Nuk do të shërbehemi me fjalën “shërime”, ashtu që të mos polemizojmë me mjekët, të cilët, nganjëherë, na quajnë “shërues”, sepse gjithkund shohim shërime. Aq më pak dëshirojmë të shërbehemi me fjalën “mrekulli”, që të mos nxisim kritikën e meshtarëve dhe ipeshkvijve, të cilët, nganjëherë, konsiderojnë se jemi naivë, sepse dukurinë më të thjeshtë e quajmë mrekulli. Mendojmë se termi “bekim” i karakterizon në mënyrë të përshtatshme të dy termet.

Bekimet e tilla hyjnore kanë ekzistuar qysh në fillim të Kishës, kurse gjatë historisë së Kishës, në numër më të madh paraqiten në disa vende, si p. sh.: në Lurd, Fatime, shenjtëroren Guadalupe në Meksikë etj. Kjo shërbesë, për të cilën mendohej se është e lidhur për disa vende dhe shenjtërore, sot po

zgjerohet me të madhe në tërë Kishën dhe në të gjitha anët e botës.

Papa Pali VI, më 16 tetor 1974, thekson rolin e karizmës në ungjillëzim: “Do të thoja se kureshtja, e cila është shumë e mirë dhe e arsyeshme, përqendrohet në një aspekt tjetër. Kur vjen Shpirti Shenjt, Ai ndan dhuratat. Tani në i njohim shtatë dhuratë e Shpirtit Shenjt. Por Ai ndan edhe dhurata tjera, të cilat quhen dhe gjithmonë janë quajtur karizma. Ç’është karizma? është – dhuratë, hir! Këto janë hire të posaçme, që u jepen disa njerëzve, e që këta t’ua bëjnë ndonjë të mirë të tjerëve. Njëri pranon dhuratën e urtësisë që të bëhet mësues, kurse tjetri pranon dhuratën e mrekullive që të realizojë vepra të mrekullueshme të cilat ftojnë në fe etj.

Kjo trajtë e dhuratave karizmatike, që nuk janë të merituar, e që rrjedhin nga bollëku i Provanisë Hyjnore, ashtu që Kisha të jetë më e pasur, më e gjallë dhe më e aftë, që të mbrojë dhe të dëshmojë, quhet ‘derrdhje shiu e karizmave’. Edhe sot flitet shumë për këtë. Duke e marrë parasysh ndërlikshmërinë dhe ndijshmërinë e çështjes, mundemi vetëm të shprehim dëshirën që këto dhunti të vijnë, dhe atë, shpresojmë, me shumicë. Që pranë hireve të ketë edhe karizma, të cilat Kisha e Zotit edhe sot mund t’i ketë dhe t’i përfitojë.

Hyji na ka dërguar këtë shiu dhuratash, të themi kështu, që ta trimërojë Kishën, që të ngritet, që të forcohet dhe të mbahet. Pastaj, ndarja e këtyre dhuratave ka qenë, do të thoja, më modeste, më ekonomike. Por, gjithmonë ka pasur shenjtër që kanë bërë mrekullira, njerëz të jashtëzakonshëm, të cilët

gjithmonë kanë ekzistuar në Kishë.

I shumëzofte Hyji dhurata e karizmave, ashtu që ta bëjë Kishën më të frytshme, më të bukur dhe më të aftë, që të vëhet në dukje dhe që të tërheq vëmendjen e njerëzimit, i cili është profanizuar.”

Kjo dëshirë e Papës, siç po shohim, po plotësohet në të gjitha anët.

Që kur jam shuguruar meshtar, kam ardhur në përfundim se Zoti shëron në fusha të ndryshme të jetës njerëzore. Prandaj, kur u njoftova me ripërtëritjen karizmatike, nuk e kam pasur vështirë për të pranuar mendimin se Zoti shëron, sepse këtë e kam përjetuar që nga vitet e para të meshtarisë.

Dr. Villiam Parker, në librin e vet “Lutja në psikoterapi”, shkruan kështu:

“Një mjek i famshëm, profesor i Etikës sociale në Shkollën e Mjekësisë, në Harvard, shprehimisht thotë se 75 % të punës që e bëjnë mjekët, do të mund ta bënin edhe meshtarët. Shumë mjekë ‘internistë’, mendojnë se 50-75 % të pacientëve që kërkojnë ndihmë mjekësore, nuk vuajnë fizikisht. Në këto rrethana, shërimi vetëm i lehtëson simptomat. Shërimi i përhershëm dhe solid në fushën e mjekësisë psikosomatike përfshin shërimin e njeriut në tërësi: trupit fizike, mentale dhe shpirtrore.”

Në këtë libër dëshiroj, që përmes dëshmimeve të mia, të flas për fuqinë e Zotit dhe të jap disa këshilla, ashtu që lexuesi të mësojë që të lutet më me sukses për shërim të brendshëm dhe fizikë të personave që vuajnë nga ndonjë sëmundje.

Dëshmoj për atë që kam parë, dëgjuar dhe prekur. Mbase, shumë raste që i përmendi mund të kenë edhe

shpjegim tjetër, por, unë këtë e bëj i shndritur me fe, çka lexuesi edhe vetë mund ta vërejë.

Më duhet t'u falënderohem të gjithë njerëzve që më kanë trimëruar që ta shkruaj këtë libër, e që më kanë ndihmuar me përvojën e tyre: misionares laike Blanka Ruiz, e cila me karizmën e madhe të shërimit të brendshëm më ka sugjeruar me shumë mendime për këtë libër; vëllezërve të mi, meshtarëve Salvador Carillo-s dhe Diego Jaramillo-s, të cilët më kanë ndihmuar në pjesën teologjike. Falënderim të posaçëm u shprehi Pepa Medina-s dhe Cecilia Munoz, për orët e shumëta që i kanë kaluar duke e përkrahur dorëshkrimin. Falemnderit Jose H. Prado Flores-it për ndihmë në redaktimin përfundimtar. Mbi të gjitha i falënderohem Zotit, që më ka ndihmuar që të shoh daljen e kësaj vepre në dritë, në lavdi të emrit të tij.

Në disa raste i kam ndryshuar emrat e personave për shkak të diskrecionit të arsyeshëm dhe dashurisë. Nga ana tjetër, i kam ndarë temat, që flasin për Marinë dhe sakramentet, burimet e shëndetit, për të cilat shkruaj në librin tjetër, me titull "Burimet e shëndetit".

Çdo gjë që është shkruar në këtë libër, ia nënshtroj gjyqit të Kishës.

Nev York, 6 gusht 1985  
Shndërrimi i Jezu Krishtit



## KAPTIULLI I.

# ZOTI DËSHIRON QË TË JEMI TË SHËNDOSHË

Ka shumë të krishterë në botë, që janë plotësisht të bindur se Zoti dëshiron që të jenë të sëmurë dhe të pikëlluar. Ata e ngatërrojnë vullnetin e Zotit me atë që Ai shfrytëzon për lavdinë e vet. Sëmundja nuk është vullneti i tij. Mund të vërtetohet qartë se Jezusi, në asnjë çast, nuk i ka shtytë njerëzit në sëmundje, e as në vuajtje, që të përmbushet vullneti i Zotit.

Vullneti i Zotit është që të gjithë të jemi të shëndoshë me trup fizikë, mentale dhe në shpirt. Pra, të kërkosh shërim, nuk do të thotë se me lutje e kundërshton vullnetin e Zotit. Po të ishte kështu, atëherë, përse t'i drejtohem mjekut dhe të marrim barëra?

Nëse vullneti i Zotit është i tillë, që ta shëronë ndonjë person, atëherë, nuk është i kuptueshëm ekzistimi i barnave dhe mjekëve, kurse puna e tyre do të ishte e pakuptimë – punë kundër planit të Hyjit.

Me të përmbushurit e kohës, Ati e dërgon Birin në tokë, që t'i shpëtojë të gjithë njerëzit. “Ti ngjitja emrin Jezus, sepse Ai do ta shëlbojë popullin e vet prej mëkateve të tija” (Mt 1, 21). Emri Jezus do të thotë “Shëlbues”, “shpëtim”. Ai është dërguar mu për këtë,

për të liruar dhe shëruar. Engjujt kanë paralajmëruar: “Sot ju lindi Shëlbuesi” (Lk 2, 11).

Jezusi, i vetëdijshëm për misionin shëlbues të vetin, erdhi në Nazaret, hyri në sinagogë dhe u ngrit për ta lexuar Shkrimin. Ia dhanë librin e Isaisë profet dhe kur e hapi, gjeti vendin ku shkruan:

“Shpirti i Zotit është mbi mua  
sepse Ai më shuguroi!  
Ai më dërgoi t’u kumtoj të vobektëve  
Ungjillin, t’u shpall robërve çlirimin,  
të verbërve dritën e syve;  
t’i lëshojë në liri të ndrydhurit” (Lk 4, 16-19).

Në këtë fragment, Jezusi e paraqet programin e vet të “Lajmëtarit të gëzimit”, porsì politikani që e paraqet planin e vet, të cilin dëshiron ta realizojë gjatë mandatit të vet. Në planin e tij paraqiten katër caqe, të cilat dëshiron t’i realizojë:

- të lirojë dhe shërojë nga mëkati: “Më ka shuguruar që të jem çlirues i të shtypurve”;

-të lirojë dhe shërojë nga sëmundjet shpirtrore: frika, urrejtja, brejtja e ndërgegjes dhe kompleksët: “t’i shëroj zemrat e pikëlluara”;

- të lirojë dhe shërojë nga dhembjet fizike: “t’u kthej dritën e syve të verbërve”;

-të shërojë dhe të lirojë nga ndikimet e djallit, djallosurve: “për t’u dhënë lirinë të shtypurve”.

## 1. Besëlidhja e vjetër

Nëse Jezusi, profeti i Atit, dëfton dhe kumton shërimin e plotë të njeriut, do të thotë se qysh në Besëlidhjen e vjetër, Hyji e ka shëruar popullin e vet. Kjo gjë mund të shihet edhe në rreshtetat që vijojnë, ku paraqiten katër lloje të shërimit.

“Unë jam Zoti, Shëruesi yt” (Dal 15, 26). Citat: “Nëse do ta dëgjosh zërin e Zotit, Hyjit tënd, dhe, nëse do të bësh atë që është e drejtë para syve të tij, nëse do t’i degjosh urdharat e tij dhe do t’u mbahesh të gjitha vendimeve të tij, nuk do të kap as një sëmundje që ua leshova Egjiptianëve: sepse unë jam Zoti, Shëruesi yt.”

Hyji, sikurse i ka thënë Mojsiut: “Unë jam ai që jam”, këtu shprehimisht thotë: “Unë jam ai që shëron”, porsi të jetë esenca e Zotit shërimi, sepse shërimi është sinonim i shpëtimit.

“Ai i shëron zemrat e copëtuara, i lidh plagët e tyre” (Ps 147, 3).

“E pra, Ai i mori mbi vete vuajtjet tona, mbi shpatulla të veta i ngarkoi dhimbjet tona! E ne ishim të bindur se ishte i ndëshkuar, i munduar prej Hyjit e i nënçmuar! Kurse Ai ishte i plagosur për shkak të paudhërive tona, i ndrydhur për shkak të fajeve tona; ndëshkimi, peng paqeje për ne, peshoi mbi Të: me plagën e Tij ne u shëruam” (Is 53, 4-6).

“Do t’ua shëroj pabesnikërinë, do t’i dua me gjithë zemër, me bujari, ” (Oz 14, 5).

Rreshte tjera, tejet të pasura, që do të ishte mirë të lexohen, janë: Dal 23, 25; Lp 7, 15; Nr 21, 9; Jb 5, 18; Ps 107, 6-20; Jer 30, 17; 33, 6; Oz 6, 1; 7, 1.

Posaçërisht kreu 38 i Librit të Siracidit është shumë i pasur me mësim praktikë.

### ***Përfundim***

Nga vështrimi i përgjithshëm i teksteve të Besëlidhjes së vjetër, mund të përfundojmë, pa kurrfarë dyshimi, se Zoti dëshiron që të jemi të shëndoshë dhe se në këto tekste dallohen katër lloje të shërimit.

## **Besëlidhja e re**

Sikurse ka shumë raste ku Jezusi shëron individë, ka edhe shumë të tjera ku shihet qartë dëshira e tij për të shëruar çdo njeri dhe të gjithë njerëzit. Jezusi ka shpenzuar shumë kohë në shërimin e trupit dhe shpirtit.

### ***Jezusi shëron nga mëkati***

“Mirë, pra, unë dua t’jua vërtetoj se Biri i njeriut ka pushtet të falë mëkatet mbi tokë – atëherë i tha të paralizuarit – Po të urdhëroj: çohu, merre vigun tënd dhe shko në shtëpi tënde!” (Lk 5, 24).

Jezusi e zbulon shpesh hyjninë e vet, në rend të parë me faljen e mëkateve, e kjo është një lloj si edhe shërimi nga mëkati:

“Atëherë i tha gruas: ‘Të janë falur mëkatet!’” (Lk 7, 48).

Mëkatarja publike ka dashur shumë, ashtu që edhe i është falur shumë. Iniciativa nuk nisët nga njeriu, por nga Zoti i cili jep mëshirë. Shën Augustini

e vërteton këtë kur thotë se fariseut nuk ka mundur t'i falet shumë, sepse e ka konsideruar veten të drejtë. Për dallim nga mëkatarja, ai ka menduar se ka mëkatuar pak dhe prandaj, natyrisht, nuk ka mundur të dojë shumë.

### ***Jezusi shëron përbrenda***

- ***Shëron nga frika.*** Shembull i mrekullueshëm është qetësimi i stuhisë. Jezusi së pari i liron nxënësit nga mëkati, kurse pastaj e qetëson stuhinë (Mt 8, 23-27).

Meriton të ndalemi në shërimin që ua bëri apostujve, të cilët, nga frika prej hebrenjve, e mbanin derën mbyllur (Gjn 20, 19). Kur u shëruan, Pjetri ka fuqi të mbrojë Jezusin para hebrenjve, të cilët haptas i qortoi se ata e kanë vrarë (Vap 2, 23). Mrekullueshëm është të shikohet Pjetri, i cili, tani guximshëm, trimërisht dëshmon, ndërsa më parë ka qenë i dobët dhe i pafuqishëm të bëjë këtë gjë përpara një gruaje dhe tre herë e mohoi (Gjn 18, 17).

Nikodemi frikësohej nga të tjerët. Pozita e tij publike, nuk e lejonte që të deklarohet haptas për Jezusin; prandaj e ka vizituar natën (Gjn 3, 2). Por, është shëruar nga frika dhe është trimëruar, e madje e ka mbrojtur Jezusin para kryepriiftërinjëve (Gjn 7, 50-51). Më vonë, madje pati guximin të kërkojë nga Pilati trupin e vdekur të Mikut të Kryqëzuar – për ta varrosur (Gjn 19, 39-40).

- ***Shëron nga urrejtja.*** Midis hebrenjve dhe samaritanëve mbretëronte urrejtja racore deri në atë masë sa që as nuk kanë folur ndër vete. Jezusi erdhi te pusi i Jakobit dhe e takoi samaritanen. Kur ajo kuptoi

se Jezusi është hebre, e qortoi për atë se ky ka guxim për të biseduar me të. Por, Jezusi, edhe më tej bisedoi butësisht me të dhe e shëroi saqë gruaja arriti të bahëj admiruasja e Tij. (Gjn 4).

- ***Shëron nga brejtja e ndërgjegjes.*** Kur Pjetri e mohoi Jezusin, e breu ndërgjegjja ashtu që qau thekshëm (Lk 22, 62). Jezusi e shëroi nga çdo mohim duke e nxitur që të dëftojë dashurinë tre herë (Gjn 21, 15-19).

- ***Shëron nga roberia e të hollave.*** Zakeu ishte njeri i pasur dhe kryetagrambledhës (këta konsideroheshin për mëkatarë publikë). Jezusi e shëroi nga grykësia për të holla dhe ky pastaj, ua ndau gjysmën e pasurisë skamnorëve dhe ua ktheu katërfishin atyre që u ka bërë padrejtësi. Pas shërimit të Zakeut, Jezusi tha: “Sot i erdhi kësaj shtëpie shëlbimi ... Biri i njeriut erdhi ta kërkojë e ta shëlbojë atë që pati humbur” (Lk 19, 1-10).

### ***Jezusi shëron dhembjet fizike – trupore***

Hebrenjtë, në kohën e Jezusit, nuk e kanë ndarë njeriun në shpirt dhe trup, por, qenien njerëzore e kanë vështruar si tërësi të pandashme. Prandaj, kur në Shkrimin Shenjt hasim në fjalën “shpëtim”, atë mund ta kuptojmë si “shërim”. Jezusi shëron dhe shpëton – shpirtin dhe trupin.

Përveç pjesës së lartpërmendur te Lk 4, 18, ku flitet për arsyet e ardhjes së tij, ekzistojnë edhe tekste tjera të përshtatshme: “Atë fuqia e Zotit e shtynte të shërojë” (Lk 5, 17), po ashtu edhe tjetri:

“Jezusi shkante prej një vendi në vend tjetër nëpër mbarë Galilenë, duke mësuar në sinagogat e

tyre, duke predikuar Ungjillin e Mbretërisë e duke shëruar në popull çdo sëmundje e çdo pamundësi” (Mt 4, 23).

Jezusi e ka çuar jetën e vet duke predikuar dhe duke shëruar. Nuk ka predikuar pa shëruar, e as nuk ka shëruar pa predikuar. Këto dy shërbesa i ka kryer ashtu që i ka plotësuar reciprokisht.

“Kur u bë natë i sollën shumë të djallosur. Jezusi me fuqinë e fjalës i dëboi shpirtrat dhe i shëroi të gjithë të sëmurët, që kështu të plotësohej fjala e Isaisë profet që thotë: ‘Ai i mori pamundësit tona e i mbarti sëmundjet tona, në plegët t tija ne u shëruam (Is 53, 5)’” (Mt 8, 16-17).

“Ejani tek unë të gjithë ju që jeni të lodhur prej barrës së rëndë e unë do t’ju çlodh” (Mt 11, 28).

“E populli lëshohej me shumicë për ta dëgjuar e për t’u shëruar nga sëmundjet e veta” (Lk 5, 15).

“E, nëse ndokush i dëgjon fjalët e mia e nuk i zbaton, nuk jam unë ai që e dënoj, sepse nuk erdha të dënoj botën, por ta shpëtoj botën” (Gjn 12, 47).

Në këto fragmente shohim kuptimin e ardhjes së Mësuesit – *të shërojë dhe të shpëtojë*.

Tekste tjera, të rëndësishme për shërbesën e shërimit dhe ungjillizimit të Jezusit, janë: Mt 9, 10-13; 12, 15; 14, 14; 15, 30-31; Mk 1, 32-34; 6, 55-56.

## ***Jezusi shëron nga ndikimet satanike***

Për këtë temë, më hollësisht do të flitet në kapitullin X.

Jezusi e ka ndarë shërbesën e vet të shërimit me apostujt e vet

“Jezusi i thirri rreth vetes të Dymbëdhjetët e u dha zotësi e pushtet mbi të gjithë djajtë si dhe aftësinë të shërojnë sëmundjet” (Lk 9, 1).

“Gjatë udhëtimit predikoni: ‘Mbretëria e qiellit është ngjat!’ Shëroni të sëmurit, ngjallni të vdekurit, pastroni të gërbulurit, dëboni djajtë! Falas morët, falas edhe jepni!” (Mt 10, 7-8).

Këto dy fragmente, tregojnë qartë se Zoti ua ka dorëzuar këtë fuqi dymbëdhjetë apostujve dhe kështu, në mënyrë konsekuente, atyre që janë pjesëtarë të këtij misioni, d. m. th. ipeshkvijve dhe meshtarëve. Prandaj, të gjithë shërbyesit e Kishës, me shërbesën e urdhërit meshtarak, e pranojnë fuqinë shpëtimtare të Jezu Krishtit në çdo trajtë dhe në çdo aspekt.

Dr. Villiam Parker, në librin e vet “Lutja në psikoterapi”, shkencorisht e dëshmon fuqinë e lutjes, posaçërisht të lutjes që e lutë meshtari ose ndonjë shërbyes tjetër i Kishës. Dhe, sjellë përfundimin se askush nuk ka mjet aq të çmueshëm për këtë punë, në krahasim me meshtarin ose me ndonjë shërbyes fetar.

Shën Augustini, i cili për një kohë e ka mohuar ekzistimin e kësaj shërbese, kur është emëruar ipeshkëv në Hipon, ka vërejtur se kanë ngjarë shumë shërime përmes shërbesës së tij dhe, atëherë, e ka ndërruar mendimin e vet dhe ka pohuar se shërbesa e shërimit ende ka jetë në Kishë.

Megjithëkëtë, vështirë është për t'i bindur meshtarët se shërbesa e tyre përfshin fuqinë shëruese të Jezusit. Sipas besimit të tyre ata do ta shohin lavdinë e Zotit.



Jezusi e ka ndarë shërbesën e vet të shërimit edhe me rrethin më të gjerë të nxënësve të vet.

“Pastaj Zotëria i zgjodhi edhe shtatëdhjetë e dy nxënës të tjerë dhe i dërgoi nga dy e dy, përpara vetes në çdo qytet dhe vend, ku mendonte të shkojë. U thoshte: ‘...Në çdo qytet që të hyni e t’ju pranojnë, hani çka t’ju vënë përpara. Shëroni të sëmurit që janë në të e thoni popullit: U afrua Mbretëria e Hyjit!’ ” (Lk 10, 1. 8-9).

Nxënës të Jezusit kanë qenë ata njerëz që i kanë shkuar pas dhe kanë qenë me të, por, që nuk janë përfshirë në të Dymbëdhjetët. Në këta nxënës janë të përfaqësuar të gjithë ata që besojnë në Jezu Krishtin, pra, të gjithë të pagëzuarit.

Të gjithë ne, në një mënyrë, apo në një tjetër, jemi të ftuar për ta zbatuar karizmën e shërimit. Mund të lusim të paktën një uratë për shërimin e vëllezërve tanë, ndonëse për zbatimin më të plotë të kësaj shërbese janë të ftuar vetëm disa, siç lexojmë në Letrën e parë drejtuar Korintianëve:

“... po i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fenë, një tjetri prapë, i njëjti Shpirt Shenjt, i jep dhuratën e shërimeve; ... Kështu Hyji disa në Kishë i caktoi: më parë apostujt, së dyti profetët, së treti mësuesit; pastaj vjen dhurata e mrekullive, pastaj ajo e shërimeve, e kujdesimit, e drejtimit shpirtëror, dhurata e gjuhëve të ndryshme... A thua të gjithë e kanë dhuratën e shërimeve?” (1 Kor 12, 9. 28-30).

Apostujt dhe nxënësit janë shërbyer me dhurata të shërimeve

“Ata shkuan dhe u predikuan njerëzve kthimin kah Hyji. Dëbonin shumë djaj, lyenin me vaj shumë të sëmurë dhe i shëronin” (Mk 6, 12-13).

“Të shtatëdhjetë e dy nxënësit u kthyen me gëzim e thanë: ‘Zotëri, deri edhe djajtë na nënshtrohen në Emrin tënd!’ ” (Lk 10, 17).

“Kurse ata dolën e predikuan gjithkund. Zoti bashkëpunonte me ta dhe e përforconte Fjalën me mrekulli që e përcillnin” (Mk 16, 20).

Kisha e kohëve të para ka qenë e bindur se e ka pranuar “fuqinë dhe pushtetin” e shërimit, prandaj, të krishterët kanë lutur dhe kërkuar këtë karizmë me këmbëngulja të madhe.

“E tani, o Zot, shih kërcënimin e tyre e bëj që shërbëtorët e tu ta shpallin me plot guxim Fjalën tënde! Shtrijsë dorën tënde e bëj shërime, shenja të bindshme e mrekulli me fuqinë e Emrit të Shërbëtorit tënd të shenjtë, Jezusit” (Vap 4, 29-30).

Është mirë të lexojmë ngadalë librin Veprat e Apostujve, i cili më parë do të duhej quajtur “Veprat e Shpirtit Shenjt”, ashtu që të shohim çka ka bërë Ai përmes Apostujve dhe nxënësve.

“Është ndokush ndër ju i sëmurë? Le t’i thërrasë udhëheqësit e Kishës! Ata le të luten mbi të duke e lyer me vaj në emër të Zotit dhe urata e fesë do ta shpëtojë të sëmurin dhe Zoti do ta ripërtëritë e, në qoftë se ka bërë mëkate, do t’i falen. Rrëfëni mëkatet njëri-tjetrit dhe lutuni për njëri-tjetrin që të shërohëni!” (Jak 5, 14-16).

## ***Përfundim***

Sikurse nga tekstet e Besëlidhjes së Vjetër përfundojmë se Zoti dëshiron që të jemi të shëndoshë, po ashtu, nga tekstet e Besëlidhjes së Re mund të përfundojmë se vullneti i Zotit është që të jemi të shëndoshë.

## **Mjekët**

Në ripërtëritjen karizmatike takojmë shumë persona që Zoti i shfrytëzon për shërbesën e shërimit. Këta persona e kanë pranuar dhuratat e shërimeve. Kur zbulohet kjo aftësi dhe kur e njëjta aplikohet në jetë, paraqitet shërbesa e shërimit.

Të pagëzuarit e zbatojnë dhuratën e shërimeve në mënyra të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm. E zbatojnë bashkëshortët kur lutën së bashku, etërit me bijtë etj, por, në mënyrë të veçantë, në shërbesë të shërimit janë të ftuar mjekët, sepse ata janë pjesëmarrës në këtë karizmë përmes pagëzimit shenjt, përmes dijës që e kanë marrë në universitet dhe përmes thirrjes së posaçme të Zotit që të shërojnë dhimbjen njerëzore.

Kur mjeku zbaton profesionin tyre dhe në praktikë aplikon dijen e vet medicinale, kurse dhuratat e shërimeve ia shton dhuntinë e fesë, shndërrohet në mjet të mrekullueshëm në duar të Zotit. Njoh shumë ekspertë që e jetojnë këtë dimension të ri të thirrjes së tyre dhe Zoti i bekon me të madhe. Shembull për këtë janë anëtarët e “Shoqatës së Mjekëve të Krishterë”.

Dekreti i koncillit të II të Vatikanit “Mbi urdhin

meshtarak” (“Presbyterorum ordinis”), thotë:  
“Meshtarët me frymëzimin, (shqyrtimin) e fesë:

- le të zbulojnë karizma të shumëllojshme të laikëve,

- le t’i njohin me gëzim,

- le të punojnë me zell në përparimin e tyre” (PO  
9).

Me këto udhëzime të koncillit të Vatikanit, ne meshtarët, duhet të vërejmë thirrjen, që të zbulojmë karizmat, posaçërisht dhuntinë e shërimeve, që e posedojnë personat që i kushtohen shërbimit të të sëmurëve.

## KAPITULLI II.

### VUAJTJA DHE VDEKJA

#### Vizioni i Gjon Palit II

Nëse Zoti dëshiron që të jemi të shëndoshë, atëherë, si mund ta arsyetojmë ekzistimin e tërë atyre vuajtjeve, dhembjeve, sëmundjeve dhe vdekjeve? Papa Gjon Pali II, në letrën e vet apostolike “Mbi vuajtjen shpëtimtare” (“Salvifici doloris”), e cila ka të bëjë me kuptimësinë e krishterë të vuajtjes në botë, ndeshet me këtë problem dhe i sjellë disa shpjegime. Mund të themi se papa, duke u nisur nga Libri i Jobit, vjen deri në tre përfundime:

#### *Vuajtja është ndëshkim i mëkatit*

Zoti është gjyqtar i drejtë, i cili e shpërblen të mirën, kurse e ndëshkon të keqen. Bindja e atyre që mendojnë se vuajtja është ndëshkim i mëkatit, ka mbështetje në drejtësi dhe përshtatet me thënien e një miku të Jobit: “Sa unë pashë: Kush lëron të keqen, në mbjelltë mjerim atë dhe korr” (Jb 4, 8 – krah. Vuajtja shpëtimtare 10).

#### *Vuajtja ka domethënien e provës*

Në fund të Librit të Jobit, vetë Zoti i qorton miqtë

e Jobit për shkak të akuzimeve të tyre dhe e pranon pafajësinë e Jobit. Këtu është fjala për vuajtjen e pafaj, të cilën duhet pranuar si fshehtësi, të cilën mendja e njeriut nuk mund ta kuptojë plotësisht. Nëse është e vërtetë se vuajtja e ka kuptimin e ndëshkimit, kur është bërë një me fajin, megjithatë, nuk është e vërtetë se çdo vuajtje është pasojë e mëkatit dhe se ajo e ka karakterin e ndëshkimit. Dëftimi e paraqet qartë problemin e vuajtjes së njeriut të pafajshëm.

Jobi nuk ka qenë i ndëshkuar, sepse nuk ka pasur arsye të ndëshkohet, por, ka qenë i nënshtruar nga një sprovë e rëndë. Në hyrje të librit shihet se Zoti e ka lejuar këtë sprovë, të nxitur nga ana e Satanit, i cili e ka vënë në dyshim nderin e Jobit: “Pse a thua Jobi kot e dron Hyjin?! Pse a nuk e ka rrethuar me gardh atë, shtëpinë e tij e gjithçka është e tija? Pse a nuk ia ke bekuar çdo ndërmarrje të tij dhe kështu u rrit mbi tokë pasuria e tij. Por sprovo e shtrihe njëherë pakësa dorën tënde e preke në gjithçka ka, pale a nuk do të mallkojë në fytyrë!” (Jb 1, 9-11). Nëse Zoti pranon ta sprovë Jobin me vuajtje, këtë e bën për ta sprovuar drejtësinë e tij. Vuajtja e ka domethënien e sprovës (Vuajtja shpëtimtare 11).

### ***Vuajtja është thirrje për kthim***

Libri i Jobit, në mënyrë shumë subtile, i thotë “pse” vuajtjes. Ky libër, gjithashtu thotë se vuajtjen e pëson edhe qenia e pafaj, por me këtë nuk e zgjidh problemin.

Qysh në Besëlidhjen e vjetër shihen vende, në të cilat zhvillohet mendimi se vuajtja do të ishte vetëm ndëshkim mëkati.

Në mjerimin e popullit të zgjedhur, është e pranishme thirrja për kthim: “I lus ata që do ta lexojnë këtë libër të mos i lëshojë zemra për shkak të këtyre vështirësive, por këto vuajtje t’i çmojnë jo si ndëshkim për shfarosje, por si qortim të kombit tonë” (2 Mak 6, 12).

Kështu vërtetohet dimensionin e ndëshkimit. Ndëshkimi është i kuptimtë jo për arsye se në të keqen përgjigj me të keqen tjetër, por, para së gjithash, sepse krijon një mundësi të re për të ripërtëritur të mirën në atë që vuan. Kjo pikëpamje e vuajtjes, është shumë e rëndësishme në shpalljen e Besëlidhjes së Vjetër dhe posaçërisht në atë të Besëlidhjes së Re. Vuajtja shpie kah kthimi, d. m. th. kah ripërtëritja e të mirës në personin që njoftohet me mëshirën e Zotit, në atë thirrje për pendim. Qëllimi i pendimit është mundja e të keqes, e cila në trajta të ndryshme, fshehet në njeriun dhe, forcimi i të mirës së tij, si brendësisë së vet individit, ashtu edhe të raportit të tij me të tjerët, e mbi të gjitha me Zotin (Vuajtja shpëtimtare 12).

Derisa isha në Argjentinë, në një mbledhje me mjekë, një prej tyre më pyeti: “Bija ime, katër vjeçe, vuan nga astma bronkiale kronike. Si mund të jetë që unë, specialist për organe të frymëmarrjes, nuk mund t’i ndihmoj, kurse shumë të tjerëve u kam ndihmuar?” Kur e pyeta në besim mjekun: “A është mbarësuar ajo vajzë me dashuri?” Më përgjigji: “Po!” Por, bashkëshortja menjëherë shtoi: “Jo! Më kujtohet se nuk e kemi dashur dhe se madje, kemi menduar në abort!”

Duke biseduar me vajzën, e pyetëm:

- *A është e vërtetë se babai dhe nëna të duan shumë?*

- *Jo! Ata nuk më duan!*

Në atë çast, prindërit e saj kuptuan se fëmija është i vetëdijshëm se nuk është i pranuar. I këshillova që ta praktikojnë “terapinë me dashuri” (sjellje të përmbushura me dashuri) si ilaç shërues.

Disa muaj më vonë, mora letër prej këtyre mjekëve, me të cilën më lajmëruan se bija e tyre është shëruar.

### **Shërimi me dashuri (terapia me dashuri)**

Ky trajtim shërues duhet t’ia mundësojë personit tjetër që ta ndiejë dashurinë tonë. D. m. th. , duhet të shërbehemi me shenja dhe me gjeste, të cilat përçojnë dashurinë. P. sh.: me përqaftim, me puthje, me shtrirje të dorës etj. , e të gjitha këto të jenë të përshkuara me një ndjeshmëri, e cila mund ta tronditë dhe ta prekë personin.

“Përshëndetni njëri-tjetrin me puthje vëllazërore!” (1 Pjt 5, 14). Kjo nuk është vetëm shprehje e ftohët e fjalëve boshe, por, përdorim i shenjave që ndihmojnë, entuziazmojnë dhe trimërojnë personin. Për këtë flet edhe shën Pali në Letrën drejtuar Efesianëve: “Asnjë fjalë e ndytë të mos dalë prej gojës tuaj, por, nëse është nevoja, thoni fjalën e mirë që t’i ndërtojë e t’ju sjellë hir atyre që dëgjojnë” (Ef 4, 29).

Kjo “terapi me dashuri” realizohet në tre nivele.



### ***Dashuria e të tjerëve ndaj meje***

Në mesin e anëtarëve të familjes, shpesh dëgjojmë fjalë, të cilat edhe nëse nuk i dëmtojnë marrëdhëniet familjare, mund ta pikëllojnë personin, të cilit i janë drejtuar. Shembulli më i përgjithshëm është ai, kur e ëma i thotë bijës: “Sa e trashë je, sa e keqe je, sa keq dukesh, nuk ke shije, nuk din të vishesh” etj. Nëse në vend të këtyre fjalëve përdorni fjalë tjera, që trimërojnë, formojnë dhe japin zemër, do të mënjanohen konfliktet dhe tensionimet, ndërsa do të krijohet një atmosferë e paqes dhe dashurisë.

Kur dikush na trimëron, na buzëqeshë, me sinqeritet na përqafton, na vë dorën në krah ose na tërheq vërejtjen vëllazërisht, e ndiejmë veten të pranuar dhe të dashur. Kjo gjë na shëron nga pasiguria dhe nga shumë komplekse.

### ***Dashuria ndaj vetes***

Askush nuk mund të dojë, as të tregojë dashuri, nëse më parë ti nuk e don veten.

Urdhërimi i parë flet për detyrën e dhurimit të dashurisë vetvetes: “Duaje Zotin, Hyjin tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë fuqinë tënde, dhe me gjithë mendjen tënde edhe të afërmin tënd porsì vetveten!” (Lk 10, 27). E dua veten ashtu si jam dhe jo, ashtu si do të doja të jam, dhe veten e çmoj sipas asaj që jam. Në të kundërtën, hyj në negativizëm personal. Që të mund të kryejmë urdhërin e Jezusit, duhet të kemi marrëdhënie të mira me vetveten ashtu si dëshirojmë t’i kemi me të tjerët. Ky nuk është leksion i vrazhdësisë, por, shpjegim

i qëndrimit të Jezusit, sipas të cilit, vetëdënimi shkatërrues nuk është përvujtësi. Ai, shpesh, i ka shëruar të sëmurët dhe i ka falur mëkatarët, duke i liruar nga barra mëkatore dhe nga dënimi: “Biro, të janë falur mëkatet!” (Mk 2, 5). Dhe pastaj i shëronte. Duke e dashur vetveten, i falënderohemi Zotit për dashurinë që e marrim nga prindërit, miqtë dhe shokët tanë, sepse sa më shumë që marrim ose japim dashuri, aq më shpejtë shërohemi.

Shumë është e mirë dhe praktike metoda e tregimit të dashurisë ndaj vetes, nëse shikohemi para pasqyrës dhe fillojmë të falënderojmë Zotin për dhuratën që na ka dhënë me krijimin tonë në përngjasim të vetin. E falënderojmë për bukurinë e syve tanë, me të cilët mund të shohim; për shijen, me të cilën kënaqemi gjatë të ushqyerit; për dhëmbët, me të cilët kafshojmë dhe përtypim ushqimin; për gojën dhe buzët, me të cilat folim; për zërin, me të cilin bisedojmë me të tjerët; për shqisën e të dëgjuarit, me të cilën dëgjojmë etj. Kur veprojmë kështu, përmbushemi me dashuri dhe paqe.

Çdo gjë që nuk ju pëlqen, automatikisht shndërrohet në armikun tuaj. Nëse nuk ju pëlqen fytyra juaj, ajo është armiku juaj. Nëse nuk ju pëlqen ngjyra e lëkurës, ajo është armiku juaj. Nëse nuk ju pëlqen trupi juaj, ai është armiku juaj etj.

Psalmi 139, 13-16 mund t’ju ndihmojë që të frymëzoheni me Lavdinë e Zotit dhe të përmbusheni me dashuri:

“Ti je ai që m’i krijove veshkat,  
ti më ke endur në kraharorin e nënës!

Të lavdëroj pse më krijove kaq mrekullisht,  
të mrekullueshme janë veprat e tua,  
po, shpirti im mirë e di!  
Eshtrat e mi nuk të mbetën të fshehur  
kur unë po trajtohesha në fshehtësi  
i endur në thellësinë e tokës.  
Ende të patrajtuar më panë sytë e tu,  
në librin tënd ishin të shkruara të gjithë ditët:  
ishin të njehura megjithëse asnjë s' ishte ende prej  
tyre.”

### ***Dashuria që ua jap të tjerëve***

Personi, përplot dashuri, pa marrë parasysh  
a e pranon, apo e jep atë, është mjet i çmueshëm i  
shërimit. Mjeku i mirë dhe i kujdesshëm, i cili me  
mirësi dhe butësi sillet ndaj pacientëve të vet, bëhet  
burim i pashterrshëm i fuqisë shëruese për të gjithë.

Meshtari, përplot mirësi dhe dashuri ndaj  
besimtarëve të vet, është kanal përmes të cilit, Jezu  
Krishti shëron.

Mënyrë mjaft e përshtatshme për dhënien e  
dashurisë të tjerëve është *buzëqeshja*. Kardinali  
Richard Cushing, ka shkruar:

“Edhe vetëm buzëqeshja e vogël në buzët tuaja e  
gëzon zemrën.

Buzëqeshju vetes...përderisa nuk e vëren se ka  
tretur serioziteti yt i rëndomtë.

Buzëqeshju vetes... përderisa nuk e ngrohë  
zemrën tënde me shkëlqimin e fytyrës tënde  
shëndritëse.

Atëherë...

Shko dhe shndrit me buzëqeshjen tënde.

Buzëqeshja jote ka për detyrë të kryejë vepër të mrekullueshme për Zotin.

Buzëqeshju fytyrave të shkreta.

Buzëqeshju fytyrave të pikëlluara.

Buzëqeshju fytyrave të sëmura.

Buzëqeshju fytyrave të freskëta dhe të reja.

Buzëqeshju fytyrave të rrudhura dhe të vjetra.

Buzëqeshju familjes tënde dhe miqve të tu.

Numëro buzëqeshjet që i ka prodhuar buzëqeshja jote në të tjerët gjatë një dite. Ai numër do të të tregojë sa herë e ke nxitur gëzimin, kënaqësinë, shpirtin, trimërinë dhe besimin në zemrat e të tjerëve. Buzëqeshja jote mund t'u jep jetë, shpresë dhe trimëri të re zemrave të lodhura, të ngarkuara dhe të dëshpëruara. Buzëqeshja jote mund të ndihmojë në arritjen e pjekurisë së thirrjes tënde, nëse je meshtar.

Vëlla e motër!

Buzëqeshja jote... mund të jetë fillim i kthimit kah feja.

Buzëqeshja jote... mund ta përgatitë rrugën e kthimit të një mëkatari kah Zoti.

Buzëqeshju edhe Zotit...

Buzëqeshu me pranimin e këndshëm të asaj jete që Ai ta ka caktuar dhe do të meritosh të kënaqesh duke e shikuar fytyrën e Krishtit, të shkëlqyer dhe me buzë në gaz, e cila do të buzëqeshet me dashuri të jashtëzakonshme në amshim.”

***Shkrimi Shenjt rekomandon gëzimin si ilaç të shkëlqyeshëm:***

“Zemra e gëzuar bëri të lulëzojë jeta, shpirti i trishtueshëm i than edhe eshtrat” (Fu 17, 22).

“Shpirti i burrit e tejkalon ligësinë por shpirtin e molisur kush mund ta ngritë?” (Fu 18, 14).

Poetja meksikane, Anamaria Rabatti, në mënyrë të mrekullueshme, e shpreh në vargje atë që do të duhej të jetë programi i jetës së një personi ndaj të afërmit:

PËR TË GJALLË, VËLLA, PËR TË GJALLË!

*Nëse dëshiron ta bësh të lumtur dikend*

*që i dëshiron çdo të mirë...*

*bëje këtë sot,*

*për të gjallë, vëlla, për të gjallë...*

*Nëse dëshiron të dhurosh lule?*

*Dhuro sot, me dashuri...*

*për të gjallë, vëlla, për të gjallë...*

*Nëse dëshiron t’u thuash “Të dua”*

*anëtarëve të familjes,*

*miqve të afërt apo të largët?*

*Thuaje atë për të gjallë, vëlla, për të gjallë...*

*Mos prit kur të vdesin njerëzit*

*t’u shprehësh mirësinë*

*dhe ta ndiejnë dashurinë tënde:*

*për të gjallë, vëlla, për të gjallë*

*bëje këtë.*

*Do të jesh shumë i lumtur  
nëse do të mësosh ta ndash lumturinë  
me të gjithë që i njeh*

*për të gjallë, vëlla, për të gjallë...*

*Në vend të vizitiës varrezave,  
në vend të mbushjes së varreve me lule,  
mbushi zemrat me dashuri  
për të gjallë, vëlla, për të gjallë...*

*Anamaria Rabatti*

## **Gëzimi në vuajtje**

Zoti lejon vuajtjen dhe dhembjen, por ato nuk i dëshiron; njëlloj sikur e lejon mëkatin, kurse atë nuk e dëshiron. Mund të ndodhë që Zoti përnjëmend ia dërgon farë sëmundje ose farë vuajtje ndonjë personi, por në atë rast ato dhembje, kanë tre domethënje:

- frymëzojnë paqen dhe gëzimin,
- paqja dhe gëzimi përhapen në personat e afërm,
- kjo vuajtje sjell dashuri të madhe ndaj Zotit, dashuri zemërgjerë dhe vetëdhuruese.
- Kjo domethënie është më e rëndësishme se dy të parat.

Në këtë shërbesë, që e zbatoj tanimë disa vite, i kam takuar dy persona të sëmurë nga kanceri, me këto domethënje. Këta nuk kanë dashur që të lutemi për ta, sepse, frikësoheshin se do të humbin paqen

dhe dashurinë që u kishte sjellur sëmundja.

Një prej tyre – një nënë e re nga Republika Dominikane – më ka thënë këtë: “Vetëm këtë dëshiroj: që kjo dashuri, që e ndiej ndaj Zotit që kur jam e sëmurë, të rritet dhe të zhvillohet edhe më tej.”

Personi i dytë ka qenë një njeri dyzet e pesë vjeç, nga qyteti Monterrey në Meksikë. Ky jetonte në një shtëpi të mjerë nga kartoni, i varfër, i paralizuar, kurse i tërë trupi i ndytë i tij kundërmonete. Ai më tha: “Vëlla, më lejo të të quaj vëllai im. Nëse nuk ju pëlqen të ju quaj kështu, ju jeni në gjendje më të rëndë se unë. Unë jam njeri i lumtur që kur Jezusi, ka hyrë në zemrën time. Nuk ndiej më dhembje dhe nuk jam i denjë të jetoj këtë jetë që ma ka dhuruar Zoti.”

Mendoj se në këta dy persona janë përmbushur fjalët e shën Palit, në Letrën drejtuar Kolosianëve: “Dhe tani vetë ju gëzohem vuajtjeve të mia për të mirën tuaj dhe plotësoj në trupin tim çka u mungon mundimeve të Krishtit për Trupin e tij – Kishën” (Kol 1, 24). Shën Pali e ka gjetur gëzimin në vuajtje kur e ka zbuluar vlerën e vuajtjes (Vuajtja shpëtimtare 1).

## **Tre qëllime të vuajtjes**

Vuajtja i shërben lavdisë së Zotit, dobisë personale ose dobisë së tjetërkujt.

### ***Për lavdi të Zotit***

Në Ungjillin sipas Gjonit i gjejmë dy tekste, në të cilat shihet qartë se Zoti lejon sëmundjet dhe vuajtjet për lavdi të veten:

“Nuk mëkatoi as ky as prindërit e tij – u përgjigj Jezusi – por ndodhi kështu që në të të dëftohen veprat e Hyjit” (Gjn 9, 3).

“Jezusi, kur dëgjoi, tha: ‘Kjo sëmundje nuk është për vdekje, por për lavdi të Hyjit, që të nderohet në saje të saj i Biri i Hyjit’” (Gjn 11, 4).

Njerëzit nuk dëshirojnë të jenë të sëmurë. Dëshmi për këtë është ngarendja e tyre te mjekët për të kërkuar shëndet. Është e qartë se vuajtjen tonë mund t’ia kushtojmë Zotit duke e shndërruar në burim të meritave. çdo vuajtje që i dhurohet Zotit, e bashkuar me vuajtjen e Krishtit në kryq, shëlbon dhe lëvdon Zotin. Megjithatë, askush nuk dëshiron të jetë i sëmurë.

Zoti na e don të mirën dhe e don lavdinë e vet. çka i jep lavdi më të madhe: dhëmbja dhe vuajtja që ia dhuron një person i vetëm apo i tërë populli që e lavdon dhe i klithë fuqisë dhe dashurisë së Zotit, të cilat i ka zbrazur në atë person me të shëruar?

Zotin e lavdojmë në mënyra të ndryshme. Duhet të themi se Zotin nuk e lavdojmë më tepër me vuajtje se me shërim. Vlera e diçkahit nuk caktohet në bazë të mundimeve dhe përpjekjeve, por, në bazë të dashurisë me të cilën veprojmë në raste të caktuara. Kështu e shpjegon këtë, shën Toma:

“Nuk llogaritet merita në saje të përpjekjes dhe mundit që e ndiejmë kur duhet ta duam armikun, por, sipas përsosmërisë së dashurisë, që tregohet në atë rast. Kështu, po të ishte dashuria aq e përsosur, saqë do të mënjanonte tërësisht mundin, do të ishte (edhe) më meritore” (Quaest. Disp. Mbi dashurinë 8; ad 17).

Mund të dëshmoj personalisht për atë se Zoti



lejon vuajtjen për lavdi të Emrit të vet.

“Motra ime Luz Elena, zonjusha Blanca Ruiz, Zonja Virginia Chang de Dias dhe unë, kemi pësuar fatkeqësi komunikacioni në qytetin Panama, me ç’rast për pak nuk kemi vdekur. Në rrezik të posaçëm ka qenë motra ime për shkak të lëndimeve të rënda. Derisa kam qënë në spital, shpeshhërë e pyesja Zotin: ‘Ç’ dëshiron të më thuash me këtë o Zot? Ç’ dëshiron o Zot?’

Por asgjë nuk kuptova. Mirëpo, me të dalur nga spitali, duke u përgatitur për t’u kthyer në shtëpinë tonë në Nev York, vëreja se Zoti, me atë rast, ka bërë shumë shërime dhe kthime. Pashë se si disa mjekë dhe infermiere janë liruar nga bestytnitë dhe amajlitë që i mbanin rreth qafës, por edhe shumë shërime shpirtërore dhe trupore, që i kishte realizuar Zoti gjatë qëndrimit tonë në spital.

Qëllimi i udhëtimit tonë në Panama ka qenë predikimi në Santiago de Veraguas, por Zoti e ka lejuar atë aksident që të na dërgojë në një vend tjetër, në spital, në të cilin ata njerëz kurrë nuk kanë dëgjuar të flitet për Të. Kemi mundur të falënderojmë Zotin që e ka lejuar këtë ‘fatkeqësi’.

Gjithmonë kur na ftojnë për të shpallur Ungjillin, na i paguajnë shpenzimet e udhëtimit, por me këtë rast ne vetë i kemi ‘paguar’ me vuajtje, ashtu që në spital të shpallim Jezu Krishtin.”

Ndoshta ky aksident komunikacioni i ngjan rastit të shën Palit, të cilit për shkak të sëmundjes iu desht të mbetet tek galatasit dhe kështu ua shpalli Emrin e Jezu Krishtit (Gal 4, 13).

## ***Për të mirën tonë***

Ripërtëritja karizmatike, sipas traditës katolike, gjithmonë ka thënë se Zoti mund të lejojë vuajtjen, për të mirën tonë, për pastrim ose bekim.

Shën Pali flet për dhembjen e vet: “Dhe që, të mos më rritet mendja për shkak të lartësisë së zbulësive, m’u dha në trup një ferrë – engjëlli i djallit – për të më rrahur që të mos krenohem. Për këtë gjë tri herë iu luta Zotit të largohet prej meje. Por Ai mu përgjigj: ‘Të mjafton hiri im, sepse fuqia përsoset në ligështi’” (2 Kor 12, 7-9). Shën Pali e ka lutur Zotin që t’ia merr këtë dhembje, por, Ai nuk ia plotësoi lutjen për shkak të mirësisë së shpirtit të tij.

Kur më ndodhi fatkeqësia në Panama, Zoti më vërshoi me bekime duke më bërë të kuptoj se jeta e njeriut është e shkurtër dhe të kuptoj nevojën që të jetoj në shenjtëri dhe drejtësi gjatë të gjitha ditëve të jetës sime. Prej atëherë, mënyra e të menduarit tim dhe pikëpamjet e mia janë të tilla që, ngjarjet e përditshme i reflektoj në amshim. Sot ndjehem plotësisht i shëruar nga lidhja për jetë.

Një mjek që na mjekonte, motrën time dhe mua, na vinte më shpesh në vizitë dhe na thoshte:

- Sa të çuditshëm jeni ju? Dalloheni nga të sëmurët tjerë. Jeni të ndryshëm, e nuk mund të kuptoj në çka.

- Doktor, e pyeta një ditë, në çka ndryshojmë ne nga të tjerët?

- Të sëmurët shpesh qajnë, ankohen për dhembje, plagë, fytyrat i kanë të pikëlluara dhe janë të molisur. Kurse ju jeni gjithmonë të hareshëm, gjithmonë me buzë në gaz dhe shpesh këndon: “Do të lavdoj, do

të lavdoj Zotin...” ose “Unë kam gëzim në zemër...” dhe gjithmonë flisni për Zotin. Këtë nuk mund ta kuptoj.

Kohë të gjatë kam qenë në spital. çdo ditë kam predikuar me Bibël në dorë duke u përpjekur t’i bind të gjithë se është i nevojshëm kthimi kah Zoti. Kur erdh çasti i kthimit në shtëpi, në Nev York, mjeku i lartpërmendur më tha:

- Nuk e di ç’keni ju në vete, por atë që keni ju kisha dashur ta kam edhe unë (me sy plot lotë ra në gjunj para meje). I vura duart në të dhe i thashë:

- S’kam ar as argjend, por atë që kam po ta jap. Në emër të Jezu Krishtit Nazarenas prano paqen, dashurinë, faljen, gëzimin.

Pas një viti u kthyem në Panama dhe e takuam këtë mjek, i cili na tha se prej atëherë i ka ndryshuar jeta plotësisht dhe se të gjitha problemet e tij janë zgjidhur.

### ***Për të mirën e të tjerëve***

Shembulli më i mirë i vuajtjes për të mirën e të tjerëve është vuajtja e Jezusit për shëlbim të botës. Si shembull tjetër mund të përmendim sëmundjen që e kaploi shën Palin dhe i mundësoi që t’ua predikojë Ungjillin galatasve (Gal 4, 13).

Ky mësim i ripërtëritjes karizmatike katolike është, në tërësi, i akorduar me mësimin që e ka paraqitur Shenjt Atë Papa Gjon Pali II, në enciklikën e vet apostolike “Vuajtja shpëtimtare”, në të cilën flet për vuajtjen njerëzore.

Të njëjtën ditë kur pësuam fatkeqësinë në Panama, më 24 shtator 1976, derisa akoma ishim në ndihmë të

shpejtë, ka ndodhur një rast interesant për të cilin nuk kam qenë i vetëdijshëm dhe nuk më kujtohet fare. Po e tregoj ashtu si ma ka treguar personi i interesuar.

Z. Ernesto Gomez gjendej në spital për shkak të tumorit në fshikën e urinës dhe në shpinë, ashtu që nuk ka mundur as të urinojë e as të ecën drejtë.

Kur z. Gomez iu afrua bartëses sime për t'më përshëndetur, unë e kam pyetur:

- Prej çka vuani?

- Do t'më operojnë të hënën e ardhshme sepse kam tumor – më ka përgjigjur.

I sëmuri më thotë në atë moment kur i kam vënë duart në të dhe jam lutur. Kur jam kthyer në dhomën time, kam vërejtur se ai mund të ecë i drejtuar e pa dhembje dhe njëherësh ka ndier nevojën për urinim, të cilën nevojë edhe e ka bërë, gjë që nuk ka mundur ta bëjë më parë.

Pas kontrolleve dhe ekzaminimeve disa ditëshe, të cilat nuk treguan asgjë të jashtëzakonshme, mjekët e lëshuan nga spitali. Zoti e ka shëruar.

Z. Ernesto Gomez ka qenë dishepull i zellshëm i budizmit. Me të parë atë që Jezusi bëri për të, u kthye në Kishën Katolike, të cilën e kishte braktisur para disa vitesh. Madje, në shportën e bërllotut pranë shtratit tim, e ka hedhur objektin religjioz, të cilin budistët e quajnë 'bogonzo' dhe të cilin e ka shfrytëzuar gjatë lutjes.

Pastaj, Ernesto Gomez, e ka pranuar dhuratën e urtisë, në masë aq të madhe, saqë për një ditë, pas leximit të katër Ungjijve, ka qenë i aftë për t'i përsëritur fragmentet paralele të Ungjijve sinoptikë

dhe me thjeshtësi të mrekullueshme t'i shpjegojë dallimet midis tyre.

Ai njeri që e ka takuar Jezu Krishtin dhe është dashuruar në Të, tani u predikon dhe i ungjillëzon vëllezërit e vet, me gjithë zemër, shpirt dhe fuqi.

Zoti, pra, mund të lejojë vuajtjen, që të tjerët të kanë dobi shpirtërore. Ernesto Gomez e njoftoi Jezu Krishtin duke iu falënderuar fatkeqësisë tonë.”

## **A thua Zoti dëshiron që ne të vuajmë?**

Dikush mendon se Zoti na e dërgon vuajtjen dhe e dëshiron atë. Ky mendim i rrejshëm ka depërtuar tek ne përmes vetë neve nëpër dy kanale:

### ***Stoicizmi***

Shërbesa e shërimit është dobësuar, në rend të parë, për shkak të ndikimit të doktrinës së stoicizmit, të cilin ndikim e gjejmë madje edhe te Etërit kishtarë dhe përgjithësisht te mendimtarët dhe teologët. Për shkak të këtyre ndikimeve, trupi i njeriut është konsideruar si burg i shpirtit, i cili e pengon rritjen shpirtërore. Kështu ka ardhur deri te asketizmi i rreptë, i cili për ideal të përsosmërisë e ka pasur përbuzjen e trupit të njeriut dhe mundimin e tij përmes vdekshmërisë dhe ndëshkimeve. Jeta ka kaluar në pritje të ardhmërisë, në të cilën, shpirti do të lirohet nga “burgu” i trupit. Trupi nuk është çmuar as si dhuratë e Zotit as si tempull i Shpirtit Shenjt.

Mirëpo çdo gjë që ka shkaktuar vuajtje ose

flijim, ka qenë e stërçmuar, sepse me këtë trup i është nënshtruar pushtetit të arsyes. Shërimi ka pasur domethënie e humbjes së rastit për vuajtje, të cilën vuajtje, stoikët e kanë çmuar.

Vlerësimi i arsyes ka qenë i përcjellur me përbuzjen e trupit, i cili është vendbanim i epsheve të paarsyeshme dhe i çdo gjëje të vdekshme. Madje, vdekja është përshëndetur si liruese e shpirtit nga pengesat trupore.

### ***Interpretimi i gabueshëm i Lumturive***

Shkaku i dytë i përhapjes së mendimit se Zoti dëshiron që ne të vuajmë, ka qenë interpretimi i gabueshëm i Lumturive.

*“Lum ata që salvohen pse kryejnë çka Hyji kërkon sepse e tyre është Mbretëria e qiejve” (Mt 5, 10).*

Është menduar se përsosmëria e krishterë përbëhet vetëm nga qarja, uria, përndjekjet dhe nga çdo pikëpamje e vuajtjes, e jo nga identifikimi me Jezu Krishtin, i cili përmes kryqit e ka realizuar ringjalljen.

Jezusi na flet për përndjekjet dhe sulmet për shkak të Emrit të Tij, por, kjo gjë nuk ka të bëjë me epilepsinë, me ulcere ose me paralizë. Me fjalë tjera, vuajtjen e jashtme mund ta pësojmë si pasojë të besnikërisë tonë ndaj Ungjillit, kurse Jezusi ka ardhur që me kryq t'i anulojë sëmundjet tona të brendshme, që ndikojnë në trupin tonë.

Shërbesa e shërimit nuk dëshiron të na lirojë nga të gjitha vuajtjet, por e shpjegon thelbin e vuajtjes së krishterë: të vuajmë si ka vuajtur Jezu Krishti. “Përnjëmend për këtë edhe qetë thirrur; sepse edhe Krishti pësoi për ju duke ju lënë shembullin që edhe

ju t'i ndiqni gjurmët e tija" (1 Pjt 2, 21).

"Gjithmonë i mbartim në trupin tonë grahamat e vdekjes së Jezusit, që edhe jeta e Jezusit të shfaqet në trupin tonë" (2 Kor 4, 10).

"Prandaj kënaqemi në ligështi, në sharje, në vështirësi, në salvime e ngushtica që më bëhen për shkak të Krishtit! Sepse, kur jam i ligështë – atëherë jam i fortë" (2 Kor 12, 10).

## **Vdekja**

Kush e ka njohur personalisht Jezu krishtin, nuk frikësohet nga vdekja. Ai e di se vdekja nuk është fundi, por, fillimi i jetës së vërtetë, në të cilën është i ftuar. "Kush beson në mua, edhe nëse vdesë, do të jetojë. Edhe kush jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë" (Gjn 11, 25-26).

Vdekja është shërim i plotë, sepse na liron nga të gjitha të këqijat.

Frika, që e ndiejnë shumë njerëz para vdekjes, tregon qartë se Zoti nuk dëshiron të vdesim, por dëshiron të jetojmë me Të. Nuk na ka krijuar për vdekje, por për jetë. Zoti, në hirin e vet, na vjen në ndihmë dhe na shëron nga frika para vdekjes.

Jezu Krishti ka marrë pjesë në natyrën tonë njerëzore, ka pasur trup dhe gjak njeriu, që përmes vdekjes së vet ta shkatërrojë zotëruesin e vdekjes, djallin, "për t'i çliruar ata që ishin të nënshtruar skllavërisë për tërë jetën prej frikës së vdekjes" (Heb 2, 15).

Koncili II i Vatikanit na flet për shërimin që e prodhon feja para fshehtësisë së vdekjes. Në

konstitucionin “Gëzimi dhe shpresa”, nr. 18, shprehet si vijon:

“Enigma e pozitës së njeriut e arrin kulminacionin para fytyrës së vdekjes. Nuk e mundon njeriun vetëm dhëmbja dhe shkatërrimi, çdo herë e më i madh, i trupit, por, gjithashtu, në të vërtetë edhe më tepër, e mundon frika nga shuarja e përhershme. Dhe për nga impulsi i natyrshëm i zemrës së tij, ai me të drejtë, me tmerr, refuzon shkatërrimin e gjithmbarshëm dhe fundin e pakthim të vetes. Fara e amshimit që e mbanë në vete, e cila nuk mund të redukohet në vet materien, i kundërshton vdekjes.

Të gjitha përpjekjet e teknikës, sado të dobishme që janë, nuk mund ta qetësojnë ankthin e njeriut: me fjalë tjera, zgjatja e jetës biologjike, nuk mund t’ia shuaj ato dëshira për jetën e mëtejshme, të cilat në mënyrë të papërballueshme janë rrënjësor në zemrën e tij.

Derisa para vdekjes, është i pafuqishëm çdo ëndërrim, Kisha, e mësuar nga Shpallja Hyjnore, thotë se Zoti e ka krijuar njeriun për cakun e bekuar të anës tjetër të mjerimit tokësor. Për më tepër, feja e krishterë mëson se kjo vdekje trupore, nga e cila njeriu do të ishte kursyer po të mos kishte mëkatuar, do të ngadhënjehet kur Shëlbuesi i plotfuqishëm dhe i mëshirshëm do t’ia kthejë njeriut shëlbimin që e ka humbur me faj të vetin. Zoti, në të vërtetë, e ka thirrur njeriun që me tërë qenien e vet t’i qepet pas, në bashkësinë e amshuar të jetës së pashkatërrueshme hyjnore. Këtë fitore e ka arritur Krishti duke u ringjallur, pasi që me vdekjen e vet e ka liruar njeriun nga vdekja. çdo njeriu që mendon, feja e parashtruar



me argumente solide, i ofron përgjigje në pyetjet ankthsjellëse, për fatin e tij të ardhshëm; njëkohësisht i mundëson që në Krishtin, të jetë në bashkësi me vëllezërit e tij të dashur e të ndjerë, duke i dhënë shpresë se ata tanimë e kanë arritur jetën e vërtetë të Zoti.”

Besoj se këto fjalë të Koncilit, shën Augustini, në mënyrë të mrekullueshme, i ka shndërruar në uratë, kur thotë:

“Mos qani nëse më doni. Oh, po ta dini dhuratën e Zotit që është në qiell! Po ta dëgjoni këngën e engjujve dhe po të më shihni në mesin e tyre! Po të shihni me sytë tuaj horizontet, fushat e pafund dhe shtigjet e reja nëpër të cilat, unë eci! Po të keni mundësi, për një çast, sikur unë, të shihni bukurinë para së cilës të gjitha bukuritë tjera zhduken!

Më besoni, kur të vjen vdekja për t’ua hequr prangat, siç i ka hequr prangat që mua më kanë lidhur dhe kur një ditë, të cilën e ka caktuar Zoti dhe të cilën Ai e di, shpirti juaj do të ngjitet në qiell, në të cilin tanimë ka hyrë shpirti im, atë ditë do ta shihni atë që ju ka dashur dhe që ju don gjithmonë dhe, do të takoni zemrën e tij me përplot butësi të tijën.

Përsëri do t’me shihni, por të shndërruar dhe të lumtur, jo si njeri që pret vdekjen, por si njeri që me ju ec shtigjeve të reja të dritës dhe të jetës, duke pirë deri në të dehur, para këmbëve të Zotit, nektarin me të cilin askush kurrë nuk do të ngopet.

Fshini lotët tuaj dhe mos qani nëse më doni.”

I kam parë shumë njerëz duke e pranuar këtë fshehtësi dhe i kam parë duke vdekur në paqe të pashprehur.

Kur i krishteri, i edukuar në fe, e kupton fatin e vet definitiv, vdekja i shndërrohet në thirrje shprese.

Shembull për këtë është shën Tereza e Madhe, e cila ka shkruar:

*“Eja vdekje, fshehtas, që të mos e ndiej ardhjen tënde, sepse kënaqësia e vdekjes nuk do të lejojë që të kthehem në jetë.”*

Për të, vdekja ka qenë gëzim. Ndërsa shën Pali u shkruan filipianëve: “Vërtet, për mua Krishti është jetë dhe vdekja fitesë!” (Fil 1, 21).

Njeriu i fesë këndon gëzueshëm: “O vdekje, ku është ngadhënjimi yt? Ku është, o vdekje, thimthi yt?” (1 Kor 15, 55).

Atë Ignac Larranaga, shprehimisht thotë se dhuratën më të madhe që mund t’ia dhurojmë Zotit, para fshehtësisë së vdekjes, është ajo që të rrijmë në heshtje. I bindur për këtë, na propozon këtë uratë:

### ***“Heshtja dhe paqja.***

*Është dërguar në vendin e jetës.*

*Përse shtroni pyetje?*

*Qëndrimi i tij prej atëherë është Pushim,  
teshat e tij janë Dritë. Përgjithmonë.*

*Heshtja dhe paqja.*

*Ç ’dimë ne?*

*Zoti im,*

*Zotërues i historisë, zotërues i ditës së djeshme  
dhe të nesërme,*

*në duart Tua janë çelësat e jetës dhe të vdekjes.*

*Dhe, pa na pyetur*

*e ke marrë me vete në Vendqëndrimin Tënd*

*kurse ne i mbyllim sytë, e ulim ballin*

*dhe thjeshtë të themi: mirë është. Ashtu qoftë.  
Heshtja dhe paqja.  
Lufta ka përfunduar.  
Për të më nuk do të ketë  
as lotë, as qarje, as ngushtica. Në ballin e tij  
do të shkëlqejë përgjithmonë dielli dhe paqja  
e paarritshme  
më në fund do t'i sigurojë kufijt e tij.  
Zotërues i jetës dhe i fateve tona,  
në duar Tua, në heshtje po e lëmë  
këtë person të dashur që ka shkuar prej nesh.  
Derisa tokës, këtu poshtë, po ia besojmë  
të mebeturat e tij kalimtare,  
shpirti i tij i pavdekshëm  
le të pushojë, përgjithmonë, në paqen e amshuar,  
në prehërin tënd, i cili është i pahulumtuar dhe  
plot dashuri.  
Atë plot hire.  
Heshtja dhe paqja.”*

Zoti, në urtësinë dhe pushtetin e vet të pafund, i ka dhënë motrës time, Luiz Elenës, pas fatkeqësisë së rëndë të komunikacionit në Panama, edhe dhjetë vite jetë, dhe në fund e ka marrë ke vetja, në qiell. Me rastin e vdekjes së saj kam marrë shumë letra, në të cilat mund të shihen ndjenjat e personit që e ka njohur Hyjin para fshehtësisë së vdekjes: ajo nuk është fundi i gjithçkahit, por është shndërrim.

*Medellin, 30 korrik 1986*

I dashuri atë Dario,

me përqaftim të ngrohtë vëllazëror dëshiroj të të përshëndes dhe të jam pranë teje në dhembjen dhe gëzimin shpirtëror për Pashu (Pasha është festa Hebrejve) Luz Elenën. Ajo tanimë kënaqet duke e shikuar Zotin, me plot pranishmëri të Shpirtit.

Më lajmëroi Blanka Ruiz. Të përcjelli me ngushëllim vëllazëror dhe me miqësi në Hyjin e Ringjallur; e lus Shpirtin Shenjt që të të jep fuqi dhe të ta zëvendësojë mungesën e motrës tënde me dashuri të madhe Hyjnore.

Vëllai yt në Krishtin

Meshtar, Salvatore Carillo

Medellin, 31 korrik 1986

I dashuri Dario,

paqe dhe mirësi. Dëshiroj që në paqe të Zotit të bashkohem me ty, në këtë çast të jetës tënde. Mora vesh për vdekjen e motrës tënde. Me të vërtetë dëshiroj të jam me ty edhe përmes kësaj letre. E di se shoqëria e mikut ngushëllon, posaçërisht nëse ajo miqësi është miqësi në Hyjin. Nuk dëshiroj të të shprehi ngushëllime, por urime, sepse motra jote ka arritur në pranishmëri të Zotit, të cilit i ka shërbyer dhe të cilit ia ka dhuruar jetën e vet dhe ky takim përfundimtar, patjetër duhet të jetë takim i lumturisë dhe i gëzimit të përhershëm.

Me të vërtetë, vdekja është çast i lumtur, sepse na liron nga të gjitha pengesat që e bëjnë qëndrimin tonë

në këtë tokë, të pasigurt. Është shkatërruar josituria dhe motra jote tani gjendet para realiteti të madh, para Zotit.

T'i drejtohem i asaj. Nëse është te Zoti, duhet të jetë Pajtores e Shenjtë e jona dhe posaçërisht e jotja...! Të uroj!

Pranoje miqësinë time përmes kësaj letre dhe ki mbështetje në lutjet e mia dhe në kujtimin e motrës tënde në Eukaristi.

Jam me ty dhe lutja ime të përcjellë. Mos më harro në lutjet tua. Me përqaftim të përzemërt dhe me siguri se jam me ty.

Vëllai yt në Krishtin dhe në Zojën e Dhimbshme  
Jaime Forero R.

Nev York, 19 gusht 1986

I dashuri Dario,

Do të çuditësh që të shkruaj tani. Ja sapo dëgjova nga Roberto Torres për vdekjen e motrës tënde. Me siguri se shumë njerëz deri tani të kanë thënë që të jeshë i fortë dhe se do të kalojë edhe kjo gjë. Është vështirë që në kësi rastesh të lehtësosh dhembjen vetëm me fjalë. Mbi vdekjen janë shkruar libra, po edhe këngë, me tentativë që të gjendet kuptimi i një ngjarjeje aq të dhembshme. Filozofi dhe shkrimtari indijan Tagora, e ka shkruar një gjë tejet të thjeshtë, që i jep kuptim vdekjes dhe e përfshin atë në planin e Zotit. Ai thotë: "Sikurse jeta që është e bukur porsit

lulja pranverore, ashtu është vdekja e bukur si gjethet e zverdhura të vjeshtës.”

Çdo gjë është në vullnet të Zotit, sado që ndonjë ngjarje është e dhembshme dhe e pakuptimtë për ne. Në urtësinë e amshuar të Tij, Ai realizon atë që është e drejtë. E di se je qenie e jashtëzakonshme njerëzore dhe se, pa dyshim, ke qenë vëlla i madh. Ky është ngushëllimi më i mirë, të dish se ke qenë... i mirë ndaj atyre që i duam. Do të të kujtoj në lutjet e mia.

Oscar Hernandez de Diego

Santo Domingo, 21 gusht 1986

I dashuri Dario,

Dëgjova për “pashen e fundit” të Luz Elenës, çka pa dyshim, është përzierje e dhembjes dhe e gëzimit në Zotin dhe ngutem që me këtë letër të jam pranë teje në këto çaste, në të cilat lus Zotin që të të jep fuqi dhe që ta mundësojë për ta ndier, në mënyrë të posaçme, praninë e Tij, përmes forcës së fesë dhe “lutjes zemërgjerë” e cila vepron.

Dje, këtu në “La Asuncion”, kemi çuar meshë, së bashku me tërë popullin, i cili vjen rregullisht dhe zakonisht në numër të madh, për ty dhe për Luz Elenën. E kemi falënderuar Zotin për mirësinë e Tij, për fshehtësinë e rrugëve të Tija dhe të momenteve të Tija; për atë se ia ka zgjatur Luz Elenës jetën për më se dhjetë vite, pas aksidentit të komunikacionit në

Panama, në shenjë të dashurisë së Tij dhe për dëshmi, njerëzve të shumtë. Kjo dëshmi ka dhënë fryte të shumta, gjë që ti e di më mirë, dhe edhe më tutje do të jep. Le të të jep Ai sa më shumë forcë dhe le të të ngushëllojë mjaft me butësinë e dashurisë së vet, e cila është dashuri e atit, ëmës, vëllezërve, motrave dhe e cila është mbi të gjitha dhe mbi të gjithë...

S’di a e ke të njohur një nga ato fjalë që nuk janë të shkruara në Ungjill, ndërsa thonë se janë të Jezusit, siç është ajo të cilën e dimë nga shën Pali: “Më i lum është ai që jep se ai që merr” (Vap 20, 35). E kam gjetur para tre vitesh, në libërthin e çmuar të Andre Louf-it “Shpirti lutet në ne” (fq 126-127). Louf-i thotë: “Sado që të jetë i vetmuar ose i fshehur, njeriu që lutet kurrë nuk është vetëm”, dhe në këtë kontekst e sjellë një shprehje që, si duket, e ka thënë vetë Jezusi, ndërsa na e ka ruajtur shën Efremi, i cili ka jetuar në mes viteve 300 dhe 375: “Aty ku është një njeri plotësisht i vetëm, aty jam edhe Unë.” Kjo fjalë e Jezusit, mua personalisht më ka shërbyer shumë, si edhe shumë të tjerëve me të cilët e kam ndarë, kurse edhe mund të përdoret në shumë mënyra të mira. Duket si shtojcë fjalëve tejet të njohura te Mateu: “Sepse, ku janë dy ose tre të bashkuar në emrin tim, aty jam edhe unë, midis tyre” (Mt 18, 20).

Me të vërtetë, në vetmi absolute ose në takim vëllazëror të fesë, Ai është gjithmonë me ne, deri në fund të botës.

Dario, le të të forcojë Zoti që të vazhdosh të dëftosh praninë e tij, fjalën e tij, dashurinë e tij në fuqi dhe dashurinë e Shpirtit të tij.

Mirë pra, i dashuri Dario, tanimë e di se të jam i afërt, posaçërisht këto ditë. Pranoj lutjet dhe përshëndetjet e mia, së bashku me tërë bashkësinë e Asuncionit dhe me tërë njerëzit që të njohin ty dhe që e kanë njohur Luz Elenën. Shih, Zoti e formon në qiell “grupin e lutjes” që na lavdëron dhe që ndërmjetëson për ne: nëna jote, nëna ime, sa e sa njerëz që i kemi njohur dhe me të cilët, këtu në tokë, i kemi ndarë bekimet e Tij, dhe tani Luz Elena... “Në qiell të gjithë këndojnë aleluja, edhe unë dëshiroj të këndoj”... “U linda përsëri, u linda në Zotin...” Nëse gjen pak kohë, më shkruaj.

Gjithmonë besnik

Jorge Bravo, S. J.



## KAPITULLI III.

### KATËR HAPA DERI NË SHËRIM

Kreu 38 i Librit të Siracidit është tejet i pasur me udhëzime për shërim. Ai flet për katër hapa, të cilat personi i sëmurë duhet t'i ndërmerr, për t'u shëruar.

#### Mbështetja në Zotin

Teksti që vijon do të duhej të gjendet në çdo spital.  
*“Biro, në sëmundjen tënde mos ji i trishtuar, por lutju Zotit e ai do të shërojë” (Sir 38, 9).*

Dr. Fritz Lechman, profesor në Universitetin Hebraik të Jerusalemit, thotë se Izraeli në kohët e lashta nuk ka pasur mjekë dhe se të parën herë hasim në emrin mjek – “refe”, kur flitet për balsamimin (Zan 50, 2).

Sëmundja është konsideruar lajmëtare e vdekjes. Mbreti Asa, të cilit i njihen merita të ndryshme dhe vepra trimërore, ka vdekur për arsye se besimi në Zotin i është luhatur. Me fjalë tjera, më shumë është mbështetur në mjeshtritë njerëzore, se në mirësinë e Zotit. (2 Kro 16, 11-12).

Sasia e hireve hyjnore që na i jep Zoti është proporcionale me shpresën që kemi në të. Prandaj Jezusi gjithnjë kur ka bërë mrekulli ka thënë: “U

bëftë sipas besimit tënd!” “Besimi yt të ka shpëtuar!” Prandaj Zoti i ka bërë gjëra të mëdha Shenjtës Virgjër Mari: sepse, ajo ka besuar më shumë se të gjithë.

Shumë njerëz i drejtohen Zotit në fund, pasi që kanë kërkuar zgjidhje të ndryshme, zaten edhe me prejardhje djallëzore. Prandaj edhe nuk i zgjidhin problemet e tyre.

Para së gjithash duhet të mbështetemi në Zotin, edhe para se të kërkojmë ndihmën e mjekut. Mjeku dhe mjekësia janë të kufizuar në mundësitë e tyre, prandaj edhe shërimi, ndonjëherë ka sukses (Sir 38, 13) dhe ndonjëherë nuk ka (Mk 5, 26; Tob 2, 10).

Shkaku tjetër është edhe ai se, disa sëmundje, nganjëherë, janë rezultat i mëkatit, si p. sh: sëmundjet venerike.

## **Pendesa**

*“Largohu së keqes, pastër ruaj duart, nga çdo mëkat pastroje zemrën tënde” (Sir 38, 10).*

Zoti kërkon që të largohemi nga mëkati dhe të pastrojmë zemrën tonë nga padrejtësitë, sepse çrregullimi i parë në shëndetin trupor është rrëmuja morale që e sjellë mëkati. Në Librin e Zanafillës (3, 16-19) njoftohemi me pasojat katastrofike që ua ka sjellur mëkati stërgjyshëve tanë dhe tërë njerëzimit.

*“Rrëfeni mëkatet njëri-tjetrit dhe lutuni për njëri-tjetrin që të shërohëni!” (Jak 5, 16).*

Në këtë tekst të Jakobit, hasim në shpjegimin e hapit të dytë drejt shërimit. Rrëfimi i sinqertë i mëkatit është burim i pashterrur i paqes. Rrëfimi është mjekim

që shpie kah shërimi i plotë.

Një mjek-psikiatër më ka thënë se nga pacientët e vet kërkon që secili në fe të vet të pendohet për mëkatet e bëra. Ai ka qenë i bindur se kjo gjë sjellë fryte të mrekullueshme.

*Psikiatri Giorgio Schiaparelli më ka thënë se njëherë e ka pasur një pacient të ri i cili shpeshherë ka pasur kriza të rënda të nervozizmit depresiv. Me ndihmë të mjekësisë dhe të terapisë, ka dalur nga gjendja patologjike, por pak më vonë, përsëri ka rënë në të.*

Me kohë, shërimi psikiatrik e ka zbuluar shkaktarin e të keqes. Ky ka qenë një kompleks i rëndë i fajësisë me ndjenjë të dënimit, e këto kanë pasur rrjedhim nga çrregullimet morale të tij, posaçërisht që kur është sëmurë nga një sëmundje veneriane.

Ky i ri ka pasur më shumë nevojë për ndihmë morale të ndonjë prijësi shpirtëror, që do të kishte plot durim dhe kuptim për të, se sa për ndihmë psikiatrike.

Dr. Schiaparelli e ka udhëzuar këtë të ri te një mik i veti, një meshtar, i cili e ka udhëhequr rastin e tij në mënyrë të përshtatshme, ashtu që ky më nuk ka rënë në kriza të nervozizmit depresiv.

## **Kushtimi i flive**

*“Kushto fli të erëndshme, kushto ende dhe dhuratë të majme simbas pasurisë sate” (Sir 38, 11).*

“Kushtimi i flive” – si duket, është hapi më i paqartë dhe më i çuditshëm në mesin e katër hapave, por, njëkohësisht është edhe hapi më i lidhur me

obligimin tonë, që ta nderojmë Zotin dhe t'i japim dhurata.

Në Librin e Levitikut 2, 2 lexojmë se “flitë përkujtuese kanë erë të mirë për Zotin” kur ne ia kushtojmë ato.

Ky hap i tretë – kushtimi i flive – konkretisht mund të zbatohet në këto mënyra:

### ***Eukaristia***

- Të jipet mesha shenjte për Lavdi të Zotit dhe për shëndetin tonë.

### ***Dhuratat***

- T'i jipen dhurata Kishës ose institucioneve bamirëse, sipas mundësive. Të mirat materiale duhet t'i dhurojmë jo me dhunë, por, nga dashuria, ashtu që bollëku i njërës palë t'u del në ndihmë nevojave të palës tjetër (Puebla 1150). Mendoj se gjatë shpërndarjes së të mirave, njeriu duhet t'i merr në konsiderim prioritetet e nevojave, ndërsa e para ndër to është ungjillëzimi. “Më së miri i shërbejmë vëllait me ungjillëzim, i cili i lejon të shendërtohet si fëmijë i Zotit, e liron nga padrejtësitë dhe i ndihmon në zhvillimin e gjithmbarshëm” (Puebla 1145). Pra, duke i kushtuar dhuratat tona, posaçërisht duhet pasur parasysh rëndësinë e ungjillëzimit.

### ***E dhjeta***

- Kishës t'i paguhet e dhjeta. Përmes Malakisë 3, 7-12, Zoti flet për bekimet, ose mallkimet e atyre që e japin, ose që nuk e japin të dhjetën. “Që prej kohëve të etërve tuaj u larguat urdhërimeve të mia, dhe nuk

i mbajtët! Kthehuni tek unë e unë do të kthehem kah ju – thotë Zoti i Ushtrive. Ju thoni: ‘E si të kthehemi?’ Pse, njeriu mund ta gënjejë Hyjin? E ju, pra, më hoqët dredhi! Ju thoni: ‘Si të hoqëm dredhi?’ – Në të dhjeta e në fryte të para! Të mallkuar jeni me mallkim sepse më bëni branci mbarë kombi pa dallim. Silleni mbarë të dhjetën në drithnik që të ketë ushqime në Shtëpinë time; atëherë, në daçi, më vëni në provë në këtë – thotë Zoti i Ushtrive – pale a do t’jua çel ujëvarët e qiellit e a do t’jua zbraz bekimin me shumicë! Do ta kërcënoj në të mirën tuaj karkalecin e s’do ta dëmtojë frytin e tokës, e hardhia s’do t’ju jetë e pafrytshme në vreshtë – thotë Zoti i Ushtrive: Mbarë popujt do t’ju shpallin të lumtur, sepse do të jeni vend i kënaqave – thotë Zoti i Ushtrive” (Mal 3, 7-12).

Infermierja e re Blanca Bonaterra, pasi që disa herë më ka dëgjuar si flas në meshën e të dielës për bekimet që u jep Zoti atyre që ia japin Zotit të dhjetën, edhe ajo vendosi që ta bëjë këtë dhe filloi çdo të diele, gjithnjë e më tepër të jep lëmoshë, derisa kjo shumë nuk e arriti të dhjetën e pagës së saj.

Një të hënë, kur shkoi në ordinancë, mjeku për të cilin ajo punonte, i tha:

“Blanca, gjithmonë keni qenë infermiere e mirë, besnike ndaj punës dhe ndaj meje, prandaj kam vendosur që t’jua rris pagën për 10%, duke filluar retrogradisht për 10 muaj.”

Blanca ka filluar të jep të dhjetën e pagës mu para 10 muajsh. Zoti i përmbahet Fjalës së vet: “Atëherë, në daçi, më vëni në provë në këtë, pale...a do t’jua zbraz bekimin me shumicë” (Mal 3, 10).

## ***Jeta***

- T'i kushtohet jeta Zotit. Flija më e madhe e Jezu Krishtit është dhurimi i jetës së tij për ne. “O Atë: në duart e tua po e dorëzoj shpirtin tim!” (Lk 23, 46). “Dashuria më e madhe që ndokush mund të tregojë është: të japë jetën e vet për miqtë e vet” (Gjn 15, 13).

Kushtimi i jetës është dhuratë e bukur për Zotin. Kjo do të ishte sikur të themi: “Zoti im, nëse me këtë sëmundje dëshiron të më marrësh nga kjo botë, ja ku jam, le të bëhet vullneti yt!”

## **Kërkimi i ndihmës mjekësore**

*“Por jepi vend edhe mjekut, sepse edhe atë Zoti e krijoi, mos lejo të të largohet, sepse edhe vepra e tij është e domosdoshme” (Sir 38, 12).*

Tërheqim vërejtjen: ndonëse në Librin e Siracidit mjeku është në vendin e fundit, megjithatë rekomandohet si mjet përmes cilit vjen deri te shërimi. Zoti dëshiron të zën vendin e parë të vetin. Kurse shumë prej nesh, që lindim, e prishim rendin: në vendin e parë e vendosim atë të funditën: së pari kërkojmë mjekun, ndërsa pastaj kërkojmë mbështetje në Zotin për ndihmë.

Nuk guxojmë të përbuzim shërbesën mjekësore. Vetë Zoti na urdhëron që t'i drejtohem. Zoti shpeshherë na mjekon me barna dhe me këshilla mjekësore.

Siracidi këtë e shpjegon më tutje, kur flet për rolin

e mjekut: “Po, edhe ata i luten Zotit që t’i drejtojë në njohjen e vërtetë e ta shpejtojë shërimin” (Sir 38, 14), pra, të të ndihmojë dhe të të shërojë. Mjeku, farmacisti dhe infermieri duhet të dinë se nuk varet vetëm prej tyre shërimi i të sëmurit. Prandaj duhet të lusin Zotin që t’u ndihmojë në caktimin e diagnozës dhe në mjekim. Edhe i sëmuri edhe mjeku duhet të kërkojnë ndihmë nga Zoti.

Siracidi thotë: “Kush mëkaton para Krijuesit të vet, rëntë në duar të mjekut!” (Sir 38, 15). Kush nuk shkon te mjeku dhe i kundërshton udhëzimet e mjekësisë, i kundërshton mjetet që Zoti, ia ka dhënë në dispozicion.

Shihet qartë se Zoti na urdhëron që pas tre hapave të përmendura më parë, duhet të kërkojmë ndihmë nga mjeku. Bibla me çudi na flet se si mbreti Asa, i nga një sëmundje të rëndë të këmbëve, nuk ka kërkuar ndihmë nga Zoti, por nga mjekët. (2 Kro 16, 12) dhe kështu e ka përmbysur planin e Zotit.

Një ditë më erdhi në shtëpi një njeri me gruan e vet. I ngjante kufomës. Lëkurën e kishte të verdhë, sytë të thelluar, eshtrat memzi të lidhura me muskuj, kurse nervat plotësisht të molisur, e të gjitha këto tregonin se ky njeri ishte me një këmbë në varr. Më tha se, sipas fjalëve të mjekut, ishte para mbarimit: se i kanë mbetur dy muaj jetë sepse kanceri ia ka kapluar pankreasin, stomakun dhe mbarë trupin. Ka ardhur, që me meshtarin, t’i rregullojë të gjitha detajet rreth varrimit të vet dhe të më pyesë, sa kushton mesha e përsëritshme.

Derisa më fliste, vëreja se në të do të mund të

tregohej fuqia e Zotit. Dhe e ftova që të vjen të njëjtën mbrëmje, që të lutemi me grupin e lutjes për shërimin e tij.

Ashtu edhe u bë. Të gjithë jemi lutur me besim të plotë në Zotin. Kur është kthyer në shtëpi, ka fituar oreksin të cilin e kishte humbur për shkak të sëmundjes. Ka marrë pak ushqim, sepse ka qenë dobësuar shumë. Ditëve të ardhshme, oreksi i është shtuar çdo herë e më shumë. Atëherë e ka thirrur mjekun dhe i ka thënë çka ka ndodhur me të. Mjeku i ka përgjigjur: “Ju jeni para vdekjes. Hani ç’ju ka ëndja!”

Sa më shumë që ka ngrënë, aq më mirë e ka ndier veten, ka fituar në peshë, kurse faqet e tij janë skuqur porsì të ishte i shëndoshë. Pas ca kohe ka filluar të punojë.

Në këtë rast më së shumti jam befasuar kur i sëmuri, një ditë, më zbuloi se derisa ishte i sëmurë i ka thënë vetes: “Nëse dëshiroj të shërohem nga kanceri trupor, së pari më duhet të shërohem nga kanceri shpirtëror – mëkati!” Dhe pasi ka qenë shtatëmbëdhjetë vite larg Zotit, e ka kërkuar dhe e ka takuar: është rrëfyer dhe me devocion të madh e ka marrë kungimin shenjt. Gjithashtu, i lartpërmenduri më tha: Që disa hëre e ka porositur meshën e shenjtë në shenjtërorën e zonës së vet dhe i është lutur Zotit: ”Që tani o Zot bën me mua atë që është vullnesa jote, bekoje mjekun tim.”

Në këtë rast mund të shohim qartë katër hapa për të cilët kemi folur:



- Për të këthyer kah Zoti: atë ai e ka bërë pas 17 vjetësh,
- Pendimi: është rrëfyer,
- Kushtimi i flive: e ka kërkuar krenimitin e meshës shënjte,
- Kërkimi i ndihmës mjeksore: E ka kërkuar ndihmën e mjekut dhe është lutur për mjekun.

## KAPITULLI IV.

### FALJA SHËRON

Kur dikush na shkakton plagë në zemër, nuk mund ta duam. Midis atij personi dhe vetes e ngrisim murin, i cili deridikund, na ndan edhe nga njerëzit tjerë.

Kur dikujt i shkaktojmë plagë ose i bëjmë diç, për çka na vjen turp, mbyllemi në fajin tonë, të paaftë për të thënë: “Më vjen keq!” dhe ndihemi të paralizuar për shkak të neverisë që kemi ndaj vetes, prandaj edhe nuk mund të hapemi ndaj të tjerëve.

Falja na aftëson për dashuri dhe për zhvillim. E aftëson atë që falë dhe atë që pranon falje. Falja na pajton me të tjerët, e shëron shpirtin, e shpesh herë edhe trupin.

Një ditë më erdhi një zonjë dhe më luti që të lusim “lutjen për shërim” sepse vuante nga artritis reumatika. Ecte me paterica. Pas bisedës që bëra me të, kuptova se ajo e urren nusen e vet, e cila është martuar për djalin e vetëm të saj, ndërsa nipin e don shumë.

Pas lutjes për shërim të brendshëm dhe pasi e falënderuam Zotin për atë nip të mrekullueshëm, zonja kuptoi se ajo, në të vërtetë, duhet të falënderojë nusen për atë nip aq të bukur. Pas disa orësh lutjeje, zonja shkoi në shtëpi, me një qetësi të brendshme dhe

me paterica në dorë, pa u mbështetur në to. Ka falur dhe është shëruar.

## **Ç'është falja?**

### ***Falja është një vendim***

Falja nuk ka të bëjë me ndjenjat. Unë vendosi që të fali, ndonëse nuk ndiej ashtu.

Katherine Marshall në librin e saj “Diç më tepër”, tregon për vështirësitë në të cilat ajo, së bashku me bashkëshortin, ka hasur gjatë lutjes. Ata e sollën vendimin që t’u përmbahen plotësisht, fjalëve të Jezusit: “Kur lutesh, harro çka ke kundër tjetërkujt” (krah. Mt 5, 23). Ata i kanë shkruar për çdo ditë vërejtjet që i kanë pasur kundër ndokujt. Atë letër e kanë lexuar me zë të lartë dhe pastaj, të njëjtën, e kanë grisur.

### ***Të falësh do të thotë të duash***

Kjo është ajo që Zoti e bën me çdokend prej nesh dhe shembulli i Tij, duhet të na nxitë edhe ne, të bëjmë të njëjtën gjë.

Ne vendosim për faljen dhe për pranimin e faljes. Duke e bërë këtë gjë, e duam veten dhe të tjerët.

### ***Të falësh do të thotë të duash personin i tillë çfarë është***

Kjo d. m. th.: t’ia falësh marrinë fëmijës, vonesën mikut. Kur i pranojmë të tjerët të tillë çfarë janë, atëherë i forcojmë lidhjet midis nesh.

***Të falësh do të thotë të duash personin i tillë  
çfarë është dhe zaten përgjithmonë. Ky është stil  
jetësor***

Kjo d. m. th.: të jesh i gatshëm për të falur. Të falësh tjetërkend dhe veten. Kështu do t'i mposhtim padrejtësitë, fyerjet dhe mashtrimet e të afërmit tonë.

***Të falësh do të thotë të pranosh kërkimin për  
falje***

Kjo d. m. th.: që njerëzisht të pranohet tentativa e pajtimit që e ofron personi që e ka lënduar dikend, lehtë ose rëndë.

***Të falësh do të thotë të tregohesh i mëshirshëm***

Falja është madhështore kur ekziston shkak për të falur, por, është edhe më e mrekullueshme kur nuk ekziston ky shkak. Mu në këto raste, falja është më e nevojshme. Jezusi nuk e ka mohuar mëkatin e gruas, të cilën kanë dashur ta vrasin me gurë për shkak të kurorëshkeljes. Ai është treguar i mëshirshëm dhe i ka thënë: “Shko, por mbas tashit mos mëkato më!” (Gjn 8, 11).

**Çka nuk është falja?**

***Falja nuk është ndjenjë***

Nuk falim për shkak të ndjenjave tona. Falja nuk është akt sentimental i cili rrjedhë nga ndjenjat tona.

Në falje nuk merr pjesë aq shumë zemra sa marrin pjesë vullneti dhe arsyeja.

### ***Falja nuk kushtëzohet***

Nuk është falje ajo që shpesh dëgjohej: “Unë fali, por nuk harroj!” Ose: “Do të fali, po qe se kërkon falje!”

Jezusi e ka treguar një shembëlltyrë për birin I humbur, i cili e braktisi shtëpinë dhe e shkapërderdhi trashëgiminë e vet duke jetuar në paturpësi. Kur u kthye, u përgatit mirë për bisedë me atin: do t’i ofrohet për shërbëtor. Por, ati nuk e lejoi as gojën ta hapë. Nxitoi kah ai, e puthi, urdhëroi që t’i sjellen rrobe të pasura dhe të organizohet kremtimi. Nuk ka pasur kohë që të shprehet falja.

Kjo është historia mbi Atin tonë, që na don dhe na i falë të gjitha, pa na vënë kushte. Na pranon të tillë çfarë jemi dhe kështu na nxitë që të ndryshohemi. Ky proces kërkon që edhe ne të falim njëri-tjetrin.

### **Tri falje**

Kend duhet falur?

Kur një mësues i Ligjit e pyeti Jezusin se ç’duhet bërë për të fituar jetën e pasosur, Ai i përgjigji: “Duaje Zotin, Hyjin tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë fuqinë tënde, dhe me gjithë mendjen tënde edhe të afërmin tënd porsivetveten!” (Lk 10, 25-27).

Pasi na është urdhëruar që të duam Zotin, të afërmin dhe veten, gjithashtu, edhe duhet të falim në

këto tre drejtime.

### ***Të falim Zotin***

Nganjëherë hidhërohemi në Zotin për shkaqe të ndryshme, siç janë: vdekja e personit të dashur, lutja e paplotësuar, sëmundja ose fatkeqësitë për të cilat mendojmë se Ai na i ka dërguar, fatkeqësitë që kemi mundur t'i evitojmë etj. Për të gjitha këto fatkeqësi që mund të rrjedhin me hidhërim, duhet të falim Zotin, që mos ta pengojnë shërimin.

Zotin e falim, jo për arsye se Ai do të na e bëjë ndonjë të keqe ose diçka të keqe kundër nesh, por, për shkak të psikologjisë tonë njerëzore, sipas së cilës, kur kemi diçka kundër dikujt, miqësinë e krijojmë pas faljes. Kështu duhet të veprojmë edhe me Zotin. Kur dikush ka diçka kundër Zotit, është mirë që të thotë: “Zoti im, po të fali!”

Jobi pranon se ka qenë i paarsyeshëm kur ka menduar se Zoti është fajtor dhe ai kerkojë falje:

*“Prandaj fola si i pamend për mrekullitë që s’i kuptoj. Nuk të njihja veç me të dëgjuar, e tani me sy të mi të pashë! Prandaj veten e qortoj, bëj pendesë në hi dhe në pluhur” (Jb 42, 3-5).*

### ***Të falim të afërmin***

Shkrimi Shenjt është përplot mendime të këtilla.

*“Njeriu mban hidhërim kundër njeriut, si mund të kërkojë prej Hyjit shërim?!” (Sir 28, 3).*

Urrejtja nuk është vetëm pengesa më e madhe e shërimit, por shpesh është edhe shkak i sëmundjes. Si mund të presim shërimin, nëse nuk e çrrënjosim

sëmundjen? Shkrimi Shenjt na tërheq vërejtjen: “Mos thuaj: ‘Do ta kthej të keqen që m’u bë!’, ki besim në Zotin e ai do të të shpëtojë” (Fu 20, 22). Kjo do të thotë: mos u hakmerr vet. Besoja punën tënde Zotit dhe do të ngadhënjesh mbi të keqen me vepra të mira (krah. Rom 12, 19-21).

“Çkado që të kërkoni me uratë, besoni se e morët, e do ta fitoni me siguri. E kurdo të ngriteni për t’u lutur, falni nëse keni ndonjësend kundër ndokujt...” (Mk 11, 24-25).

“Na i fal fajet tona, sikurse ua falëm ne fajtorëve tanë” (Mt 6, 12), pra atyre që na ofendojnë.

Në këto tekste, qartë shohim nevojën për të falur, ashtu që të shërohemi, të dëgjohemi dhe të na falet. Do të mjaftonte edhe sikur të lutej mirë një “Ati ynë”, që të përfundojnë konfliktet dhe grindjet dhe kështu ta ngjallim qytetërimin e dashurisë.

*“Pra, nëse e sjell dhuratën tënde për ta kushtuar në lter e aty të bie në mend se yt vëlla ka diçka kundër teje, lëre dhuratën tënde aty para lterit, shko e pajtohu më parë me vëllanë tënd e pastaj eja e kushtoje dhuratën tënde!” (Mt 5, 23-24).*

Shën Gjoni Krizostom thotë se hiri i Atit është aq i madh, saqë më shumë kujdeset për të mirën tonë se për nderin e vet. Sipas tij, Zoti kërkon që për falje të lutet ai që është kujtuar i pari për problemin, e jo ai që ka ofenduar i pari.

Nëse në tekstet e më parshme theksohet përgjegjësia dhe obligimi që të falim atë që na ka ofenduar, në këtë fragment na tregohet qartë, se duhet të lusim falje nga ai që e kemi ofenduar. Sa herë?

“Atëherë Pjetri iu afrua dhe e pyeti: ‘Zotëri, nëse vëllai im gabon ndaj meje, sa herë duhet ta fal? Deri në shtatë herë?’ Jezusi i përgjigji: ‘Nuk po të them deri në shtatë herë, por deri në shtatëdhjetë herë shtatë herë!’” (Mt 18, 21-22).

Të falësh shtatëdhjetë herë shtatë herë, do të thotë të falësh gjithmonë.

Parabola mbi shërbëtorin i cili nuk deshti t’ia falë detyrimin të afërmit të vet, paraqet pasoja të tmerrshme të mosfaljes (krah. Mt. 18, 23-25).

*“Falni e do të gjeni falje!” (Lk 6, 37).*

Shprehjen e epërme – “falje”, disa e përkthejnë si “lirim”, që do të thotë falje me kuptim më të gjërë. Kjo do të thoshte, të arsyetohen të metat e të tjerëve. Aq më tepër: mos të përfillen fare.

*“Nëse ndokush thotë: ‘E dua Hyjin’, e këndeje e urrenë vëllanë e vet, është rrenacak. Sepse kush nuk e do vëllanë e vet që e sheh, Hyjin që nuk e sheh, s’mund ta dojë’ ” (1 Gjn 4, 20).* E kjo do të thotë se baba juaj është djalli, i cili është rrenacak dhe babai i rrenës (krah. Gjn 8, 44).

Mund të shikohen edhe tekste tjera, siç janë Siracidi 10, 6 dhe Fjalët e urta 19, 11.

### ***Të falim edhe veten***

Sikurse është vështirë t’i duam të tjerët nëse nuk e duam veten, ashtu është vështirë edhe të falim tjetërkend nëse nuk e falim veten.

Dëshmia që vijon tregon se sa është me rëndësi të falim veten.

“Njëherë nuk kam qenë i disponuar dhe iu përgjigja ashpër nënës, e cila ka qenë në karrocë



invalidore. Nëna qau. Në atë çast nuk kam pasur fuqi të kërkoj falje, por, këtë ia kam thënë Hyjit të dashur në rrëfim. Kur ka qenë nëna në shtrat të vdekjes, i kam kërkuar falje, kurse ajo më përgjigji me shtrëngim të dorës.

Megjithatë, një ndjenjë e thellë faji më ka përcjellur tërë kohën. Një person ma dha këtë këshillë: ‘Ti e ke lutur Zotin në sakrament që të të falë dhe ai të ka falur. E ke lutur nënën që të të falë dhe ajo, gjithashtu, të ka falur. Por ti nuk e ke falur veten. Bëje këtë dhe do të ndihesh më mirë!’ Dhe përnjëmend, kur e fala veten e ndjeva dashurinë ndaj vetes dhe kompleksi i fajësisë u zhduk.”

## **Disa udhëzime praktike për falje**

### ***Të gjithë t’i konsiderojmë të pafajshëm***

Shumë njerëz dëshirojnë të falin, por, nuk mundin. Mirëpo, Jezusi i kryqëzuar na ka dhënë çelësin e suksesit. Jezusi ka bërtitur në kryq: “Fali, o Atë, se nuk dinë ç’bëjnë!” (Lk 23, 34). Mendoj se me këtë, Jezusi na ka zbuluar fshehtësinë si të falim me lehtësi, duke thënë: “...se nuk dinë ç’bëjnë”. Shumica e njerëzve që ofendojnë të tjerët, nuk janë të vetëdijshëm për atë që bëjnë.

Shpirti i keq na ngacmon duke na thënë se ata që na ofendojnë, e dinë mirë se ç’bëjnë. Por ne, duke i vështruar nëpër dritën e fesë, mendojmë se ata me të vërtetë nuk dinë se ç’bëjnë, prandaj edhe i arsyetojmë.

Pot’i pyetnim ushtarët që e kanë kryqëzuar Jezusin: “Përse e bëni këtë?” Me siguri do të përgjigjinin: “A

nuk shihni? E kryqëzojmë të dënuarin.” Kjo do të thotë se, nganjëherë, njerëzit nuk janë të vetëdijshëm për veprat e këqija të tyre, megjithëse duket se janë. Ushtarët nuk kanë qenë të vetëdijshëm për të keqen që e kanë bërë. “Një frikë e madhe e kapi centurionin dhe ata që bashkë me të po e ruanin Jezusin, kur panë termetin dhe ngjarjet e tjera, thanë: ‘Me të vërtetë ky paska qenë Biri i Hyjit!’ ” (Mt 27, 54).

Shën Pali, këtë gjë e shpjegon kështu në Letrën e parë drejtuar Korintianëve: “Ne...predikojmë dijen e Hyjit të fshehur në mister...atë që asnjë nga princat e kësaj bote nuk mund e njohi; sepse, po ta kishin njohur, nuk do ta kishin kryqëzuar Zotin e lavdisë” (1 Kor 2, 6-8).

Për t’i konsideruar të pafajshëm ata që na kanë ofenduar sepse nuk dinë ç’bëjnë, nuk do të thotë se ata me të vërtetë nuk kanë bërë asgjë të keqe, por, nga dashuria e krishterë, subjektivisht, në vete i konsiderojmë të pafajshëm.

### ***Të besojmë se nuk kemi kundërshtarë***

Vëllai Roger, themelues i bashkësisë ekumenike në Teze, thotë se kusht për pajtimin është braktisja e bindjes se gjithmonë e kemi ndonjë kundërshtarë ose ndokend që nuk pajtohet me ne, me arsye apo pa arsye.

Mos të humbim kohën dhe fuqinë duke i shtruar vetes pyetje se kush ka të drejtë e kush s’ka të drejtë. Mos të humbim kohë në konflikte dhe diskutime që nuk sjellin kurrfarë fryti. T’u afrohemi personave të ngjashëm, madje edhe atyre që nuk mendojnë si mendojmë ne.

### ***Të pranojmë se nuk jemi të pranuar***

Ajo që na shkakton dhembje dhe që është shkak i urrejtjeve të mëdha, është mospranimi ose moskujdesi. Të gjithë ne, pak a shumë, nganjëherë kemi qenë të prekur për shkak të mospranimit.

Ekziston një parim tjetër i urtë, i cili, nëse do t'i përmbahemi në jetë, do të na ndihmojë që të shërohemi nga moskujdesi ose mospranimi, e ai thotë: *“Të pajtohem me faktin se nuk mund të jemi të pranuar nga të gjithë njerëzit.”* Kur të pajtohem me këtë fakt. Do të gëzojmë paqe të madhe në brendinë tonë.

Ati Ignac Larranaga e thekson këtë parim dhe thotë se Jezu Krishti është lutur në lutjet e tija të mbrëmjes që të shërohet nga mospranimi dhe moskujdesi fariseas, sepse i kundërviheshin predikimeve të tij. Po të mos bënte kështu, Jezusi do të vepronte me një agresivitet të madh .

Një person më ka thënë: “Kur jam pajtuar me faktin se nuk jam i pranuar nga të gjithë, përsëri e kam gjetur paqen që e kam humbur më parë.”

### **Hapat që duhen ndërmarrur për falje**

Të gjithë kemi vështirësi sa i përket faljes, edhe kur është fjala për të falur, ose për të kërkuar falje, edhe kur është fjala për të pranuar faljen kur na ofrohet ose kur e falim vetveten. Ja disa këshilla të dobishme:

### ***Të pranojmë gabimin***

Këtë e ka bërë mbreti David: “Ty, vetëm ty të kam rënë në faj!” (Ps 51, 6). Nëse nuk kërkojmë falje, ndjenja e fajësisë do të jetë gjithnjë e më e thellë dhe më e rëndë.

### ***Të duam të falim***

Kur vendosim të falim, ende nuk do të thotë se kemi falur, porse jemi në rrugë për të falur. Bën diçka! Ndërmerr diçka, dhe atë sa më parë: shkruaj letër, thuaje një fjalë, bëre një gjest të mirë, përqafo, lutu etj.

### ***Të mendojmë për tjetërkend***

Ndonjëherë, dikush na shkakton dhembje edhe me pahir. Mendo për këtë dhe shtroja vetes pyetjen: “Ç’ është ajo që e nxiti të më ofendojë?” Ose: “Ç’ do të bëja unë në ato rrethana?”

### ***Falja***

Falja duhet të jetë e plotë ose, përndryshe nuk është falje. Ajo është rrezikim, kurse rrezikimi është gjithmonë i rëndë. Ngadhënjimi i frikës se do të na shkaktohet dhembje, është çmimi që duhet paguar për dashuri.

### ***Shërimi i brendshëm që i shëron plagët***

Mendo për atë se ç’do të fitoje ti, po të të falej ndonjë padrejtësi e madhe që e ke bërë. Edhe ti mund të falësh.

***Ç' duhet bërë, nëse personi tjetër nuk dëshiron  
falje (pajtim)?***

Falja mund të jepet qetë – me zemër. Duke shpresuar në fshehtësinë e gjithpushtetësisë së Zotit, me anë të lutjes duhet të bashkohemi me faljen e tij dhe do të shihni se efekti do të jetë edhe më i madh se që mund të paramendohet.

**Të falim që të shërohemi**

Shumica e njerëzimit jeton në të kaluarën. Vuan për atë që nuk është më, duke i kujtuar plagët, tashmë të harruara nga të tjerët. P. sh.: bashkëshortësia e dështuar: njëra palë mund të vuajë, plot urrejtje e dhembje, kurse tjetra është indiferente, harron plotësisht të kaluarën, e lumtur në të tashmen. Duhet liruar nga e kaluara dhe ajo, duhet hedhur nga dora porsì prushin, se përndryshe do të na djegë.

Këtu po e paraqes një letër të 28 majit 1984. E ka shkruar një vajzë nga Formoza (Argjentinë).

“Atë!

Jam vajzë pesëmbëdhjetë vjeçe, nga Formoza. Vizita juaj na ka gëzuar. Jo vetëm mua, por edhe tërë familjen time. Tani do t'ju tregoj për ç'arsye po ju shkruaj këtë letër:

Babai im është njeri i vrazhdë që pin alkohol dhe duhan, kurrë nuk shkon në meshë dhe flet keq për meshtarët. Gjithnjë na keqtrajton, posaçërisht nënën. Jam shumë e pikëlluar, sepse nëna, për këtë arsye edhe gjendet në spital, në Buenos Aires (Ju lus që të

luteni për të!).

Kam shumë vëllezër dhe të gjithë, së bashku, vuajmë shumë, sepse kemi baba i cili nuk na dëfton dashurinë e vet. Përkundrazi, na keqtrajton dhe kur dëshirojmë t'i themi ndonjë gjë, na kthen shpinën që të mos na dëgjojë. Të shtunën ka qenë në stadium, në një mbledhje karizmatike. Kur u kthye, i vëreja disa ndryshime tek ai. Na thirri të gjithëve që të na tregojë për atë që ka parë dhe që ka dëgjuar. Pastaj na kërkoi falje dhe madje edhe qau. Kam mbetur e habitur. Kurrë nuk e kam parë babain tim duke qarë. Kjo që hera e parë në pesëmbëdhjetë vitet e jetës time.

Atëherë kuptova se babai im, me të vërtetë ka zemër të madhe (siç dinte të thoshte nëna ime). Kuptova se babai na don. Kur e kuptova këtë, dëshirova t'ua them të njëjtën gjë juve. Të dielën kam qenë në stadium dhe kam parë se Zoti është me të vërtetë i mrekullueshëm! Zoti i ndryshoi shumë persona. Madje edhe unë ndihem e ndryshuar.

Falemnderit atë! Falemnderit shumë!

Një motër e juaja në Krishtin.”

Në këtë letër shohim si është shëruar kjo vajzë, duke e falur atin për dhembjet që ky ia ka shkaktuar në të kaluarën. Zoti kërkon prej nesh që të falim, ashtu që ne të mos vuajmë dhe të mos u shkaktojmë dhembje të tjerëve.

Ato që e pengojnë më së shumti shërimin janë hidhërimi dhe urrejtja, e këto shpesh mund të shkaktojnë sëmundje shpirtërore dhe trupore. Për këtë flet edhe dëshmia që vijon:

“Në kishë të Chinandega-së, në Nikaragua, ka ardhur një ushtar me paterica për shkak të një

sëmundjeje të këmbëve dhe kërkoi që të lusim lutjen për shërim. Derisa luteshim për të, zbuluam se e urren shumë ish-diktatorin e Nikaraguës, gjeneral Somozën. I sugjerova që para së gjithash ta falë Somozën dhe kështu të hapet kah lutja efikase. Ushtari refuzoi. Pas një bisede të shkurtër, djaloshi tha: ‘Do ta fali, sepse e shoh se kam gjykuar gabimisht për padrejtësinë e Somozës!’

Në atë moment, ushtari ndjeu një ngrohtësi në këmbë dhe dhembjet u zhdukën. Ndjeu se mund të ecë pa vështirësi dhe doli nga kisha duke i bartur patericat në dorë.”

### **A kemi me të vërtetë armiq?**

Në Ungjillin sipas shën Lukës (6, 27-28) gjejmë udhëzimet e Jezusit, për atë se si duhet të sjellemi ndaj armiqve tanë:

- doni armiqtë tuaj!
- bënu mirë atyre që ju urrejnë!
- bekoni ata që ju mallkojnë!
- lutuni për ata që dijekeqas ju mendojnë!

Kështu duhet vepruar, sepse përndryshe nuk do të dallojmë nga ata që nuk janë të krishterë. Për këtë arsye në rreshtin 32 na shpjegon: “Nëse i doni vetëm ata që ju duan, çfarë merite të veçantë pritni? Sepse edhe mëkatarët i duan dashamirët e vet.”

Mënyra më e mirë për të lidhur miqësi me armikun është – biseda. Duhet të dimë se na duhet të

ndërmarrim hapin e parë: të kërkojmë personin. Mos prit që ta shohësh rastësisht, as që ai ty të të kërkojë, ndonëse edhe kjo mund të ndodhë. Ti ndërmerre iniciativën.

Nëse veprojmë kështu, nuk do të kemi armiq, jo pse i kemi eliminuar, porse i kemi bërë miq.

## **Lutja për falje**

Ati Roberto De Grandis e ka përpiluar këtë lutje për falje:

O Jezu Krisht, sot po të lus që të më japish hirin që të mund të fali të gjithë që më kanë ofenduar. E di se do të më japish fuqinë që të fali. Të falënderoj që më don dhe që më dëshiron fat e mirë edhe më shumë se unë i dëshiroj vetes.

O Zot, po të fali për të gjitha rastet, kur kam menduar se dërgon vdekje në familjen time dhe kur bota thoshte se ky është “vullneti i Zotit”. Po të fali, o Zot, edhe për hidhërimet e mia të ndërdujes. Po të fali edhe për vështirësitë dhe për problemet materiale, për ndëshkimet, sepse kam menduar se ti na i dërgon ato, mua dhe anëtarëve të familjes time. O Zot, është e mundur se këto hidhërimet i kam në vete qysh nga fëmijëria, por tani po të fali!

O Zot, po e fali edhe veten për mëkatet e mia, të metat dhe rrëzimet e mia. Për të gjitha të këqijat që i kam bërë, po e fali veten. Po e fali veten për pjesëmarrjen time në spiritizëm, në qitje falli, në horoskope, në këshillime me magjistare për fatin tim. Po e fali veten për atë që e kam thënë emrin tënd pa



nevojë dhe që nuk të kam nderuar ashtu si e meriton Ti. Për atë se i kam ofenduar prindërit e mi, se jam dehur, kam marrë droga, se kam mëkatuar kundër pastertijesë, se kam thyer kurorën, se kam këshilluar aborte, se kam vjedhur, se kam gënjyer... Për të gjitha këto po e fali veten. Falemnderit o Zot, për mëshirën tënde!

Sinqerisht po e fali edhe nënën time. Po e fali për ofendimet që mi ka bërë, për dhembjen që ma ka shkaktuar, po e fali për atë se është hidhëruar në mua, po e fali për atë se i ka dashur vëllezërit e mi më shumë se mua. Po e fali për atë kur më ka thënë: budalla, i pagdhendur, sa i keq je, i marrë, je më i keqi nga të gjithë bijtë e mi dhe për atë kur më ka thënë se i kam kushtuar shumë shtrenjtë. Po e fali për atë që më ka thënë se nuk më kanë dashur dhe se në këtë botë kam ardhur i paplanifikuar. Po e fali me gjithë zemër.

Po e fali babain tim. Po e fali për të gjitha çastet kur s'më ka ndihmuar me zemër dhe me kujdes. Po e fali për atë se nuk ka pasur kohë për mua. Po e fali për shprehinë e dehjes, për grindjet dhe zënkat e tij me nënën dhe me vëllezërit. Po e fali për atë kur na ka ndëshkuar e na ka injoruar, kur na ka braktisur, me të ikur nga shtëpia; po e fali për atë se është shkurorëzuar nga nëna dhe për të gjitha qëndrimet e tij jashtë shtëpisë. Për të gjitha këto po e fali.

O Zot, dëshiroj që falja ime të arrijë deri te vëllezërit dhe motrat e mia. Po i fali të gjithë që më kanë braktisur, që kanë gënjyer për mua, që më kanë urrejtur dhe që janë hidhëruar në mua; edhe ata që ma kanë lënduar trupin dhe shpirtin. Po i fali ata që kanë

qenë të rreptë ndaj meje, që më kanë ndëshkuar dhe munduar. Unë po i fali.

O Zot, po e fali edhe gruan time (ose burrin tim), për mangësi të dashurisë, kujdesit, mbështetjes, bisedës; po e fali për mungesat e treguara, për rrëzimet, dobësitë, veprat dhe fjalët që më kanë shkaktuar plagë dhe që më kanë dërmuar. Për të gjitha po e fali.

O Jezus, po i fali bijtë e mi për mangësinë e nderimit, dëgjueshmërisë, kujdesit, mbështetjes, ndjenjave, kuptimit, për veset, për atë se nuk kanë dashur të shkojnë në meshë dhe për të gjitha zënkat.

Zoti im, po i fali edhe dhëndërin tim e nusen time dhe të gjithë kushërinjtë, edhe të gjithë që janë të lidhur me bashkëshortësinë time, dhe të gjithë ata që janë sjellur ndaj fëmijëve të mi pa dashuri. Për të gjitha fjalët, mendimet, veprat dhe lëshimet e tyre, që më kanë shkaktuar dhembje – unë po i fali o Zot!

O Zot, më ndihmo që t'i fali kunetët e mi, gjyshërit dhe gjyshet e mia, të gjithë që kanë ndikuar në jetën time familjare dhe që u kanë bërë dëm marrëdhënieve tona familjare. Unë po i fali.

O Jezus, më ndihmo që t'i fali kolegët e mi të punës, të cilët janë të mërzitshëm e antipatikë dhe më mendojnë; ata që më ngarkojnë me punë, që më kritikojnë, që nuk bashkëpunojnë me mua, dhe ata që mundohen të më përzënë nga puna. Unë po i fali.

Gjithashtu po e fali ipeshkvin tim, famullitarin tim, kishën time, bashkësinë time, që nuk më japin mbështetje, që janë të mjerë dhe të gjorë, që nuk më ofrojnë miqësi, që nuk dinë të më trimërojnë si duhet, që nuk më nxitin, që nuk më vendosin në poste për të cilat jam i aftë. Për të gjitha po i fali.

O Zot, po i fali të gjithë që më kanë ofenduar në çfarëdo mënyre: mjekët, infermierët, avokatët, policët, nëpunësit në spitale dhe në ente të tjera. Për të gjitha që m’i kanë bërë, unë po i fali.

O Zot, po e fali edhe punëdhënësin, shefin tim, që nuk më ka paguar, që nuk e ka çmuar punën time, që nuk ma ka dashur të mirën dhe që nuk ka qenë i drejtë ndaj meje, që ka pasur karakter të dobët, që nuk është sjellur mirë ndaj meje, që nuk më ka dhënë vend më të mirë pune, që nuk ma ka lehtësuar punën.

O Zot, po i fali profesorët dhe instruktorët e mi, ata të mëparshmit dhe këta të tashmit, ata që më kanë ndëshkuar dhe poshtëruar, që kanë qenë të padrejtë ndaj meje, që më kanë përqeshur dhe që më kanë thënë se jam i marrë. Unë po i fali.

O Zot, po i fali miqtë e mi, që më kanë përfolur, që e kanë ndërprerë çdo lidhje me mua, që nuk më kanë dhënë mbështetje, që nuk më janë gjetur kur më janë nevojitur, ata që u kam dhënë të holla, e që nuk m’i kanë kthyer. Unë po i fali.

O Jezus, të lutem që të më japish hirin, që të mund të fali personin që më ka ofenduar më së shumti. Të lutem më jep forcë, që të mund të fali armikun më të madh, të cilin e kam më së vështiri për ta falur, të cilin kurrë nuk do ta kisha falur! Falemnderit, o Zot, që po më liron nga e keqja dhe që po më ndihmon që të fali. Falemnderit për dashuri dhe paqe! Bën që Shpirti Shenjt t’i shndritë të gjitha pjeses e qenies time! Amen!

## FALJA

Dua të fali...

Shpirti më është i disponuar tërësisht  
sikur të jetë i shurdhër për ofendime dhe lajkatime  
e... as e keqja që e pranoj, as e mira që e bëj  
nuk meritojnë që të kundërshtoj ose në kreni të  
ngritem.

Vullneti i keq nuk më shqetëson

as zemërimi i padrejtë s'më ofendon,  
kur jam i tradhtuar, kur jam i penguar,  
falja është përgjigjja ime që zgjatë.

Jam i lumtur... sepse të keqen që e pranova  
me përbuzje e hodha  
në greminën e pakapshme të harresës.

Pedro Elizalde Descalzo

## KAPITULLI V.

### BANJA ME DRITË

#### Ç'është ajo?

Banja me dritë s'është asgjë tjetër veçse, me ndihmë të Zotit, kërkimi dhe gjetja:

- e përgjigjeve në pyetjet që na mundojnë ose na shkaktojnë dhembje;

- e shkaqeve që na pengojnë të jemi të lumtur dhe nuk na lejojnë të përparojmë shpirtërisht;

- e shkaqeve të një pengese apo traume;

- e dritës e cila do ta dëbojë errësirën që e paralizon jetën tonë shpirtërore.

Shembull: një person jeton në një disponim agresiv, nuk është i disponuar, çdo gjë e hidhëron dhe asgjë nuk i pëlqen etj. Kjo gjendje e ka shkakun e vet, por, në të shumtën e rasteve, ai nuk dihet. Atëherë duhet lutur Zotin që ta zbulojë shkakun, që ta shndritë personin, ashtu që ky me të njohtuar me shkakun, ta thotë lutjen për shërim të brendshëm.

Që ta shpjegojmë më mirë se ç'është “banja me dritë”, po e paraqesim rastin e rregulltares, e cila ka jetuar në kuvend 32 vite dhe e cila thotë:

“Njëzet vitet e para, kam pasur jetë tejet të lumtur. Gjatë dymbëdhjetë viteve të fundit, kam përjetuar ferr të vërtetë. Askend nuk e kam dashur dhe askush nuk

më ka dashur. Kam kërkuar ndihmë për t'u liruar nga e keqja që më kishte kapluar dhe m'u rekomandua 'banja me dritë'.

Natën, duke u lutur në kapelë, i thashë Zotit:

- Jezus, më shndrit dhe më trego cili është shkaku i jetës time të shkretë dhe të mërzitshme në kuvend?

Atëherë, e pashë Jezusin duke dalur nga Tabernakulli dhe duke mu afruar me mirësi dhe me buzëqeshje. E shikoja derisa më afrohej. E pyeta:

- Jezus, pse jeta ime rregulltare është aq boshe? Pse nuk jam e lumtur si dikur?

Jezusi më përgjigji:

- Çfarë lidhje kanë me Mua revistat dhe gazetat që i lexon rregullisht? Pse humbë kohë në leximin dhe shfletimin e padobishëm të revistave?

I përgjigja:

- Jezus, ato revista nuk janë të pahijshme.

Jezusi më tha:

- Mu për atë se nuk janë të pahijshme, ti i lexon dhe ato të përmbushin me boshllëqet dhe kotësitë e kësaj bote, e këto të largojnë nga Unë. Kështu më ke përjashtuar nga zemra jote. Ti nuk ndien më asgjë për Mua. Nuk je e dashuruar në mua, nuk të jam tërheqës. Ja shkaku i mërzisë në jetën tënde rregulltare.”

Kjo rregulltare, me të vërtetë, gjatë dymbëdhjetë viteve ka lexuar disa revista, që e kanë larguar, gjithnjë e më tepër, nga dashuria ndaj Zotit dhe kështu e kanë shkatërruar jetën e saj, përse i përket lutjes. “Banja me dritë” ia ka treguar burimin e problemit të saj.

Gjatë ushtrimeve shpirtërore në Guatemalë, një person e ka bërë “banjën me dritë” dhe pastaj e ka

treguar këtë përvojë:

“Kur e ndjeva praninë e Jezusit, fillova t’i them, duke qarë e duke bërtitur, se kurrë nuk më ka dashur.

Jezusi më përgjigji:

- Gjithmonë të kam dashur.

I përgjigja:

- S’besoj se më do, sepse po t’me kishe dashur, nuk do t’ma merrje nënën, kur kam qenë tetë vjeçe.

Në atë moment ndjeva si më afroi Jezusi, në gjoks të vetin dhe, me shumë dashuri e butësi më përkëdheli dhe m’i fshiu lotët.

Më shikoi dhe më tha:

- A mendon se nuk të dua pse ta kam marrë nënën?

Kam ardhur ta marr, sepse e ka përmbushur detyrën që ia kam dhënë, e kjo detyrë ka qenë që ta dhurojë ty jetën. Unë jam i kënaqur me të dhe e kam marrë me vete që ta shpërblej, ashtu si i kam premtuar. A thua mendon ti, se ajo do të ishte më e lumtur po të kishte mbetur me ty, duke kaluar me vite të tëra, e ajo e sëmurë dhe e paralizuar?

Ndjeva atëherë, si Jezusi më jep në duar të Virgjërës Mari, duke më thënë

- Shko bijo! Siç e sheh, gjithmonë ke pasur nënë.

Kurrë s’ke qenë vetëm. Nëna ime, e cila është edhe nëna jote, ka qenë me ty dhe të ka përcjellur gjithkund.

Atëherë ndjeva se si Zonja e Bekuar më përqafoi, më përkëdheli dhe më mbulon me petkun e saj, duke më thënë:

- Bijo! Gjithmonë kam qenë me ty dhe të kam dashur, sepse je e imja!

Atëherë, ndjeva si mbushet jeta ime me lumturi. Pastaj, Jezusi më shikoi dhe më tha:

- Pse nuk ma dorëzon dhe nuk ma jep nënën tënde? A mund ta marr me vete?

Për të parën herë ia dorëzova nënën Zotit dhe e ndjeva një paqe të thellë.

Atëherë, Jezusi më tha:

- Do të të tregoj se me të vërtetë të dua dhe se kurrë nuk të kam harruar, sepse gjithmonë kam qenë me ty. A dëshiron të shohësh sa të dua? A thua nuk e di se të kam dhuruar burrin dhe fëmijët që të duan dhe kujdesen për ty? A thua nuk je e lumtur në shtëpinë tënde? Bijo, unë i dua ata që më përkasin, duke u dhënë çdo gjë që u nevojitet.

Ndjeva si më përqafton dhe si më afron në gjoksin e vet, duke më thënë:

- Unë jam Ati yt. Nëna ime dhe Unë të duam dhe gjithmonë jemi me ty.

Atëherë fillova të qaj, por nga lumturia dhe qetësia e brendshme. Kurrë, në jetën time, nuk kam ndier aq dashuri. Për të parën herë ia kam falur Zotit hidhërimin që e kam pasur gjatë në zemrën time dhe që më ka penguar që ta çmoj dashurinë, butësinë, kuptimin dhe mirësinë që e kanë treguar burri im dhe bijtë e mi.”

## **Dallimi në mes banjës me dritë dhe shërimit të brendshëm**

Me ndihmë të “banjës me dritë”, mund të lusim Zotin që të na shndritë, ashtu që të njohim rrënjën e të keqes. Kur e njohim rrënjën e të keqes, atëherë lutemi për shërim.



Te shërimi i brendshëm, e lusim Jezusin që ta shërojë dhembjen konkrete. Banja me dritë na tregon plagën dhe paraqitjen e saj.

Te shërimi i brendshëm kërkojmë ndihmën dhe mendimin e personit që lutet për ne. Banjën me dritë e bën vet personi që i nevojitet ndihma. Këtu qëndron dallimi më i madh në mes tyre. Në dëshminë e ardhshme do të shohim personin që ka pasur nevojë për dritë, ashtu që ta kuptojë qëndrimin e vet ndaj të tjerëve.

Gjatë “banjës me dritë”, e pyeti Jezusin:

- Jezus, pse e kam aq vështirë që ta bëj hapin e parë kah pajtimi dhe gjithmonë pres që atë hap ta bëjë personi tjetër?

- Për atë se, i përgjigji Jezusi, e shikon veten dhe jo Mua. Ti mendon për vete se je e mirë dhe se nuk ke faj, e harron se Unë, i pari, i kam falur mëkatarët. Në ato çaste, në vend se të vësh gisht në fajtorët dhe në vend se t'i dënosh, po të më shikosh Mua dhe po të më pyesësh se ç'do të bëja Unë në atë rast, do të gjeje përgjigje.

## **Tekstet biblike**

Disa tekste biblike na shpjegojnë se ç'është “banja me dritë”.

Jezusi, drita e botës (Gjn 12, 46), shndrit çdo njeri (Gjn 1, 9), që të mos mbetet në terr (Gjn 12, 46), por që ta ketë dritën e jetës (Gjn 8, 12). Kush e refuzon dritën mbyllet para shërimit që Zoti ia ofron falas (Gjn 3, 19-21).

Zoti, së pari e krijoi dritën: në të njëjtën mënyrë neve na bëri krijesa të reja (2 Kor 5, 17) duke bërë që drita e tij të shndritë në zemrat tona.

Në Krishtin jemi shndërruar në dritë për të tjerët, pra në faktorë të shëndetit dhe shpëtimit (2 Kor 4, 6).

Sepse asgjë s'është e fshehtë, veçse për t'u zbuluar, asgjë në moh, veçse për të dalë në dritë (Mk 4, 22). Nëse me fe dhe mbi të gjitha me sinqeritet e lusim Jezusin që të na shndritë dhe të na shërojë nga të këqijat tona, nuk ekziston asgjë që Ai nuk do të donte apo nuk do të mundte të bëjë.

“E çdo gjë që zbulohet, del në dritën e vërtetë të veten, sepse çdo gjë që është e zbuluar, është dritë. Prandaj thotë: ‘Zgjohu ti që fle, ngritu nga të vdekurit, dhe do të të shndrisë Krishti!’ ” (Ef 5, 13-14).

Ai që i afrohet dritës shndritet sikur që ngrohet ai që i afrohet ngrohtësisë ose sikur që ftohet ai që i afrohet akullit.

“Në saje të zemrës së dashur të Hyjit tonë që do të na e dërgojë në pasi prej qiellit Diellin, për të shndritur ata që gjenden në errësi dhe në hijen e vdekjes, për t'i drejtuar hapat tanë në udhën e paqes” (Lk 1, 78-79).

Ky tekst shpjegon qartë se ç'është “banja me dritë”. Ajo e shndritë errësinë, problemin, vështirësinë dhe në mënyrë konsekuente e udhëheqë personin, i sjellë dhe i jep paqe.

Tekste tjera, tejet të pasura me temën për dritën e Zotit, e cila na shndritë për të na shëruar, janë këto: Gjn 1, 4-5; Vap 9, 3; Rom 13, 11-14; 2 Kor 4, 3-6; Ef 5, 8-9; Kol 1, 10-14; 1 Sel 5, 2-9; Jak 1, 17; 1 Gjn 1, 5-7; Zb 21, 23-24. Posaçërisht i mrekullueshëm është

rreshti i parë i Psalmi 27: “Zoti është drita ime dhe shpëtimi im, kë do të kem frikë? Zoti është mbrojtësi i jetës sime, para kujt do të dridhem?”

Një ditë, gjatë ripërtëritjes shpirtërore, një person ma la një porosi në lter. Aq më ka prekur, saqë e ruajta atë porosi, që të lutem për të. Porosia ishte kjo: “Ka shumë vite që jam e sëmurë rëndë për shkak se një mjek më ka shkatërruar. Pas këtij rasti mizor kam rënë në pagjumësi dhe në asi nevrikosje, e cila ende më mundon. Prandaj e kam edhe tensionin e gjakut të lartë. Për të më shëruar, më kanë rekomanduar një dietë, e cila më ka bërë keq. Pastaj, për shkak të nevojës, më është dashur të punojë në kushte të ndotura, përplot lesh e pluhur. Kështu, u sëmura nga bronkiti, i cili, vitin e fundit aq shumë mori hov, saqë një natë gati nuk kam mundur të marr frymë.

Mbasi në spital nuk më kanë mjekuar në mënyrë adekuate, kam pësuar infarkt. Jam e moshuar, por, kurrë nuk e kam ndier pleqërinë ashtu si e ndiej tani: zemra e sëmurë, bronkiti kronik dhe dhembjet e tmerrshme në gjoks dhe shpinë, kurse gjatë natës astma. Tani, me të vërtetë dukem si plakë.

Ndihem e padobishme dhe më duket se jam barrë e gjithkujt. Po vdes nga frika; gjithmonë jam frikësuar dhe turpëruar. Nëse nuk më ndihmoni, do të vdes.”

Pak kohë, pas kësaj ripërtëritjeje shpirtërore, më erdh kjo letër e bukur:

“Atë, unë jam ajo që ua kam lënë porosinë e shkruar në lter, në të cilën ju kam shkruar se si më ka shkatërruar një mjek. Derisa e kam bërë ‘banjën me dritë’, e pyeta Zotin përse jetoj kështu, me shpirt dhe trup të sëmurë. Atëherë e dëgjova si më thotë:

‘Bija ime e dashur! Vërtetë, shkaku i vështirësive tua fillon me mizorinë e atij mjeku, por gjithashtu duhet të dish se **ligji im është dashuria dhe falja**, madje edhe ndaj armiqve. I tillë jam Unë. Nëse e duani njëri-tjetrin, bota do t’ju njeh si nxënës të mi. Kjo është shenja e vetme sipas të cilës do t’ju njohin se jeni të mitë!

Ji e vetëdijshme se duhet t’i duash dhe t’i falish armiqtë. Kështu kam vepruar edhe unë duke ju dashur, ndonëse keni qenë të këqij – mëkatarë.

Ndonëse e ke rrëfyer ngjarjen lidhur me atë mjek, në ndërdije, ti e urren ende atë. Fale! çfarë lumturie po qe se mbledhish fuqi, e ia thua këtë personalisht. Gjithashtu, thuaj se e dua, megjithë dobësitë dhe mëkatet e tij. Le të vjen te Unë dhe do ta shëroj. Unë të dua dhe të ruaj në zemrën time. ’

Atë Dario, e kam bërë këtë gjë dhe jam e lumtur pa masë. Kurrë deritani nuk kam ndier kësi paqe. Çdo gjë ka ndryshuar. Kam dashuri të madhe, ashtu që gjithçka më duket e mrekullueshme; gjithçka më pëlqen. Më me rëndësi është se jam shëruar nga çka më pëlqen. Më me rëndësi është se jam shëruar nga çdo dobësi, trupore dhe shpirtërore. Madje edhe rrudhat e fytyrës më janë zhdukur.

Falemnderit Jezusit!

“Mirënjohëse ndaj jush në Jezu Krishtin!”

Përgjigjja e drejtpërdrejtë

Dëshmitë e pranuar na vërtetojnë se Zoti na përgjigj drejtpërdrejt kur e lusim që të na lajë me dritën e vet.

Nëse shpejtësia e dritës është 300 000 km/s, drita hyjnore është edhe më e shpejtë dhe ajo sjellë begati të jetës.

Një zonjë, që ka vuajtur shumë për pabesitë e shpeshta të burrit të saj, e ka pyetur Hyjin:

- O Hyj, ç'të bëj me burrin tim të pabesë?

- Falje!

- Por, tanimë jam lodhur nga faljet dhe asgjë nuk po përmirësohet.

- Falje!

- Por, ai po e keqpërdorë këtë...

- Nuk të thash që ta falish, por që të lutesh për falje, pse nuk je e tillë çfarë ai kërkon. Lute që të të falë, sepse nuk i kushton kujdes të mjaftueshëm. Lute që të të falë, sepse e dënon dhe nuk je e butë dhe e kujdesshme ndaj tij ashtu si je ndaj të tjerëve!

## **Si bëhet kjo gjë**

Siç ka bërë Jezusi në Kopshtin e ullive në Gjetseman:

Vendi i qetë

Së pari, nevojitet një vend i qetë për lutje. Në Mk 5, 37-40 shohim si Jezusi ka mbetur vetëm në dhomë me prindërit e vajzës dhe me disa nxënës të tij. Kjo do të thotë: se ia ka bërë vetes vendin për lutje seditëse. (shtë shumë me rëndësi që të qetësohet shpirti, ashtu që të mundësohet hyrja në lutje.

Të paramendohet Jezusi në mënyrë njerëzore

Duhet ta parafytyrojmë Jezusin në mënyrë tejet njerëzore, sikur atëherë kur u është paraqitur nxënësve pas ngjalljes, i buzëqeshur dhe me vurrë në duar dhe këmbë, sikur na thërret që në to të vendosim gishtin tonë, ashtu si e ka thirrur apostullin Tomë.

Barbara Shlemon, në librin e vet “Lututni që të shëroheni”, shkruan: “Shfrytëzimi i imagjinatës tonë në lutje, mund të na ndihmojë që të besojmë se atë, për çka lutemi, tanimë e kemi arritur!”

Në gazetën New York Times (gusht 1973), dr. Walter Chase, drejtor i Seksionit për Hulumtimin e të Pamurit në Kaliforni, shprehimisht thotë:

“Ajo që shihet në mendje është po aq reale sa edhe ajo që shihet nëpër dritare. Nuk ka dallim të madh fiziologjik në mes shenjave që na i dërgon mendja dhe asaj që na ofron syri.”<sup>1</sup>

Pra, fuqia e imagjinatës nuk është komponentë pasive e qenies tonë, por mund të bëhet pjesë shumë aktive e lutjes tonë.

## Dialogu

Lutja është bisedë në mes dy personave: në mes teje dhe Jezusit. Tjetërkush nuk guxon të përzihet në këtë bisedë. Vetëm ju dytë duhet të bisedoni.

## Dialogu i dashurisë

Ky dialog është bisedë dashurie me Hyjin. Shembulli më i mirë i bisedës me Jezusin në “banjën me dritë” është ai, që na tregon shën Gjoni (Gjn 4, 1-26), kur Jezusi bisedoi me samaritanen. Derisa Ai

1 - Krah. Barbara L. Shlemon, Molite da ozdravite. Duh i voda. Jelsa, 1986. fq. 27.

ka biseduar me të, njëkohësisht, e ka shëruar nga urrejtja racore. Banja me dritë qëndron në ngjalljen e të vërtetës se Jezusi është në ne si shpresë e lavdisë që e presim.

### Heshtja

Që të mund ta dëgjojmë Hyjin, nevojitet heshtja. Shumë herë nuk e dëgjojmë Hyjin, sepse në asnjë moment nuk e lejojmë që të na përgjigj.

Lutjen e shndërrojmë në monolog, në vend se të kërkojmë bashkëbisedues.

### **Të shkruajmë në vend se të flasim**

Ekzistojnë persona që e kanë vështirë të flasin me Hyjin, por me shkrim mund të shprehen shumë më lehtë. Prandaj është mirë që t'i shkruhet Hyjit, duke ia paraqitur problemet tona dhe duke kërkuar përgjigje. Derisa Hyji na përgjigj, duhet të lusim dhe të heshtim. Është mirë që të shënohet përgjigjja e Hyjit. Po i paraqesim tre shembuj:

- Gjatë një ripërtëritjeje shpirtërore në Uruguaj, një nënë i shkruajti Hyjit: “Jezus, kam probleme të mëdha me bijën time. Ajo nuk të do ashtu si dëshiroj unë. Ç'të bëj? Me dashuri e pres përgjigjen tënde sepse bija ime nuk më kupton. Besoj se do të më ndihmosh! Petrona.”

Pas disa minutash ajo na e besoi përgjigjen e Jezusit: “Petrona, ke durim. Beso. Foli për Mua. Si mund të kërkosh nga ajo që të besojë në Mua, nëse kurrë nuk i ke folur për Mua?”

- Gjatë një ripërtëritjeje shpirtërore në Argjentinë, një i ri i shkruajti Jezusit: “Jezus, më jep durimin, që të mos jam eksploziv dhe që të mos jap përgjigje, me fjalë të ndyta, sikur sot! Përse kam bërë titur, kur këtë nuk kam dashur ta bëj? Jezus, më përgjigj! Më ndihmo! Oscari.”

Atëherë e dëgjoi Jezusin si i përgjigjet:

“Ti duhesh ndryshuar. Lejon që të të drejtojnë instinkt, sikur dikur. Përpiqu që të këshillohesh me Mua. Mëso të më dëgjosh, jo vetëm kur je në vështirësi, por në të gjitha çastet e jetës, për çdo ditë. Të gjitha m’i trego. Trego më shumë dashuri. Shërbehu me fjalët e dashurisë ashtu si vepron edhe me të fejuarën tënde. Çmo çdo të mirë dhe të bukur që mban në vete dhe atë që mua më pëlqen!”

- Gjatë ripërtëritjes shpirtërore në Obregon, në Meksikë, një zonjë ka shkruar: “Jezus, më thuaj ç’të bëj me burrin tim problematik? I dashuri Jezus, si të veproj? Ty nuk mund të të mashtroj sepse e di mirë se ky problem, që nuk mund ta zgjidhi, më mundon tanimë shtatë vite. Gjithmonë kam besuar në Ty, ndërsa përgjigje nga Ti nuk kam dëgjuar. Veçse heshtjen Tënde. E ndiej veten të braktisur në dhembjet e mia. Më akuzojnë dhe më dënojnë ashpër, kurse unë, Jezu Krisht, e ndiej veten të pafajshme. (’të bëj? Nuk dëshiroj të të shoh të përgjakur dhe të gozhdur në kryq për shkak të mëkateve të burrit tim. Sot dëshiroj që Ti të më jep zgjidhjen dhe e di se do të ma jep. Margarita.”

Hyji, në heshtje e bëri që të kuptojë:

“Bija ime, eja tek Unë. Tani jam duke e zgjidhur problemin tënd. E vetmja gjë që duhet ta bësh është që



të deklarosh se burri yt është i pafajshëm para Zotit. Ata dy persona që të kanë shkaktuar aq dhembje, paraqitja Atit tim në qiell e shpalli të pafajshëm, dhe do të shohësh si sendërtohet vepra e Zotit në familjen që Ai e ripërtërit dhe e pastron.”

## **Sa herë**

Aq herë sa nevojitet që të fitohet përgjigjja nga Hyji, derisa Ai nuk e zbulon shkakun e të keqes. Kjo gjë mund të bëhet për çdo periudhë të jetës, për ndonjë rast konkret ose për shërimin e plagëve që i fitojmë çdo ditë.

Nuk ka kohë as kohëzgjatje të caktuar. Mënyra si do ta bëjmë këtë ndryshon dhe përshtatet, varësisht nga rrethanat.

## **Efektet**

Kur e zbulojmë shkakun e vështirësive dhe të këqijave tona, duhet të zbatojmë atë që na thotë Hyji dhe në ne do të vjen deri te ndryshimi i dukshëm – shndërrimi. Nëse seriozisht dëshirojmë t'i njohim shkaqet e vështirësive tona, Zoti do të na i zbulojë dhe atëherë:

- do të jemi si pasqyra që e pasqyron lavdinë e Hyjit dhe gjithnjë e më shumë do të shndërrohemi në Krishtin, sepse do të kemi gjithnjë e më shumë lavdi të tij (2 Kor 3, 18). Dhe lavdia që do ta shndrisim do të jetë lavdia e fytyrës së Krishtit, i cili është lavdia e

Hyjit Atë;

- do të shkëlqejmë me dritën e yjeve në mes të kësaj bote të errët (Fil 2, 15) sepse jemi drita e botës (Mt 5, 14);

- do të shndrisim me paqe, për vete dhe për të tjerët.

## KAPITULLI VI.

### LUTJA ZEMËRGJERË

Në shërbesën time shëruese, kam vërejtur se vetë shërimi, varet nga mënyra si e lusim Zotin dhe sa shpesh, megjithë qëllimin më të mirë, e pengojmë shërimin. Gjithashtu, jam bindur se shumë shërime sendërtohen përmes lutjes zemërgjerë. Shpesh dëgjojmë shumë persona si thonë: “Nëse Zoti më jep këtë ose atë, do ta lë duhanin, do të bëj këtë dhe atë.” Ky është shembull klasik i lutjes vetjake, e cila nuk ka asgjë të bëjë me zemërgjerësi dhe prandaj nuk ka mundësi të arrijë atë për çka lutet.

Shërimi nuk blehet. Nuk mund të bëjmë me të tregti përmes kontratave ose veprave të mira. Ai është fryt i dashurisë së Zotit të mëshirshëm dhe prandaj, detyra jonë themelore është – falënderimi dhe zemërgjerësia.

#### **Ç’është lutja zemërgjerë**

Është kjo lutje, me të cilën e lusim Zotin që të bëjë ashtu si Ai mendon se është më së miri, në lavdi të Tij. Nuk e lusim për asgjë konkretisht, por, për atë që Ai don. Në këtë lutje nuk lusim asgjë për vete, por e lusim që të bëjë atë që do t’i jep lavdi. Lusim

që të njihet më mirë, të jetë i bekuar dhe i lavdëruar. Në këtë lutje, nuk lutem për atë të mirë që do të ma jep, por për atë që Ai dëshiron ta bëjë. Jam i gatshëm madje edhe të vdes, nëse Ai ka vendosur kështu dhe nëse Ai do të lavdërohet.

### ***A. Lutja në fatkeqësinë që e pësua në Panama***

Në aksidentin e përmendur në Panama, mendoj se e kam thënë një lutje, vërtetë zemërgjerë, kur i jam drejtuar Hyjit në këtë mënyrë:

“Para shumë kohësh t’i kam dhuruar prindërit e mi, pa u ankuar për atë se m’i ke marrur. Të lus në emër të Plagëve të Shenjta të tua dhe Gjakut të çmuar tënd, liroje motrën time nga vdekja, jo për shkak të dobisë që kam unë nga ajo, por, për shkak të lavdisë që do ta jep shërimi i saj. Trego se je Zot i gjallë dhe i pranishëm. Bën që ata që e shohin motrën time, të mos munden e të mos thonë: ‘Sa zemërgjerë ka qenë Zoti ndaj tyre! Sa i madh është Zoti ynë!’

Nëse në Provaninë tënde, tanimë ke vendosur ta marrësh tek vetja, merre, por kjo le të bëhet ndonjëherë tjetër, kur nuk do të ketë kurrfarë lidhje me këtë aksident dhe me pasojat e këtij aksidenti. Trego, o Zot, se je Fuqiplotë, Madhështor dhe Zot i Madh!”

### **B. Lutja e atit Karl de Foucauld**

Mendoj se njëra ndër lutjet më të bukura është

lutja e dorëzimit, e atit Karl de Foucauld. Mendoj se është lutje, vërtetë zemërgjerë:

“O Atë,  
po të dorëzohem.  
Bëj me mua ç’të duash.  
Të falënderoj  
për gjithçka do të bësh me mua.  
Jam i gatshëm për të gjitha.  
I pranoj të gjitha.  
Le të bëhet vullneti yt në mua  
dhe në të gjitha krijesat.  
Nuk dua asgjë tjetër, Zoti im!  
Në duart tua po e dorëzoj shpirtin tim,  
po ta jap ty, Zoti im,  
me tërë zjarrin e zemrës time  
sepse të dua  
dhe sepse ndiej nevojën e dashurisë  
që të dhurohem, që të dorëzohem  
me besim të pakufishëm  
në duart tua të gjithmbarshme  
sepse je Ati im. Amen.”

### **C. Lutja e atit tim**

Derisa kam qenë fëmijë, e kam dëgjuar babain si e thoshte lutjen, e cila gjithmonë më ka tërhequr. Kjo me të vërtetë ka qenë lutje zemërgjerë:

“Jezusi im, jam i bindur se tani je duke ndenjmur mbi koka të të gjithë atyre që shpresojnë në ty dhe se asgjë nuk do t’u mungojë atyre që nga Ti presin çdo gjë. Prandaj kam vendosur të jetoj pa frikë, duke

t'i lënë Ty të gjitha brengat e mia. Nëse njerëzit m'i marrin të gjitha të mirat dhe zërin e mirë; nëse sëmundjet më marrin tërë fuqinë e shërbimit tim ndaj teje, edhe nëse me mëkat e humbi mëshirën, nuk do të humbi besimin. Përkundrazi, do ta ruaj deri në çastin e fundit të jetës time, sepse kurrë nuk është asgjë e tepërt, çka pres nga Ti dhe, kurrë nuk do të arrij më pak se që kam shpresuar.

Jezusi im bën me mua ç'të duash sepse e di se më do!"

**D.**        **Të dytën lutje zemërgjerë** e kam lutur atë ditë kur jam ndarë nga spanjollët e mi në Nev York për t'iu kushtuar plotësisht ripërtëritjes karizmatike

“Jezus zemërbutë e i përvujtë, dëgjoje lutjen time!  
Më liro nga dëshira që të jem i çmuar,  
nga dëshira që të më duan,  
nga dëshira që të më lartësojnë,  
nga dëshira që të më nderojnë,  
nga dëshira që të më lavdërojnë,  
nga dëshira që të më pyesin për këshillë,  
nga dëshira që të më çmojnë,  
nga dëshira që të jem më i dashuri.

Më liro nga frika se do të jem i përlur,  
nga frika se do të jem i braktisur,  
nga frika se do të jem i përfolur,  
nga frika se do të jem i harruar,  
nga frika se do të jem i përqeshur,  
nga frika se do të jem i kritikuar,

nga frika se do të dyshojnë në mua dhe se nuk do të më besojnë.

Jezus, më jep hirin,  
që t' i duan të tjerët më shumë se veten,  
që t' i çmojnë të tjerët më shumë se veten,  
që t' i zgjedhin të tjerët, kurse mua të mos më përfillin,  
që t' i lavdërojnë të tjerët, kurse unë të mbes i panjohur,  
që të tjerët të kanë përparësi në gjithçka,  
që në sytë e botës të tjerët të lartësohen, kurse unë të përulem,  
që të tjerët të bëhen më të shenjtë se unë,  
kurse unë të jem i shenjtë aq sa duhet të jem.”

### **Lutja e shën Terezës**

Shën Tereza, në një vjershë të vetën, për mrekulli e shprehë zemërgjerësinë e dhurimit dhe të dorëzimit në duar të Zotit:

“Më jep vdekjen, jetën ma jep.  
Më jep sëmundjen ose shëndetin.  
Më jep turpin ose lavdinë.  
Më jep luftën ose paqen e plotë.  
Shenjën e dobësisë ose fuqisë  
dhe të gjithave t' u them Amen!  
E Jotja jam, për Ty u linda!  
Ajo që thua, le të frytojë!”

## Themelet biblike

Në Fjalën e Zotit gjejmë mësim dhe shembuj të mrekullueshëm për këtë lutje të dorëzimit të plotë.

Jezusi na ka mësuar që të lusim duke thënë: “U bëftë vullnesa jote si në qiell ashtu në dhe!” (Mt 6, 10). Ai vetë, në Malin e ulla të ullinjëve është lutur: “O Atë, ... veçse, le të bëhet, jo vullnesa ime, por vullnesa jote!” (Lk 22, 42), dhe iu dorëzua pa kurrfarë kushti Atit, duke thënë në kryq: “O Atë: në duart e tua po e dorëzohet shpirtin tim!” (Lk 23, 46).

Shën Pali na thërret që të shpresojmë, sepse “e dimë se Hyji në gjithçka bashkëpunon me ata që e duan” (Rom 8, 28).

Shën Jakobi është plotësisht i qartë kur zbulon se për ç’arsye nuk fitojmë atë për çka lutemi:

“Nuk keni pse nuk luteni. Luteni e nuk fitoni, pse luteni keq që t’i shpenzoni në plotësimin e ëndjeve tuaja” (Jak 4, 2-3).

Kurse shën Gjoni shton:

“Dhe kjo është siguria që kemi te Ai: nëse kërkojmë gjë sipas vullnetit të tij, Ai na e plotëson uratën” (! Gjn 5, 14).

Nuk mund të kërkojmë asgjë më mirë në lutje, se në ne të kryhet vullneti i Zotit. Jezusi na ka mësuar që të lutemi kështu në Atynën, sepse vullneti i Zotit është dashuri e pastër. Ai na e don të mirën më të madhe të gjithëve dhe gjithkujt, të mirën, edhe më të madhe se që mund ta dëshirojmë. Prandaj, dashuria e tij nuk lejon që të na plotësohet ajo që nuk na nevojitet. Psalmi 37 e shprehë një siguri të gjithmbarshme para Zotit, kur thotë: “Vëre gëzimin tënd në Zotin e ai do



t'i plotësojë dëshirat e zemrës sate" (Ps 37, 4),

Shën Toma i Akvinit, mosplotësimin e nganjëhershëm të lutjeve tona e shpjegon kështu:

“Zoti i plotëson lutjet tona nëse ajo për çka lutemi, është e mirë. Nganjëherë ndodh që ajo për çka lutemi, vërtetë nuk është gjë e mirë, por, është e mirë e rrejshme, ndoshta madje edhe gjë e keqe. Prandaj kjo lutje nuk mund të plotësohet.

## Dëshmitë

Në Bibël hasim në shembuj të lutjeve zemërgjera, në të cilat Zoti është përgjigjur për mrekulli.

**A.** Lutja e ndërmjetësimit që Shtjefni e ka thënë për përndjekësit e tij, në mesin e të cilëve ka qenë edhe “djaloshi që quhej Saul” (Vap 7, 58-59).

Shën Augustini thotë: “Po të mos lutej Shtjefni, Kisha nuk do ta kishte shën Palin.” Duke e ditur se ç’është bërë Pali më vonë, nuk mundemi e mos të mahnitemi, befasojmë nga vepra e Zotit, e cila e ka shndërruar atë në mrekullueshëm. Kjo gjë na mëson se kurrë nuk guxojmë të humbim shpresën për ndonjë shpirt, sepse nuk mund t’i kuptojmë planet e Zotit.

**B.** Zoti i ka falur të gjithë miqtë e Jobit, sepse Jobi është lutur për ta: “Prandaj merrni për vete shtatë dema e shtatë desh dhe shkoni te shërbëtori im Jobi, kushtoni fli shkumbimi për vete, kurse Jobi, shërbëtori im, do të lutet për ju, kështu që unë për dashuri të tij nuk do t’ju ndëshkoj për marrëziri tuaj, sepse nuk keni thënë për mua fjalë të drejta si shërbëtori im, Jobi” (Jb 42, 8). Në këtë pjesë shihet

deti i pafund i dashurisë së Zotit. Jezusi na e paraqet si shembull të përsosmërisë mëshirën e dashur të Atit Qiellor: “Jini, pra të përkryer siç është i përkryer edhe Ati juaj që është në qiell!”, që do të thotë: “Bëhuni edhe ju të mëshirshëm sikurse (edhe) Ati juaj është i mëshirshëm” (Mt 5, 48; Lk 6, 36).

**C.** Shembull tjetër i lutjes zemërgjerë, të cilën Zoti e ka plotësuar, është kthimi i shën Augustinit, të cilin e kanë mundësuar lutjet e nënës së tij, shën Monikës.

**D.** Këtu po e paraqes një letër nga Santiago (Çile), në të cilën shihen frytet e lutjes zemërgjerë.

Santiago, 18 tetor 1978

I nderuari Atë

Dario Betancourt!

Nuk dëshiroj të pres më e mos t’ju lajmëroj për gjendjen e vajzës sime Laura Ines, për të cilën jeni lutur ju dhe ati Diego Jaramillo, në spitalin Barros Luco.

Pas kësaj lutjeje i kam kaluar disa ditë në mendime para se vendosa që ta lus Zotin për shëndet, të cilin Ai tanimë kishte filluar ta jep. Nuk e kam pasur lehtë, sepse përveç kohës kur kam qenë në seminar, kurrë nuk jam lutur. Më as nuk e kam dashur Zotin, megjithëse kam besuar në Të. Unë, i marri, jam mbështetur në veten time!

Nga thellësia e qenies time, më ka tërhequr zemra ime atërore dhe nuk kam mundur të iki nga dëshira për shëndet aq të nevojshëm. Nuk di sa shenja i janë

dashur Zotit që t' mi jep, që të shoh se lutja ime nuk është lutje e vërtetë. Kam kërkuar, hiç më pak, që Zoti të bëhet mjet i vullnetit tim. Kam vazhduar të mbështetem në vete e jo në Të.

Kur e kam kuptuar këtë, jam penduar me sinqeritet dhe më në fund ia arrita të lutem: “O Atë, le të bëhet vullnesa jote: Laura Ines është mjete yt; i tërë njerëzimi është mjete yt; unë jam mjete yt.” Atëherë vërejta se si Zoti, shëron shumë shpirtëra rreth meje, në familjen time dhe jashtë saj. Sëmundja, i ka sjellur Laura Inesit shumë fryte, e ka shndërruar dhe në fund, Zoti ia dha shëndetin, ashtu si kam dashur.

Të premten, më 29 shtator, gjatë egzaminimit mjekësor, nuk ka dhënë kurrfarë reaksioni, as në nivel të të dëgjuarit, ashtu që u erdh në përfundim se nuk ka më kurrfarë shprese. Sipas fjalëve të mjekut “ka rënë në komë të thellë”.

Të hënën e ardhshme, na thanë se janë lajmëruar disa shenja pozitive,

Të enjten, më 5 tetor, hyra në dhomën e saj, në të cilën keni hyrë edhe ju dhe jeni lutur. Ajo u kthye kah unë e më tha: “Babi” dhe sytë e saj u ngjallën, kurse ajo me lumturi më buzëqeshi. Prej këtij çasti, gjendja i përmirësohet, ndërsa mjekët janë të çuditur dhe të lumtur. Rezultatet e reja, qartë tregojnë se nuk kanë ngelur pasoja. Më duhet të shtoj se Laura, gjatë një sulmi e ka këputur me dhëmbë gypin që e ka mbrojtur nga zënia e frymës. Dhëmbët nuk duruan dhe dy incizivët e epërm u lëshuan. Kur më njohu të enjtën, as nuk i kushtova kujdes gojës së saj, por e di se të njëjtën ditë e ka ngrënë një çokolatë të tërë me lajthi, për çka, natyrisht nevojiten dhëmbë të fortë. Të

nesërmen u vërtetua se dhëmbët i ka në rregull.

I bekuar qoftë Ati, i bekuar qoftë Biri, i bekuar qoftë Shpirti Shenjt!

Në fund, atë, dëshiroj të ju them se ajo, me iniciativë të veten, e ka kërkuar meshtarin dhe tani “lutet shumë”, siç thotë ajo. Kurse ka tre vite që nuk është lutur. Kjo do të thotë se Zoti e ka shëruar edhe shpirtin e saj.

Gjatë tërë kësaj kohe, shumë persona janë lutur për vajzën time, të njohur dhe të panjohur. Të gjithë i falënderoj pamasë, posaçërisht atin Diego dhe juve, kurse në veçanti Atin e amshuar!

Paqja e Zotit qoftë me ju!

Mario Alvina V.

Kjo dëshmi është shembull i mrekullueshëm i madhësisë së dashurisë së Zotit, si përgjigje në lutjen zemërgjerë, kur lutemi pa vënë kushte.

## KAPITULLI VII.

### “TERAPIA” ME LUTJE

Sipas përvojës tonë personale, të gjithë e dimë ç’është pikëllimi, dhembja dhe ankthi, kur nuk kemi sukses në përmirësimin e gjendjes shpirtërore, megjithëse u drejtohemi mjekëve dhe medikamenteve, që i kemi në disponim. Më së shumti vuajmë kur i kemi fëmijët të sëmurë.

Kur sëmuremi, së pari i drejtohemi mjekut. Ai na e konstaton diagnozën, na i shkruan reçetat për barna të caktuar dhe na thotë që për një kohë ta zbatojmë terapinë, e pastaj të vijmë tek ai, që ky t’i sheh rezultatet e arritura. Këtë proces e quajmë “procedimi mjekësor”.

Diçka ngjashëm ndodh kur një person vjen të kërkojë lutjen për shërim. Procedimi është i ngjashëm sikur shkuarja te mjeku.

Procedimi mjekësor

- Pacienti, së pari i thotë mjekut çka i dhemb, i tregon simptomet dhe shkaqet (nëse i njeh).

- Mjeku e konstaton diagnozën. – Mjeku e paraqet mendimin e tij të parë.

- Mjeku e cakton terapinë, të cilën pacienti duhet ta zbatojë gjatë një kohe të caktuar.

## Terapia me lutje

- I sëmuri tregon prej kur është i sëmurë, si ndihet etj.

- Zbulohet shkaku i sëmundjes dhe pastaj caktohet lloji i lutjes që duhet lutur: lutja për shërim të brendshëm, për lirim ose për shërim trupor.

- Thuhet lutja e parë me personin që kërkon shërim.

- Kërkohet nga i sëmuri që të vazhdojë të lutet vetë në shtëpi, t'i falë të gjithë, të pajtohet me Zotin etj.

## Aftësia e të dëgjuarit

Në terapinë me lutje, është tejet e rëndësishme aftësia e të dëgjuarit.

Francis McNut-i, njeri tejet i njohur në fushën e lutjes shëruese, thotë se ka dëshirë që më shumë kohë të shpenzojë në të dëgjuarit e personit se në lutje për të, sepse të dëgjuarit ia mundëson thënien e lutjes më adekuate për secilin rast. Kujdesi personal, tanimë është pjesë e kësaj terapie, pasi që shërimi bëhet me dashuri. Prandaj, Jezusi nuk ka thënë rastësisht: “Prapë po ju them: nëse dy vetë prej jush këtu mbi tokë, të një mendimi, luten për çfarëdo sendi, Ati im që është në qiell, do t’ua japë” (Mt 18, 19).

Barbara Shlemon, në librin e saj “Lutuni që të shërohemi”, thotë: “Që lutja jonë të jetë sa më efikase, është e nevojshme që për një kohë të dëgjojmë frymëzimet e Shpirtit Shenjt. Të fillojmë me lutjen: ‘O Zot, ç’do të bëje ti në këtë rast?’ Pastaj, lutemi

ashtu si na frymëzon Ai. Me praksë zhvillohet ‘aftësia e të dëgjuarit’; sa më shumë që shërbehemi me të, aq më shumë mund të mbështetemi në të. Do të duhej të lutemi për ‘aftësinë e të dëgjuarit’ sikur që lutemi për dhuntinë e gjuhës.”<sup>2</sup>

Dr. Monton Kelsey, nga Seksioni i Studimeve të Larta në Universitetin Notre Dame dhe autor i librit “Shërimi dhe krishtenizmi”, thotë: “Pesëdhjetë për qind të të gjitha egzaminimeve psikiatrike përbëhen nga dëgjimi me dashuri i vështirësive të huaja dhe nga ajo që të njëjtat mos t’i dënojmë.”

Barbara Shlemon shton: “Dhurata më e mirë që mund t’ia dhurojmë tjetërkujt është vëmendja dhe interesimi që ia kushtojmë asaj që tjetërkush flet. Të dëgjuarit na ndihmon që në vete të zhvillojmë ndjenjat e gjalla të ngushëllimit dhe të kuptimit. Fjala ngushëllim, nënkupton ‘vuajtjen me tjetërkend’, përjetimin e dhembjes së personit tjetër. Atëherë kur vendosemi në pozitën e tij, fillojmë të kuptojmë masën e vuajtjes së tij. Atëherë, sikur shën Pali, mund të ‘gëzohemi me ata që gëzojnë, e të qajmë me ata që qajnë’ (Rom 12, 15).”

Për të mësuar që t’i dëgjojmë, e jo t’i dënojmë të tjerët, duhet të ushtrojmë, ashtu që mos të dyshojmë në të tjerët që nuk mendojnë ashtu si mendojmë ne. Shenjë e pjekurisë është pranimi i personit ashtu si është. Atëherë, e pranojmë urtinë e shën Palit, i cili thotë: “Tashti, ju jeni trupi i Krishtit dhe, secili prej jush gjymtyrë e tija” (1 Kor 12, 27).

## Shembulli i Jezusit

Jezusi, gjatë shërimeve të tij, ka vepruar në këtë mënyrë:

**A.** Një shembull na paraqet i verbëri nga Jerihoni, të cilin Ai e pyet diçka që mund të na duket e tepërt: “Çka dëshiron të bëj për ty?” (Mk 10, 51). Jezusi e ka ditur përgjigjen qysh më parë, por, ka dashur që i verbëri t’ia thotë atë.

**B.** Kjo gjë është edhe më e qartë me të verbërin prej Betsaidës:

- e mori për dore,
- e qiti jashtë fshatit,
- vuri duart mbi të,
- e pyeti të verbërin dhe ai i përgjigji,
- i vuri duart mbi sytë e të verbërit,
- e nisi të shkojë në shtëpi (Mk 8, 22-26).

**C.** Në rastin e samaritanes, Jezusi vepron në mënyrë të jashtëzakonshme: biseda zgjati disa orë; me Nikodemin diskutoi me natë të tëra, kurse me samaritanët qëndroi disa ditë dhe me ta bisedoi që t’i shërojë nga urrejtja racore (Gjn 4 dhe 3).

Siç shohim, Jezusi nuk është lutur dhe nuk ka vepruar vetëm njëherë, por, vazhdimisht, për një kohë më të gjatë dhe kështu na ka dhënë shembull si të vazhdojmë edhe ne veprën e tij.

**D.** Me rastin e lutjes për lirim, vetë Jezusi, personalisht, na jep shembull: Ai shtron pyetje dhe jep urdhëra (Mk 1, 23-26; 5, 1-20; 9, 14-19).



## Dëshmitë

**A.** Në një vend të vogël të Kolumbisë ka ndodhur një shërim i çuditshëm. Një vajzë ka qenë e sëmurë nga osteomielitisi (pezmatimi i koskave) në këmbë. Pas përsëritjes së lutjeve disa orëshe, këmba u drejtua, u forcua dhe vajza filloi të ecë. Gjatë lutjes, ajo qante. Kur e pyetën përse qanë, tha se i është kushtuar Zotit se do të jetë e sëmurë derisa vëllai nuk i përjeton kthimin. Prandaj, ka menduar se e ka shkelur kushtimin e vet, kur ka parë se është duke u shëruar. Është dashur pra, të lutet për shërimin e saj të brendshëm. Atëherë, Hyji e shëroi tërësisht.

**B.** Në qytetin Matagalpa, në Nikaragua, ngjau diçka ngjashëm. Një vajzë i ka pasur këmbët të deformuara. U lutëm disa herë për të, derisa nuk ia arriti të ngritet në këmbë pa u ndihmuar me paterica. Edhe ajo qau me këtë rast. Kur e pyetën përse qanë, tha se e ka urrejtur atin e saj, për shkak se ka pirë dhe u ka shkaktuar vuajtje të shumta. Pastaj e lutëm dhe e nxitëm që ta falë babain e vet, që ta dojë dhe ta falënderojë për jetën që ia ka dhuruar. Pastaj, përsëri u lutëm për shërimin trupor, i cili vazhdoi të sendërtohet.

Mund të vërehet në të dy rastet se procesi i shërimit fizik, që kishte filluar, u ndal për një kohë dhe vazhdoi atëherë, kur ndryshoi forma e lutjes. Kështu u arrit shërimi i plotë.

**C.** Motra ime ka pasur probleme me syrin e djathtë, të cilin e kishte lënduar në aksidentin e

komunikacionit në Panama. Mjekët, tanimë i kishin thënë se nuk do të mund të sheh më. Një ditë, kur e hoqi fashën nga syri, filloi të qajë sepse shihte dyfish. Atëherë filluam të lusim që Zoti ta përfundojë veprën e vet. Sa më shumë që luteshim, shikimi i kthjelltësohej edhe më. Pas lutjes disa orëshe, të pamurit iu kthjelltësua tërësisht.

### Përfundim

Me shprehjen “terapia me lutje”, duam të themi se Zoti nuk shëron menjëherë, por ngadalë.

Shkaku është ai se shumë të sëmurë dëshirojnë të jenë në qendër të vëmendjes, dëshirojnë të jenë të pranuar, dëshirojnë që të duhen nga të tjerët, dhe që të tjerët të shfaqin interesim për dhembjet e tyre. Dhe kur pranohen me dashuri nga njerëzit, plagët fillojnë të shërohen, e me këtë edhe shkaku i sëmundjes së tyre.

Kush nuk ia kushton tërë kohën e vet lutjes për të sëmurët, nuk do të ketë shumë sukses me lutjen e vet. Pali apostull na trimëron dhe na rekomandon: “Lutuni pa pushim!” (1 Sel 5, 17).

Gjatë një fluturimi ndërkombëtar, në aeroplan, pranë meje, ishte i ulur një i ri me emrin Oktavio. Filloi të më tregojë për shqetësimet që kishte. Para se iu prezentova si meshtar, ai m’i tregoi të gjitha për vete dhe për jetën e vet të shfrenuar. Në momentin e caktuar fillova ta fus në të vërtetën ungjillore. I thashë se vetëm në Jezu Krishtin do të gjejë atë që kërkon. Në lartësi prej shtat mijë metrash, Oktavio, duke qarë, e pranoi Jezusin për Shëlbues dhe Hy të vetin.

Stjuardesa, e befasuar, pyeti ç’u bë.

- Jemi duke u lutur – i përgjigja – a doni të bashkëngjiteni?

Mbasi pranoi, u ngrita dhe ia lëshova vendin tim. Oktavio dhe unë filluam të lutemi me zë të lartë duke mos u turpëruar nga feja jonë. Atëherë erdhi komandanti i ekipit që të shohë se ç’po ndodhë dhe na tha:

- Në aeroplan nuk lutet.

- Natyrisht se lutet – i thashë – do të lutemi edhe për Ju.

Mbasi nuk deshti të ulet, stjuardesa, Oktavio dhe unë, vazhduam të lutemi para të gjithëve që na shikonin me habi.

Në fund të udhëtimit ia dhashë Oktavios vizit-kartën. Ai e lexoi me zë: “atë Dario Betancourt” . Pastaj më tha:

- Ah! Me të drejtë Ju luteni aq bukur...Ju jeni predikues protestant.

- Jo! – i përgjigja menjëherë. Nuk është e domosdoshme të jemi protestantë nëse lutemi bukur, por duhet të jemi të dashuruar në Jezu Krishtin. Unë jam prift katolik!

Ai më besoi vetëm pasi ia tregova librezën meshtarake. Pas disa muajsh, nga Oktavio mora një letër, në të cilën ai më tregoi për shërimin e tij dhe për atë se Jezusit ia ka dhënë vendin e parë në jetën e vet.

Buenos Aires, 6 dhjetor 1980

I dashuri Dario!

Dje e mora letrën e bukur nga ti. Falemnderit! Më ke bërë nder, sepse është më vështirë të merret letër

nga ti se nga kryetari. Më kanë treguar sa i zënë je, prandaj e kam të qartë se nuk mund të përgjigjesh në të gjitha letrat. Edhe njëherë, falemnderit!

Dje, duke e shikuar televizorin, kam qeshur sikur të isha i marrë, sepse të gjitha programet amerikane, në gjuhën spanjolle, e kanë të njëjtin zëdhënës. E dëgjova zërin e njëjtë si tëndin, e i cili dëgjohej në të gjitha programet: të hëneve je polic në motoçikletë, të marteve të ndjekin nëpër tërë Teksasin sepse ke vjedhur bagëti, të mërkureve je detektiv trim, por tullac, kurse të enjteve je vetëm mjek i thjeshtë, i cili kur hidhërohet, shndërrohet në gjigant të gjelbërt.

Besoje se, sa i përket kësaj, jemi të ngjashëm. Dikur jam “djalë i mirë”, i cili ia shtrin dorën e shpëtimit ndonjë të panjohuri që mbytet në ujë, kurse të nesërmen jam hajn dhe plaçkitës që tallet me tërë botën.

E kam edhe unë gjigantin e gjelbërt, që më kaplon atëherë kur punët nuk shkojnë ashtu si duhet. Ai i rrënon të gjitha derisa nuk fiton atë që dëshiron. Sa persona në një trup! Tipa dhe persona të ndryshëm qëndrojnë në mua gjithmonë, duke pritur pas perdes kohën kur do të dalin në skenë. Sa aktorë në mua – në Oktavion?!

- Ka Oktavio të mirë, të rrejshëm, të butë, të sinqertë! Cilin prej tyre e kam më të afërt dhe cilit i ngjaj? Të gjithë këta janë pjesë e imja! A mund të jetoj nëse njëri prej tyre vdes, ose a mund të jetoj pa asnjërin prej tyre?

Në ulëse, duke e pritur rendin e vet, qëndron një aktor tjetër, pa të cilin nuk mund të jetoj, sepse ka hyrë që moti në theatrin tim të vogël dhe thotë se nuk

do të shkojë derisa nuk ia besoj rolin kryesor! Nuk mundem e mos ta pranoj, sepse e dua dhe është më i mirë se të gjithë.

Kur “ego”-ja ime kolerike del në skenë dhe pas shfaqjes kthehet të pushojë, ky aktor përgatitet që ta luajë rolin e vet, por “ego”-të tjera e kapin për dore dhe i thonë:

- Jezus, kur do të pushosh me këtë? Ne jemi shumë dhe Ti, vetë, nuk mund ta marrësh mbi vete tërë theatrin, pajtohu me atë se e ndan me ne vendin që kemi. Pranoje atë se ti del në skenë çdo të diele prej orës 7 deri në ora 8, dhe kaq mjafton. Jemi shumë dhe të gjithë duhet t’i realizojmë ambiciet tona artistike. Mos na mërzit më. Përveç tjerash, për shfaqjet tua të dashurisë, paqes dhe të virtyteve tjera, nuk shiten shumë bileta.

Jezusi, atëherë tërhiqet në ulësen e vet dhe pret me durim. Më pushton zemrën ky tip. Disa herë kam dashur t’ia besoj rolin kryesor, por jam frikësuar se aktorët tjerë do të zemërohen. Epshendjellësi do të trokiste me durim në derën e dhomës time për çdo natë, vetjaku do ta përcjellte, pastaj do të vinte rrenacaku, lakmuesi, përtaci me shokët e vet dhe dhoma ime do të mbushej me njerëz, grindavecë, ashtu që më nuk do të kisha pasur paqe dhe qetësi. Pastaj, aty janë edhe vizituesit që më shikojnë. Nga dita në ditë do të më thoshin:

- Si bën që ky theatër të ketë vetëm një aktor? Nuk më pëlqen ç’flet ai. Nuk më pëlqen ky theatër.

Njerëzit do të shkonin, e unë nuk mund të mbes pa vizitues. Po të kishte shkuar Jezusi më herët, nuk do të kishte problem. Por tani nuk mund ta përjashtoj.

Së pari nuk dëshiroj ta përjashtoj, kurse as Ai vetë, nuk dëshiron të shkojë. Me të vërtetë dëshiron ta sendërtojë atë që e ka paramenduar.

Çdo herë kur e çoj perden e skenës së jetës sime, sytë i shkëlqejnë, sepse mendon se do ta thërras. Por, janë shumë aktorë dhe nuk mund t'ia jap tërë theatrin. Bëj ç'mundem, ndonëse të tjerët kërkojnë që ta përjashtoj përgjithmonë.

Ky, Jezusi kërkon shumë. Jo vetëm që nuk është i kënaqur me atë që t'ia jap theatrin, të vetmin që e kam, por don që ta lë të punojë në mënyrë të vet dhe të jetë drejtor i të gjitha shfaqjeve. Nëse vazhdon kështu, një ditë do të më përjashtojë nga shtrati dhe do të flej në tokë.

A dëshiron të ta them të vërtetën? Qysh moti do ta kisha përjashtuar, po të mos ishte një vajzë, që ka qenë butësia vetë, e cila më vinte për çdo ditë në theatër dhe më pyeste në ç'kohë shfaqet Jezusi nga Nazareti. Ishte aq e mrekullueshme, e mirë! Ishte tre ose katër vjeçe dhe kishte fytyrën me sy të mëdhenj që të zbutnin shpirtin e tërë.

- E dashur, i them, nuk e di a do të paraqitet sot Jezusi, por të dielën, në mes orës shtatë dhe tetë, me siguri do të paraqitet!

- Nuk është me rëndësi! Do të pres – më thotë ajo – derisa ulet pas ulëses porsì një pëllumb i bardhë. Është kjo vajza më e bukur që e kam parë ndonjëherë në jetën time. Më përkuqton fjollën e borës... kurse buzëqeshja e ëmbël e saj, duket si mjaltë!

Ajo i përcjellë të gjitha shfaqjet me kujdes. Akt pas akti shikon me syçeltësi dhe pret që lajmëtari të thotë nëpër altoparlant:

- Ndërsa tani, jeni ju në rend, Jezus nga Nazareti!  
Por, asgjë prej kësaj! Kalojnë orët, kurse Jezusi nuk paraqitet. E përcjellë perden duke u lëshuar, orvatet që të gjejë fytyrën e Jezusit pas perdes, por sytë e saj të mëdhenj nuk mund të zbulojnë asgjë. Në fund thotë: “Mirë, ndoshta nesër...!”

Dhe shkon kokëulur me lotë në sy. Para se shkon, më pyet: “Me gjasë nesër, apo jo?”

- Nuk mund të premtoj e dashur, ndoshta nesër!

Më puthë butësisht dhe largohet duke përshpëritur: “Të lutem Oktavio, nëse e sheh Jezusin, i thua se ka qenë Maria e vogël (nga Nazareti)!”

Me këtë tregim fantastik, orvatem të të njoftoj me disa ngjarje nga jeta ime. I dashuri Dario, të përqafton miku yt dhe dëshiroj që të kalosh mirë për festa.

Çdo ditë e lus Zotin që të vazhdojë t’i shërojë sëmundjet e mia shpirtërore.

Miku yt Oktavio

Kjo letër dëshmon se si mund të jetë efikase “terapia me lutje”, kur dëshirojmë të jemi të shndërruar në Krishtin.

“E ne të gjithë, të cilët, me fytyrë të zbuluar, bredhim lavdinë e Zotit, me anë të Shpirtit të Zotit, shndërrohemi në të njëjtën trajtë – nga lavdia në lavdi” (2 Kor 3, 18).

## KAPITULLI VIII.

### FJALA E TË NJOHURIT

Çdo herë e më tepër dëgjojmë në grupe lutjeje dhe nëpër mbledhje, si flitet për “fjalën e dijes ose për fjalën e të njohurit”. Por, edhe më shpesh, kjo fjalë përjetohet kur lutemi për shërimin e të sëmurit. Ndodh të dëgjojmë shpalljen: “Jezusi e shëron një person që ndien ngrohtësi në një pjesë të trupit. Kjo është fuqia hyjnore e shërimit. Hyji që është jetë, në atë moment e shëron atë person”.

Disa janë të befasuar, disa pyesin ç’po ndodh dhe përse flitet në këtë mënyrë, por ka edhe skeptikë.

Do të mendojmë që ta shpjegojmë këtë dhuratë aq sa është e mundur, këtë dhuratë që shërben për përforcim të fesë në bashkësi.

#### **Ç’është fjala e të njohurit**

Fjala e të njohurit është të njohurit mbinatyror që pranohet përmes hireve. Përmes saj, inteligjenca njerëzore shndritet me veprimin e Shpirtit Shenjt, përmes të cilit njihet dhe shihet rrënja e një problemi apo ajo që Zoti bën ose që do të bëjë me krijesat e veta me cak mbinatyror.



## **Njohja mbinatyrore e hireve**

Këtu bëhet fjalë për të njohurit mbinatyror që nuk arrihet me përsiatje dhe me sjellje të përfundimeve, por, me dritën e posaçme të Shpirtit Shenjt, që jepet gradualisht. Siguria nuk arrihet me njohuri dhe me të menduarit njerëzor, por, ajo është hir i posaçëm i Zotit.

## **Përmes saj shndritet mendja e njeriut**

Fjala e të njohurit vjen në mendjen e njeriut që është parapërgatitur përmes fesë, që të mund ta pranojë këtë njohuri mbinatyrore. Kjo është edhe një dhuratë që ndihmon në rritje dhe në forcim të fesë.

## **Përmes veprimit të Shpirtit Shenjt**

Shpirti Shenjt është ai veprimtar që e vë në lëvizje fjalën e të njohurit. Drita e Shpirtit Shenjt e mundëson të njohurit dhe të pamurit. Nuk është kjo ndonjë përsiatje, por një lëvizës më i lartë nxitë në veprim.

## **Për të njohur dhe për të parë**

Me fjalën e të njohurit njohim atë që ka bërë Zoti, që bën ose që do të bëjë me krijesat e veta. Shpeshherë duket se shpallja e fjalës së të njohurit përputhet me veprimtarinë e Zotit.

Në raste të tjera duket se fjala e të njohurit është mjet i Shpirtit Shenjt, fjalë e suksesshme që e realizon atë që e dëfton. Kur ka thënë Zoti “Le të bëhet drita”, drita u bë. Në të njëjtën mënyrë, kur shpallet ndonjë shërim, ai edhe realizohet. Shih Gj 15, 3; Ps 16, 12.

## **Në personat me cak mbinatyror**

Fjala e të njohurit përdoret, në rend të parë, për të shprehur realitetin hyjnor në krijesat që e zbulojnë lavdinë e Zotit. Më thjeshtë do të mund të themi, se ajo është drita e Shpirtit Shenjt përmes së cilës i njohim veprat e Zotit.

## **Emri tjetër i kësaj dhurate**

Nganjëherë e quajmë “fjala e dijes”. Gjithashtu, mund të quhet kështu: të njohurit, dituri dhe kuptimësi. Unë më me dëshirë e përdori shprehjen “të njohurit”, sepse ajo më në tërësi e shprehë kuptimin e karizmës: dhuratës me të cilën njihen veprat e Zotit. Pastaj, shprehja “të njohurit”, më pëlqen më shumë sepse, disa teologë e shohin dallimin në mes të njohurit dhe diturisë. Sipas tyre, shprehja e parë paraqet njohjen e veprave të Zotit, pa shpjegime. Fjala e dytë do të paraqiste të menduarit, diskutimin, thellimin dhe depërtimin në Zotin, që të mund t’i mësojmë edhe të tjerët për Zotin.

Mendoj se “fjala e të njohurit” e shprehë më së miri thelbin e saj. Me shprehjen tjetër, më vështirë shpjegohet kuptimi i kësaj karizme të Shpirtit Shenjt.

Nuk është ky ndonjë “fenomen psikik” ose “njohuri jashtëshqisore”. Nuk është as “telepati”, as “fuqi parashikuese”. Nuk është as “bartje e mendimeve”, siç është kur dy persona, njëkohësisht pranojnë të njëjtën porosi.

## Si vërehet kjo dhuratë

Në mënyra të ndryshme.

Është kjo një siguri e brendshme, që na tregon se ajo që e kemi në mend, është me të vërtetë, vepër e Zotit dhe shpirti nuk qetësohet derisa nuk e dëfton këtë.

Është kjo, sikur një fjalë që shkëlqen në ekranin televiziv. P. sh.: fjala “zemër”. Kur shqiptohet kjo fjalë, na shfaqen detajet: personi me zemër të sëmurë, i moshës së caktuar, me atë ose këtë sëmundje.

Mund të jetë edhe si një dhembje e vogël, në një pjesë të trupit, ose sikur dikush, me maje të gishtit, na prekë një pjesë të trupit. Kur dëftohet se Zoti e ka shëruar ndonjë person, ndjenja e dhembjes zhduket.

Shembull: të paramendojmë se gjendemi në një dhomë të errët. Përnjëherë ndezet drita dhe në një kënd vërehet një piano e zezë, e mbyllur dhe e vjetër. Befas ndalet drita dhe përsëri jeni në errësi. Në çastin kur ka qenë drita e ndezur, nuk kemi pasur kohë të mendojmë për kualitetin dhe vjetërsinë e pianos, për atë se a është margaritar i lashtësisë etj. Përsëri ndezet drita dhe në anën tjetër shohim një dollap përplot me libra, të ngjyrave dhe formave të llojllojshme, me përmbajtje të llojllojshme dhe në pozita të ndryshme... Drita ndalet dhe kthehet errësira, kurse ne nuk kemi pasur kohë për mendime tjera.

Ati Emilien Tardif, në librin e vet “Jezusi më ka bërë dëshmitar”, shpjegon: “Është fjala për një ide të qartë që e kemi në shpirt. Gradualisht, duke e shpallur,

na paraqiten detajet. Këtë përvojë do ta krahasoja me porosinë e shkruara në façoleta të letrës. Në façoletën e parë janë fjalët që janë të lidhura me tekstin që është në façoletën e dytë. Teksti i tretë nuk mund të lexohet as të kuptohet, nëse nuk i kemi lexuar dy tekstet paraprake. Në të njëjtën mënyrë fillon të shpallet porosia e fjalës së të njohurit, e cila, gradualisht gjatë shpalljes, plotësohet.”

#### **4. Kur duhet shfrytëzuar këtë**

Janë disa që tentojnë ta mohojnë këtë dhuratë për keqpërdorime të ndryshme. Unë mendoj kështu: pasi që kjo dhuratë na ndihmon që ta rrisim dhe ta forcojmë fenë, ndonëse disa e konsiderojnë të çuditshme dhe e braktisin, neve nuk guxojnë të na pengojnë keqpërdorimet e kësaj dhurate, por duhet të na mësojnë si ta përdorim këtë, në mënyrë sa më të drejtë. Askund nuk ka pasur aq keqpërdorime, sa ka pasur në sakramentin e pajtimit, por Kisha nuk e ka lënë atë. Diçka e ngjashme mund të thuhet për këtë dhuratë.

Disa mendojnë se kjo dhuratë nuk duhet të përdoret në publik, pasi që kryesisht bëhet fjalë për zbulimin e fshehtësive të zemrës; diçka ngjashëm me atë si ka vepruar Jezusi me samaritanen kur ia ka zbuluar jetën e saj dhe meshkujt e saj. Mendoj se kjo është vetëm një pjesë e kësaj dhuntie, e jo caku i vetëm dhe kryesor.

Në ripërtëritjen karizmatike, kjo dhuratë, shpesh

përdoret për të shpallur shërimin që Zoti e realizon në popullin e vet, gjë që i jep gëzim Zotit dhe ndihmon që të rritet feja. Nënkuptohej vetvetiu se fjala e të njohurit nuk guxon të përdoret në publik kur i zbulon mëkatet e ndonjë personi, sepse kjo do të sjellte shqetësime dhe jo bekime.

Prandaj, disa ipeshkvij dhe meshtarë nuk lejonë që të përdoret këtë dhuratë edhe pse si dhurat e prajojnë. Prandaj, do të ishte e përshtatshme, që para se të shërbehemi me këtë dhuratë, të kërkojmë nga ipeshkvi mendimin e tij për te. Për t'i evituar mosmarrëveshjet, duhet t'i mësojmë besimtarët për vetë dhuratën, para përdorimit të saj. Shumë mosmarrëveshje janë frytë i paditurisë. Kur shpjegohen të gjitha, dhuratë pranohet me kënaqësi.

### **Si të njihet autenticiteti i dhuratës**

Ungjilli na tregon metodën si të njohim autenticitetin e dhuratës së të njohurit: “Do t’i njihni prej fryteve të tyre” (Mt 7, 16). Frytet, rezultatet, janë mënyra e vetme për të njohur vërtetësinë e dhuratës. Prandaj, dëshmitë janë të rëndësishme. Përndryshe, do të na duket se dikush manipulon ose luan me psikologjinë e bashkësisë. Qëllimi që arrihet me dëshmi, është lavdia e Zotit dhe ndërtimi i bashkësisë. Prandaj, kur përdoret kjo dhuratë, duhet të përcjelllet me dëshmitë që do ta vërtetojnë. Është shumë me rëndësi përgjigjja e Jezusit, që ua ka dhënë nxënësve, që i ka dërguar Gjon Pagëzuesi, për ta pyetur se a është Ai Mesia apo të pritet një tjetër, e cila përgjigje

udhëzon në veprat e tij: “Shkoni e tregoni Gjonit çka po dëgjoni e çka po shihni: Të verbërit po shohin, të shqeptit po ecin, të gërbulurit po pastrohen, të shurdhëtit po dëgjojnë, të vdekurit po ngjallen, të varfërve po u predikohet Ungjilli” (Mt 11, 4-5).

Kjo përgjigje e Jezusit e vërteton vlerën e dëshmisë dhe tregon qartë, se Jezusi është Mesia që bën mrekullira. Në të njëjtën mënyrë, dëshmitë e vërtetojnë autenticitetin e “fjalës së të njohurit”.

### **Themeli biblik**

Jezusi është shërbyer shpesh me këtë dhuratë: e ka ditur se ç’ mendojnë farisenjtë dhe mësuesit e Ligjit (Lk 5, 22), populli (Lk 11, 17) dhe mësuesit e Ligjit (Mt 9, 4). Natanaelit ia zbuloi fshehtësitë (Gjn 1, 47-48) dhe samaritanes të kaluarën (Gjn 4, 16-18).

Shën Pali, shprehimisht e përmend këtë dhuratë në 1 Kor 12, 8: “Dhe njëmend, Shpirti Shenjt i jep njërit fjalën e urtisë, kurse i njëjti Shpirt Shenjt, një tjetri i jep fjalën e dijes.”

Në Besëlidhjen e Vjetër, gjithashtu takojmë në shembuj të këtyllë: Danieli e zbuloi akuzimin e rrejtshëm ndaj Suzanës (Dan 13), kurse Jozefit, Zoti ia zbulonte realitetin përmes ëndërrave (Zan 37, 40-41).

### **Dhurata e urtisë**

Fjala e të njohurit dhe dhurata e urtisë janë dy

karizma të ndryshme, ndonëse të ngjashme.

Dhuntia e urtisë nuk është asgjë tjetër, veçse realizim i fjalës së të njohurit.

E njëjta i ndodhë edhe orëtarit, i cili në praktikë e zbaton diturinë e vet dhe kështu dëshmon se është kompetent për të gjitha që kanë të bëjnë me “mjeshtrinë” e tij.

Urtia duhet të na bëjë me dije se ç’duhet të bëjmë me fjalën e të njohurit që e kemi pranuar. Në këtë mënyrë, Jozefi i Egjiptit, përmes urtisë është bërë ministër i parë i Faraonit (Zan 41, 37-57), kurse Danieli i ka zbuluar fajtorët e vërtetë, që e kanë akuzuar padrejtësisht Suzanën (Dan 13, 50-60).

Disa teologë e definojnë këtë karizmë si virtut mbinatyror, sipas të cilit, nën ndikim të Shpirtit Shenjt, gjykojmë për Zotin dhe punët e Zotit.

## **Dëshmitë**

Mendoj se fuqia e dëshmive më së miri i shpjegon këto dhurata dhe i bindë njerëzit lidhur me to.

**A.** Me rastin e aksidentit që e kam pasur në Panama, më janë ndrydhur e dyta dhe e treta unazë lumbale dhe kjo gjë më ka shkaktuar dhembje aq të mëdha, sa që më është dashur të kthehem përsëri në spital.

Në nëntorin e vitit 1983, në Santo Domingo, në Republikën Dominikane, u mbajt Kongresi Latinoamerikan i ripërtëritjes karizmatike. Megjithë dhembjet e mëdha të kurrizit, vendosa të marr pjesë

në të. Gjatë takimit të lutjes, ati Emilien Tardif, e tha lutjen për shërim të të gjithë pjesëmarrësve. Kur e nisi lutjen, e ndjeva një ngrohtësi në shpindë dhe nën bel. Në vete thashë: “Jam duke u shëruar sepse po ndiej ngrohtësi.”

Mirëpo edhe më tutje ndjeva dhembje. Duke e përfunduar lutjen, ati Tardif tha: “Në mesin e pjesëmarrësve gjenden disa persona që e posedojnë fjalën e të njohurit. Shfrytëzoheni në lavdi të Zotit dhe për të mirë të vëllezërve.”

Në një moment dikush tha: “Këtu gjendet një njeri që ka pësuar fatkeqësi komunikacioni dhe ndien dhembje në shpinë. Në këtë çast ndien ngrohtësi sepse Zoti është duke e shëruar.”

Mu në atë moment, dhëmbja u zhduk, edhe më shpejtë se pas aplikimit të injekcionit të morfiumit ose të ndonjë medikamenti tjetër. E falënderoj Zotin që më ka bekuar me këtë bekim dhe që ma ka vërtetuar efektin e fjalës së të njohurit, sepse deri atëherë, kam qenë vetëm mjet i saj.

**B.** Në Monterrey, në Meksikë, Gerardo Gonzales dhe Paty Olais, të martuar para disa viteve nuk kanë mundur të kenë fëmijë, Mjekët, më nuk u kanë dhënë shpresë. Në dhjetorin e vitit 1982, Zoti e ka dhënë këtë fjalë të të njohurit: “Këtu gjendet një çift bashkëshortor, të cilit, Zoti do t’i falë djalë. Gruaja do të mbetet shtatzënë pas pesë muajsh.” Në një rast të mëparshëm, përmes fjalës së të njohurit, u është paralajmëruar se do të fitojnë djalë më 1984.

Kah fundi i prillit, zonja filloi t’i blejë rrobat e nevojshme për shtatzani dhe për lindje të fëmijës.



Personat që kanë ditur për dëftimin e Zotit dhe që i kanë parë sjelljet e saj, megjithatë kanë dyshuar.

Më 1 maj, Ditën e Punëtorëve, ajo i tha burrit: “Meqenëse sot asgjë nuk punon dhe klinikat janë të mbyllura, nesër do të shkoj te mjeku që ta marr vërtetimin se jam shtatzënë!”

Të nesërmen shkoi te mjeku dhe analizat treguan se tanimë një muaj, është shtatzënë. U përmbush saktësisht ajo që ka thënë Zoti: “Pas pesë muajsh do të jesh shtatzënë!” Fëmija aq i dëshiruar, i pritur dhe i paralajmëruar, u lind më 1 janar 1984. Pas nëntë muajsh.

Pas disa ditësh, pata gëzimin që ta pagëzoj këtë fëmijë në famullinë e Zojës së Fatimës, në Monterrey, në gëzim dhe falënderim të Zotit, që e ka dëftuar këtë lindje.

C. Në Pompono Beach të Floridës, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka qenë një i ri që nuk ka qenë i sigurt në sjelljen e vendimit, a t’i vazhdojë studimet në Universitet, apo të hyjë në seminar dhe ta përqafojë meshtarinë që e tërhiqte.

Gjatë meshës shenjte, në fund të kongresit, në atë qytet, i riu i tha Zotit: “Nëse dëshiron që të bëhem meshtar, bën që përmes dhuratës tënde, këta vëllezër të thonë diçka për të riun që dyshon në thirrjen e vet.”

Me të kryer lutjen e vet, ai thotë se i ka dëgjuar këto fjalë: “Këtu është një i ri që dyshon në thirrjen e vet për meshtari. Mos u frikëso! Ki trimëri! Unë jam me ty dhe të dua! Dua të më ndihmosh dhe të më lavdërosh në lteret e mia!”

I riu thotë se nuk mund të shprehë me fjalë atë që

ka përjetuar në atë çast: zemra i ka rrahur, duart i janë ftohur, kurse djersa e ngrohtë ia ka mbuluar trupin. Ai ka vendosur dhe tani gjendet në seminar.

**D.** Në Buenos Aires (Argjentinë), një çift bashkëshortor, përmes fjalës së të njohurit, e ka pranuar dëftimin mbi lindjen e birit të tyre brenda dhjetë muajsh. Po e paraqes dëshminë, të cilën e kanë shkruar ata vetë.

“Bekojeni Hyjin dhe lëvdojeni Atë ndër sy të gjithë të gjallëve për të mirat që na i bëri! Bekojeni e lëvdojeni Emrin e Tij! Bëni që të gjithë njerëzit t’i dinë veprat e Zotit ashtu si ato e meritojnë! Mos pushoni duke iu falënderuar! Fshehtësitë e mbretit është mirë të mbahen si fshehtësi, por është nder të zbulohen e të shpallen veprat e Hyjit. Bëje të mirën e s’do t’ju gjejë asnjë e keqe!” (Tob 12, 6-7).

Dëshirojmë të falënderojmë Zotin publikisht dhe të paraqesim atë që na ka bërë Zoti.

Në katër vitet e para të bashkëshortësisë tonë, nuk kemi mundur të kemi fëmijë, ashtu që u jemi drejtuar mjekëve. Gjatë kësaj kohe, nuk kemi pushuar të lusim Zotin, duke kërkuar hirin e prindërisë. Shumë njerëz, gjithashtu janë lutur për ne, në meshë, ruzare dhe nëntëshe, në Argjentinë dhe jashtë vendit.

Të dielën e parë të shtatorit 1978, sipas zakonisht të famullisë së Trinisë Shenjte, u çua mesha shenjte për ripërtëritje karizmatike. Pas kungimit, me të pranuar të Bukës së jetës, ushqimit të fuqishëm të shëlbimit dhe mëshirës së Zotit, Korpit të vërtetë dhe Gjakut të

vërtetë të Jezusit të Ringjallur, meshtari që e thonte meshën, u lut për të sëmurët. Në atë lutje, meshtari tha se në zemër ndiu, se Zoti do t'ia dhurojë një djalë çiftit bashkëshortor që ka kohë që lutet për këtë hir. Pas dhjetë muajsh do ta sjellin në kishë që ta shohin të gjithë.

Kur përfundoi mesha shenjte, shumë njerëz na uruan; por, a ka të bëjë kjo me ne? Diçka më thoshte se po. Disa na shikonin çuditshëm dhe duke qeshur na thoshin: “Do të shohim!”

Disa ditë pas kësaj meshe, gruaja ime iu nënshtua kiretimit të mitrës, pas një terapie kundër sterilitetit. Ia dërguam rezultatet mjekut tonë, ia treguam lakoren e temperaturës dhe i thamë se në ç'gjendje është bashkëshortja ime, kurse ai tha: “Gruaja juaj është shtatzënë, por duhet t'i bëjmë edhe disa analiza që të vërtetohemi. Në njëzet vite të punës sime mjekësore, të dytën herë hasi në kesi rasti.”

Dhe me të vërtetë, gruaja ime mbeti shtatzënë, pas katër vitesh pritjeje dhe shpresimi në fe, dhe fëmija nuk u humb, megjithë kiretimin e mitrës.

Fëmija u lind në mënyrë natyrore, të dielën më 27 maj, në ditën e Të Ngjiturit të Krishtit në Qiell. Fëmija ka peshuar tre kilogram dhe ka qenë i gjatë pesëdhjetë e dy centimetra.

Duhet të falënderojmë Zotin për shumë gjëra të mrekullueshme që na ka dhënë në jetën tonë, prej të cilave, ky rast është i posaçëm. Kemi fituar edhe dhunti tjera që e kanë mundësuar këtë lindje.

Zoti na ka shpëtuar nga frika, ankthi, dëshpërimi, vetmia, mungesa e kuptimit në bashkëshortësi, marrëdhëniet e këqija me prindërit tanë, mungesa

e pranimit të vetvetes, mungesa e interesimit për të afërmin. Njëmend, nuk kemi arritur deri te caku përfundimtar. Përpiqemi më shumë se kurdoherë që mos ta humbim shpërblimin përfundimtar.

Rrugët e Zotit nuk janë rrugët tona. Ai ka plan për secilin prej nesh, dhe atë nuk na imponon, por, na fton që t'i dorëzohemi. Prej nesh varet a do t'i japim përgjigje apo jo. Nëse i kundërshtojmë planit të Zotit, nuk mund të llogarisim me mëshirën e Zotit.

Vetëm Krishti e mëson njeriun si të bëhet njeri, si të jetojë si njeri dhe çka është kuptimi i të gjithave. I lumtur është njeriu që jeton në Krishtin.

Jorge Herndn dhe Kako Merono

Të dielën e parë të korrikut 1979, gjatë meshës mujore të ripërtëritjes karizmatike, në famullinë e Trinisë Shenjte, në Buenos Aires (Argjentinë), u pagëzua fëmija i familjes Merono, dhjetë muaj pasi që Zoti tha se do ta sjellë që ta shohim.

**E.** Në një kishë, në Argjentinë, gjatë lutjes për shërim, Zoti, përmes fjalës së dijës, tha: “Në anën e majtë të kishës, pranë shtyllës së parë, qëndron një mjek që nuk është argjentinase dhe këtu është me fëmijët e vet. Të gjitha i vështron në mënyrë kritike dhe përbuzëse. Zoti dëshiron që menjëherë, sonte, të pendohet për mëkatet e veta dhe ta pranojë Jezu Krishtin për Zot të jetës së vet dhe të familjes së vet. Jezusi dëshiron ta shpëtojë dhe përmes tij, ta shpëtojë

edhe gruan dhe fëmijët e tij.”

Pas Eukaristisë, ky njeri iu afrua Iterit dhe u prezentua: “Unë jam mjeku kolumbias për të cilin folët. Gati nuk mund të besoj se ndodhi kjo gjë. Jam i tronditur thellësisht. Qysh sonte do ta bëj këtë që tha Zoti.”

Disa ditë më vonë, e mora këtë letër nga ai:

San Bernardo, 12 dhjetor 1981

### **I nderuari pater Dario!**

Unë jam mjeku kolumbias, që me frikë, pabesi dhe kuriozitet ju kam dëgjuar në kishë, se si flitnit gjithçka për mrekullitë, shërimet dhe Zotin. E pyesja veten: a është parapsikologji, terapi grupi, sugjestion, apo është me të vërtetë diçka mbinatyrore, që i përket Atit qiellor? Kur ke fe, të duket se e prek qiellin me duar tua dhe i sheh veprat e mrekullueshme të Zotit.

Nuk deshta të ju shkruaj para se i rregullova, pas shumë vitesh, logari, hesapet me Zotin tim. Pasi mendova me pjekuri, u kungova më 8 dhjetor. Ishte kjo dita e kungimit tim të parë, që e mora në Kolumbi, më 1936.

Pasi po afrohen Kërshëndellat, unë do të kungohem, së bashku me bashkëshorten dhe me fëmijët e mi të rritur. Tre djem janë mjekë, dy prej të cilëve po përgatiten të marrin kungimin e parë në Javën e Madhe. Fëmija i katërt është vajzë, inxhinjere,

dhe ajo tanimë është kunguar.

Tërë familja Salazar, e lut Zotin që frytet e atit Dario, të jenë çdo herë e më të begatshme.

Me dashuri ju përqafton dhe ua uron Kërshëndellat, familja Salazar!

J. D. S. C.

## KAPITULLI IX.

### SI SHËRON ZOTI

Natyrisht se çdo krijesë, që është dëshmitare e veprave të mrekullueshme të Zotit, e shtron pyetjen: “Si u bë kjo? Si e bëri këtë Zoti?”

Kur shpjgohen veprat e Zotit, atëherë, njerëzit më me lehtësi besojnë në Zotin. Shën Pjetri me urtësi thotë: “Jini gjithmonë të gatshëm t’i jepni përgjegje gjithsecilit që prej jush kërkon arsyen e shpresës që është në ju, por me butësi dhe nderim të duhur...” (1 Pjt 3, 15-16)

Janë shumë ngjarje misterioze, shpjgimi i të cilave e tejkalon të kuptuarit tonë. Dhe ne i pranojmë. Por janë edhe ngjarjet tjera, të cilat mund t’i shpjgojmë dhe ky shpjgim na ndihmon në ndërtim të fesë. Kemi shembullin e shërimit të “të verbërit të lindur të verbër”: ata që e pyetnin si ndodhi mrekullia, ai thjeshtë dhe qartë ua paraqiste ngjarjen (Gjn 9).

Veprat e Zotit, ndonëse na duken të rënda dhe misterioze, nganjëherë mund të shpjgohen thjeshtë. Shumë njerëz nuk i pranojnë dhe nuk besojnë në to, sikur edhe farisejtë që e pyetnin të verbërin.

Në një kongres të mjekëve dhe karizmatikëve, në Santiago (Argjentinë), disa mjekë, pasi kanë qenë dëshmitarë të mrekullive hyjnore, gjatë lutjes për shërim, të çuditur dhe të habitur pyetën: “Në ç’mënyrë

Zoti i bën këto vepra të mrekullueshme?” Përgjigjet që i kanë marrë, jo vetëm që nuk i kanë kënaqur, por, disa prej tyre kanë tentuar t’i shpjegojnë këto fakte me ndihmë të shkencës mjekësore.

T’i analizojmë tani tre mënyrat e shërimit që i zbaton Zoti.

## **I shfrytëzon mjetet që gjenden në ne**

Nganjëherë, Zoti e përdorë autosugjestionin për të na shëruar.

Një parim filozofik thotë: “Zoti nuk i shumëzon krijesat pa nevojë”, që do të thotë se Ai, nuk vepron drejtpërdrejt, nëse këtë mund ta bën përmes diçkahit që tanimë ekziston në ne.

Në frymë të fesë dhe lutjes, Zoti mund ta zmadhon “sugjestionin” tonë deri në atë masë, saqë na shëron përmes tij. Kjo gjë mund të ndodhë përmes fjalës bindëse të predikuesit, përmes dëshmisë, përmes bashkësisë fetare etj. Në shumë lutje për shërim, ka persona që janë shëruar në këtë mënyrë. Duhet ta kemi të qartë se nuk na shëron sugjestionin, por Zoti, duke e shfrytëzuar atë si mjet. Nuk guxojmë të përziejmë fenë me sugjestionin. Këto janë dy gjëra të ndryshme.

Në të vërtetë, shumë persona sëmuren përmes autosugjestionit, atëherë, përse Zoti, nuk do të mundte të na shërojë përmes autosugjestionit? Megjithatë, duhet të themi se, sikurse autosugjestionin nuk është shkaku kryesor i sëmundjes, ashtu edhe nuk mund të ndihmojë gjithmonë në shërim.

Nëse edhe është fjala për sugjestion, Zoti nuk



humb në dinjitetin e vet, nëse vjen deri te shërimi. Së fundi, a thua mjetet të cilat i shfrytëzon Zoti në shërim të të sëmurit, janë vendimtare? (Në një moment, Jezusi e ka shfrytëzuar edhe baltën për ta shëruar të verbërin).

Shkenca, gradualisht është duke i zbuluar aftësitë dhe energjitë e reja, të cilat, Zoti i ka rrënjosur në trupin tonë gjatë krijimit, psikologjia tërë kohën kërkon shpjegime për këto fenomene dhe orvatet t'i shpjegojë disa raste të shërimit. Për besimtarin, kjo nuk është vendimtare. Me psikologji nuk mund të shpjegohen të gjitha ngjarjet, e më së paku veprat e Zotit.

Duhet përdorur dhurata e fesë, e cila është mbi arsyen dhe në momentin e caktuar duhet të vërejmë veprimtarinë e Zotit, e cila mund të shfrytëzojë mjete të ndryshme.

Në famullinë e Zonjës Ndihmëtare, në Cuenca (Ekuador), ndodhi ky rast.

Një zonjë ka banuar në mal, larg nga qyteti dhe në radio ka dëgjuar se në kishën e Zonjës Ndihmëtare mbahen misionet. Zonja ka qenë e paralizuar një kohë të gjatë dhe nuk ka mundur të ecë, ashtu që e luti dikend që ta mbartë deri atje, e të merr pjesë personalisht në misione. Me të hyrë në kishë dhe me të parë një mori njerëzish që këndonin dhe e lëvdonin Zotin, si dhe zjarrin në fytyrat e tërë atij populli, e ndjeu një gufim në zemër dhe menjëherë ia përfshiu trupin ngrohtësia. Në të njëjtën kohë filluan të lëvizin të gjitha gjymtyrët e saj, kurse dhembja, me ngadalë zhdukej. Pasdite, pas rrëfyerjes sakramentale dhe pasi u vajua, gruaja u shërua tërësisht.

## **Zoti i shfrytëzon mjetet që janë jashtë nesh**

Zoti, gjithashtu, i shfrytëzon edhe mjetet që janë jashtë nesh: mjekët dhe medikamentet. Kush mund të dëshmojë se nuk është shëruar me terapi të rregullt mjekësore? Shkrimi Shenjt, në shumë vende, dëshmon se si Zoti, përmes këtyre mjeteve, shëron.

### **Përmes mjekëve**

“Nderojë mjekun sikurse i takon, sepse edhe atë e ka krijuar i Tejlarti” (Sir 38, 1).

Zoti urdhëron që të kërkohet ndihma mjekësore dhe të nderohet mjeku, ashtu që t’ia tregojmë dhembjen tonë. Për shkak “se ke nevojë për të”. Duket se thotë: Unë të shëroj përmes mjekut.

“Prej të Tejlartit ai e ka dijen edhe prej mbretit ai merr dhurata” (Sir 38, 2).

Zoti ia ka dhënë mjekut dhuntinë e shërimit ashtu si ia ka dhënë pushtetit civil dhuntinë e administrimit.

“Po edhe ata i luten Zotit që t’i drejtojnë në njohjen e vërtetë e ta shpejtojnë shërimin” (Sir 38, 14).

Këto fjalë na tregojnë qartë se si Zoti shëron përmes mjekëve.

Në një kongres të mjekëve, në Santiago (Argjentinë), u tha lutja për shërim të mjekes dr. Ana Solorzano. Ajo e ka shkruar këtë dëshmi:

“Jam 40 vjeçe. Jam mjeke. Prej tetorit 1978 jam e sëmurë nga ishiasi. Qysh në nëntor kam pasur të

kallurit e nyjeve. Prej janarit 1979 deri në qershor të të njëjtit vit, sëmundja i përfshiu të gjitha nyjet, në duar, gjunjë dhe këmbë. Kam pasur dhembje të mëdha në muskuj. Gati u bëra invalide. I vizitoja specialistët e vendit dhe ata të huajt, por pa kurrfarë suksesi. Më kanë mjekuar me aspirina, në të cilat jam alergjike. Më kanë mjekuar kundër të kallurit dhe dhembjeve, por pa sukses. Vetëm se dhembjet më janë zvogëluar paksa. Terapia me betametadon e ka nxitur në mua sëmundjen e artritis reumatika, e cila gjendjen time të rëndë e ka rënduar edhe më. Kam qenë, pra, e sëmurë nga të kallurit reumatik të nyjeve. Të kallurit më ka shtrembëruar dhe më ka bërë invalid të rëndë. Dhembja dhe palëvizshmëria që i bijnë barrë njeriut në ditët më të mira të jetës së tij, e hedhin në depresion dhe i shkaktojnë dhembje të pandërprerë, e cila nuk pushon as pas marrjes së medikamenteve të forta, gjë që mund të sjellë deri te vetëvrasja.

Unë jam e krishterë, katolike. Megjithë mjerimin dhe vuajtjet e mia, nuk ia kam kthyer shpinën fesë dhe mendoj se ajo më ka mbajtur në jetë.

Kam marrë pjesë në mbledhjet e seminareve të Ripërtërimit karizmatike, duke kërkuar më shumë ndihmë shpirtërore se fizike, sepse për ndihmën shpirtërore kam pasur më shumë nevojë. Të shtunën, më 7 maj, kam marrë pjesë në mbledhje, së bashku me mjekët. Me atë rast u tha lutja për shërimin tim dhe prej atij çasti dhembjet më pushuan, nyjet e bërrylave dhe të duarve u bënë më të lëvizshme, edemet e ujit u zvogëluar, sikurse edhe tkurrja e nyjeve, e këto janë simptome tipike të kësaj sëmundjeje. Tani, kohë pas kohe e marr ndonjë analgetik, flej mirë pa dhembje, e

këtë nuk kam mundur ta bëj gati pesë vite. Ende nuk jam shëruar nga dhembjet që i ndiej në të dy gjunjët, më shumë në të majtin, kur eci (këto dhembje nuk i ndiej kur pushoj).

Si mjeke, pranoj se çdo gjë që më ka ndodhur, nuk mund të shpjegohet në mënyrë shkencore. Aspak nuk dyshoj se lutja që është thënë për mua, e ka sjellur këtë shërim që e kam kërkuar shumë vite me radhë dhe atë pa sukses.

Ana Solorzano

### **Përmes barnave**

“I Tejlarti nga toka i krijoj barnat e njeriu i mençur nuk i ka në iri” (Sir 38, 4).

Disa gjëra të krijuara, siç janë barnat, bimët, kanë cilësi shëruese, e këto i kanë fituar nga Zoti. Efektet e mëdha të barnave modeste dhe të mospërfillshme që përdoren në mjekësi, janë në përputhje me mësimin biblik.

“Vet i Tejlarti u dha dije njerëzve që të lavdërohej me mrekullitë e veta. Me to bëhen shërime e zbuten dhimbjet, baranatori bën përzirje barnash e kështu s’ka mbarim për veprat e tija” (Sir 38, 6-7).

Falë barnave, shumë njerëz shërohen. Teksti që vijon flet qartë për atë se si Zoti shëron përmes barnave:

“Frutat që do të jenë për ushqim e gjethet do të përdoren për barna” (Ez 47, 12).

Ezekieli profet, në profeci flet dhe i vështron elementet e jetës së përditshme, në të cilën për barna

përdoren bimët e krahinës dhe të kohës së caktuar.

### Balzëmi

“Në Galead thua më s’ka balzëm? S’ka atje thua asnjë mjek? Pse atëherë nuk u përtha vrraga e bijës së popullit tim?” (Jer 8, 22).

“Merrni balzëm për dhimbë të tij, se mos shërohet” (Jer 51, 8).

### Vaji

“Ia lidhi plagët duke ia pasë larë me verë e me vaj” (Lk 10, 34).

“Lyenin me vaj shumë të sëmurë dhe i shëronin” (Mk 6, 13).

“Ata le të luten mbi të duke e lyer me vaj në emër të Zotit” (Jak 5, 14).

Është zakon i vjetër që njerëzit e përdorin vajin për t’i ngrohur dhe forcuar muskujt.

### Vera

“Mos pi më vetëm ujë, por pi ngapak verë për shkak të stomakut dhe të sëmundjeve të tua të shpeshta” (1 Tim 5, 23).

“Ia lidhi plagët duke ia pasë larë me verë e me vaj” (Lk 10, 34).

Në kohët biblike, vera është përdorur si dezinfektues, me gjasë për shkak të alkoholit që përmban.

### Bekimi i barnave

Në Ritualin Romak është një uratë e bukur me

të cilën bashkohet bekimi hyjnor i barnave. Shumë mjekë dëshmojnë se pas lutjes për barna, janë zhdukur efektet e padëshirueshme dhe se efekti i tyre terapeutik është treguar edhe më i suksesshëm. Ja bekimi:

- Ndihma jonë është në emër të Zotit.
- Që e krijoi qiellin dhe tokën.
- Zoti qoftë me ju.
- Dhe me shpirtin tënd.

Të lutemi. Zoti ynë, që e ke krijuar njeriun aq mrekullueshëm dhe, edhe më mrekullueshëm e ke ripërtëritur, denjohu që t'i ndihmosh nevojës njerëzore dhe tokësore të fëmijëve të tu që vuajnë nga sëmundje të ndryshme. Dëgjo lutjet tona dhe beko këto instrumente mjekësore dhe këto barna, që ata që i marrin, të njohin në trupin dhe shpirtin e tyre vërtetësinë e provanisë tënde. Ti ke shëruar aq sëmundje përmes birit tënd Jezu Krishtit dhe mbretëron me të dhe me Shpirtin Shenjt në amshim. Amen.

(Stërpiket me ujë të bekuar).

Ose, kjo lutje:

Të lutemi. O Zot, ti ke krijuar mrekullueshëm njeriun dhe edhe më mrekullueshëm e ke ripërtëritur, ti je denjuar që me barna të shumëllojshme t'u ndihmosh njerëzve të vdekshëm në sëmundjet e ndryshme: ki mëshirë për lutjet tona dhe zbraz nga qielli bekimin e shenjtë në këtë medikamente, ashtu që ai që e merr (ata që e marrin), të meriton (meritojnë) shëndetin shpirtëror dhe trupor. Nëpër Krishtin, Zotin tonë. Amen.

(Dhe le të stërpiket me ujë të bekuar).

/Rimski obrednik Pija XI. , Zagreb 1929. /

Në Tijuanë (Meksikë), Carmelita de Valero-s i është dashur të merr një medikament që e ka vënë në gjumë, ashtu që ajo nuk ka mundur t'i kryejë obligimet e bashkëshortes dhe nënës. Atëherë, bashkëshorti i saj Jose Valero, mjeku, Carmelita dhe unë, e thamë lutjen mbi barna. Të nesërmen, kjo grua nuk e ka pasur më ndjenjën e gjumësisë dhe ka qenë e lumtur që ka mundur të na shërbejë me dashuri dhe kujdes.

Shoqata e mjekëve të krishterë

Mjekët e krishterë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e hulumtojnë fuqinë e lutjes në mjekësi. Ata obligohen se do të bashkojnë lutjen për shërim me ndihmën profesionale mjekësore ashtu që të arrihet shërimi i fizik- trupore

(që mjekon mjeku) psikik (me këtë fjal mendojm atë pjes e njerit të cilin mjekon psikijatar-mendja, vulnesa, ndjenja) dhe shpirtit (pjesa e njeriut ku na ndihmon meshtar ose një person e Zotit) si ndergjegja, falja, pajtimi.

Në këtë shoqatë janë të mbledhur ekspertët e mjekësisë. Prandaj, këtu po e paraqes adresën e zyrës kryesore të shoqatës, ashtu që mjekët që dëshirojnë këtë, të kanë mundësinë t'i drejtohen:

Association of Christians Therapist

3700 East Avenue

Rochester, New York 14618 – U. S. A.

Jemi të lumtur, që në këtë çast, anembanë botës, takohen ekspertët, ashtu që t'i luten Zotit që t'ua

shndritë punën mjekësore.

### **Zoti shëron edhe drejtpërdrejt, pa përdorim të mjeteve**

Zoti na shëron edhe drejtpërdrejt, pa kurrfarë mjetesh. Kjo, mënyra e tretë, është mënyra më diskrete, më pak e njohur, por, Zoti e shfrytëzon edhe këtë. Në këtë mënyrë e zbulojmë mrekullinë, me plotkuptim të fjalës. Kjo mrekulli ka fuqinë për ta zgjuar fenë personale.

Në Romë jam njoftuar me një rregulltare të kongregates të Marisë, e cila, mrekullisht është shëruar nga kanceri i jashtëm në kokë, përmes ndërmjetësisimit të Themelueses së kongregates. Motra e nderit më ka thënë se ka parë në ëndërr se si nga qielli, në re, zbret e lumja Juana Del Stonac, e cila ia ka prekur kokën dhe i ka thënë: “Bijo, Zoti të ka shëruar.” Kur është zgjuar, e ka parë se është e shëndoshë dhe se plagët i janë shëruar tërësisht. Kjo mrekulli është konfirmuar nga Kongregata për shpallje të të lumëve. Juana Del Stonac është kanonizuar nga Papa Piu XII, më 1950.



## KAPITULLI X.

### A MUNDET TË SHËROJË DJALLI?

Nuk dëshiroj të zhvilloj këtu një studim teologjik mbi këtë “qenie të gjallë, këtë mashtrues të prishur shpirtëror. Realitet i tmerrshëm, misterioz dhe i llahtarshëm”, siç e ka quajtur Pali VI, në katehezën e 15 nëntorit 1972. Ose siç e ka përshkruar Jezusi: “Ai qe vrastar njerëzish që në fillim, nuk mundi të qëndrojë në të vërtetën, sepse në të nuk ka të vërtetë. Sa herë rren, flet prej natyrës së vet sepse është rrenacak dhe babai i rrenës” (Gjn 8, 44).

Dëshiroj t’i paraqes disa mendime nga përvoja ime pastorale.

Tetë ditë para fatkeqësisë që e përjetuam në Panama, kam predikuar në një famulli në Nev York për mashtrimet djallëzore, siç janë horoskopet, shenjat e zodiakut, amulletet, talismanet, amajlitë, gjërat që “sjellin fat”, parashikimet e ardhmërisë, joga, falli, magjitë etj, në përgjithësi për gjërat që na pengojnë të shijojmë dashurinë e Zotit.

Kam folur për atë se Djalli orvatet që ta imitojë fuqinë shëruese dhe shpëtuese të Jezu Krishtit, duke i mashtruar kështu, posaçërisht ata që nuk janë në rrugë të Zotit dhe ata që nuk e njohin atë.

Të njëjtën mbrëmje, në tryezën prej nga kam predikuar, e gjeta një dhuratë të bukur, të mbështjellur

me shije dhe me mbështjellëse të bukur. E hapa kutizën me kujdes dhe e gjeta figurinën e shën Lazrit me kokë, duar, e këmbë të thyera dhe me vërejtjen: “Babalu le të dënojë për të gjitha ato që ke thënë kundër tij” (Shortarët nga SHBA-të e quajnë shën Lazrin me emrin Babalu”).

Pra, në mesin e të pranishëmve ka qenë ndonjë adhurues i flakët i djallit, që ka dashur të më frikësojë, ashtu që të mos flas më për këtë temë.

Tetë ditë më vonë kam përjetuar aksidentin e komunikacionit në Panama, për të cilin tanimë kam folur, në të cilin, katër persona dhe unë kemi pësuar lëndime dhe thyerje të shumta.

Ua kam treguar këtë ngjarje personave të ndryshëm dhe secili prej tyre më ka dhënë mendim të ndryshëm. Sa më përket mua, unë nuk dyshoj në atë se Zoti ka lejuar që kjo fatkeqësi të ndodhë, ashtu që ta tregojë fuqinë e vet të madhe. Nëse Djalli është i fuqishëm, Zoti, me siguri është më i fuqishëm se ai. “Sepse është më i fortë Ai që është në ju se ai që është në botë” (1 Gjn 4, 4).

## **Ekzistimi dhe fuqia e Djallit**

Njëherë, në Nev York, më kanë ftuar në një shtëpi që të lutem, sepse në të ndodhnin gjëra të çuditshme. Derisa luteshim në dhomë të pritjes, dëgjonim në kuzhinë si binin pjatat në dysheme, si punonte makina për lëngje në shpejtësinë më të madhe, kurse përbrenda mureve binin gurë (shumica e shtëpive në SHBA janë të ndërtuara me mure boshe). Pas lutjes,

zhurma pushoi.

Që të vërtetohemi në fuqinë e djallit, mjafton t'i përkujtojmë disa tekste biblike:

“Atëherë, faraoni i grishi të dijsmit dhe dijësit; po edhe magjistaret e Egjiptit me shortitë e veta bënë po ashtu” (Dal 7, 11).

“Sepse do të paraqiten mesi të rrejshëm e profetë të rrejshëm dhe do të tregojnë shenja të mëdha e të çuditshme, aq sa t'i gënjejnë, po të ishte e mundur, edhe të zgjedhurit” (Mt 24, 24).

“Një ditë, ndërsa po shkonim për t'u lutur, na takoi një skllave që kishte shpirtin e magjisë dhe, duke ushtruar mjeshtrinë e magjisë, zotërinjve të vet u sillte shumë fitesë” (Vap 16, 16; lexo më tutje deri në rreshtin 25).

“Dragoi ia dha fuqinë e vet, fronin e vet dhe një forcë të madhe...dhe të gjithë e adhuruan Dragan që i dha Egërsirës një pushtet të tillë. E adhuruan edhe Egërsirën dhe thoshin: ‘Kush është si Egërsira!? Kush do të ketë guxim të luftojë kundër saj?!’... Ajo ushtron tërë pushtetin... Ajo bën shenja të mëdha: deri edhe zjarrin e bën të ulet nga qielli përmbi tokë ndër sy të njerëzve. Gënjeu banuesit e tokës me shenja që iu dha pushteti t'i bëjë...” (Zb 13, 2-4, 12, 13, 14).

Djalli ka fuqi të madhe. Mos të harrojmë se është shpirt i dënuar, që e ka ruajtur natyrën e engjëllit dhe prandaj, është më i lartë se ne, por është i nënshtruar nga Zoti sikurse çdo krijesë.

Në një qytet në Venezuelë, e kemi takuar një vajzë që vuante nga ankthi dhe frika. Na tregoi se e ka pasur një tumor të vogël në qafë, i cili i ka shkaktuar dhembje të mëdha dhe se për shkak të shërimit, ka marrë

pjesë në një seansë spiritiste, në të cilën është ftuar shërbëtori i Zotit, Jos Hernandez (mjek venecuelas, emri i të cilit shfrytëzohet në seansa spiritiste që të arrihet shërimi). Në atë seansë, tumori është zhdukur dhe ka mbetur një vurratë e vogël. Ajo, njëkohësisht, e ka humbur paqen dhe lumturinë. Djalli, kështu e ka kompensuar shërimin e vet.

Përse të kërkohet ndihmë nga të vdekurit ashtu që t'u ndihmohet të gjallëve? Përse nuk e kërkojmë nga Zoti ndihmën e nevojshme? Djalli i mashtron njerëzit me spiritizëm, ashtu që të kërkojnë ndihmë nga të vdekurit, në vend se t'i drejtohen Zotit dhe të gjallëve (krah. Is 8, 19).

### **Magjistarët dhe falltarët nuk e flasin të vërtetën**

“Urdhërova: le të më sillen të gjithë dijetarët e Babilonisë për të ma zhvilluar ëndërrën. Atëherë erdhën dijës, magjistarë, kaldenj, shtjellues shenjash. Unë ua tregova ëndërrën, por ata s'ditën të ma japin spjegimin” (Dan 4, 3-4).

“Baba juaj është djalli e ju dëshironi të kryeni vullnetin e babait tuaj. Ai qe vrapar njerëzish që në fillim, nuk mundi të qëndrojë në të vërtetën, sepse në të nuk ka të vërtetë. Sa herë rren, flet prej natyrës së vet sepse është rrenacak dhe babai i rrenës” (Gjn 8, 44).

Mjafton të përkujtojmë rrenën që ia ka thënë Evës në parajsën tokësore, ashtu që të njohim fuqinë

bindëse të tijën kur rren.

“Sepse shumë profetë të rrejshëm janë shpërndarë nëpër botë” (1 Gjn 4, 1).

“Çdo gjë shqyrtoni me kujdes: mbani të mirën!” (1 Sel 5, 21).

### **Zoti na paralajmëron që të kemi kujdes**

Djalli u jep fuqi mbinatyrore dishepujve të vet dhe atë, në të njëjtën mënyrë sikurse Shpirti Shenjt kur u jep karizmë besimtarëve. Prandaj, është me rëndësi që të jemi të kujdesshëm.

“Dhe nuk keni pse të çuditëni. S’keni, pra, pse të çuditëni në qoftë se edhe punëtorët e tij marrin dukjen e jashtme të punëtorëve të drejtësisë” (2 Kor 11, 14-15).

“Sepse njëherë duhet të ndodhë rënia nga feja (apostazia) dhe të shfaqet Njeriu i fajit, biri i Bjerrjes...I Paudhi do të vijë me pushtetin e Satanit dhe do të bëjë gjithfarë mrekullish, shenjash dhe çudish të rrejshme” (2 Sel 2, 3. 9).

“Shpirti Shenjt shpall botërisht se në kohën e fundit disa njerëz do t’i bien mohit fesë dhe do t’ju besojnë shpirtave të rrejshëm dhe mësimëve të frymëzuara nga djajtë” (1 Tim 4, 1).

“Të dashurit e mi! Mos i besoni çdo shpirti, por vini në provë shpirtat për t’i vërtetuar a janë të Hyjit, sepse shumë profetë të rrejshëm janë shpërndarë nëpër botë. Me këtë mund ta njihni shpirtin që vjen prej Hyjit: çdo shpirt që dëshmon se Jezu Krishti ka ardhur në trup, është prej Hyjit. Kurse çdo shpirt që nuk e dëshmon Jezusin të tillë, nuk është prej Hyjit: është prej Antikrishtit”

(1 Gjn 4, 1-3).

Vini re se si shën Gjoni nuk thotë “që beson se Jezu Krishti ka ardhur në trup”, por “ që dëshmon se Jezu Krishti ka ardhur në trup”. Nuk është njëlloj të besosh dhe të dëshmosh (= të njohësh). Shumë njerëz besojnë në Jezu Krishtin, por nuk e njohin për Zot dhe Shëlbues të tyre. Është ky dallim i madh!

Në një seansë spiritiste, e pyetën shpirtin e të vdekurit, a beson në Jezu Krishtin, ndërsa ai tha se beson dhe e përshkroi tërë jetën e Jezusit, prej lindjes deri në vdekje. Por kur e pyetën, a e njeh Jezusin për njeri të vërtetë, me hidhërim u tërhoq dhe nuk përgjigji asgjë.

Zoti na mëson si të sjellemi me të vdekurit, shortitë, magjitë, fallet, astrologjinë, parashikimet e ardhmërisë etj.

“Mos ushtroni as shorti as magji. Mos u ktheni kah shortarët e dijësit që të mos bëheni të papastër me anën e tyre. Unë jam Zoti, Hyji juaj” (Lev 19, 26. 31).

“Ruhu e mos të pëlqejnë punët e poshtra të atyre popujve. As të mos gjendet ndokush ndër ju që ta bëjë të kalojë djali ose vajza e tij nëpër zjarr, që të merret me shorti, me shqyrtim resh, me këqyrje shpatullash, që të bëjë magji, që të shqitojë, që të thërrasë shpirtrat e të vdekurve; sepse të gjitha këto i urren Zoti... Kurse ti ke qenë mësuar ndryshe prej Zotit, Hyjit tënd” (Lp 18, 9-12. 14).

“Do t’ju afrohem në gjyq e do të jem dëshmitar i gatshëm kundër magjistarëve, kurorëshkelësve...” (Mal 3, 5).

Lidhjet me shpirtrat e të vdekurve janë tejet të rrezikshme sepse mund të ndodhë që shpirtrat e këqij,

t'i kaplojnë personat që u drejtohen. Ai që kërkon këshillë nga të vdekurit, i shkelë Urdhërimet e Zotit dhe kalon në anën e armikut.

Që kur Djalli e tha rrenën e parë në Eden dhe ia arriti që t'i bindë Adamin dhe Evën se nuk do të vdesin nëse bëjnë atë që ua propozon, ai nuk pushoi së shfrytëzuar frikën njerëzore nga vdekja për t'i bindur njerëzit se të ndjerët nuk janë të vdekur dhe se njerëzit nuk vdesin. Idhujtaria, paganizmi, spiritizmi, okultizmi dhe gjërat e ngjashme, kanë të bëjnë me vdekjen.

Të gjitha këto na shërbejnë si vërejtje që të qëndrojmë larg nga të gjitha këto gjëra. Ndonëse premtimet e Djallit janë lajkatore dhe tërheqëse, gjithmonë sjellin deshprim, mundime dhe depresion, sepse na largojnë nga Zoti, duke na zhytur në pabesi dhe mëkat. Premtojnë jetën duke e mohuar vdekjen dhe e arsyejnë, sa për sy e faqe, rrenën që e ka thënë Djalli në parajsën tokësore: “Nuk do të vdisni asses!” (Zan 3, 4). Spiritizmi i shndritë ata që janë të dobët në fe dhe ata që nuk dinë si t'i zgjidhin problemet e tyre.

Të paramendojmë se e kemi humbur një person të dashur. Atëherë na duket se shtëpia jonë dhe tërë bota jonë gjenden në errësi. Ardhmëria na duket e mjegulluar, e turbullt! Po të mundeshim me ndihmë të ushtrisë ta kthejmë personin e dashur, këtë edhe do ta bënim. Spiritizmi vjen mu në atë çast, kur jemi të shkrirë nga lotët, të qarit dhe pagjumësia, kur jemi shpirtërisht dhe fizikisht të dobët dhe, na ofron përgjigjen, e cila, më shumë do të na dëmtojë se që do të na ndihmojë.

## **Ndëshkimi për magjistarët dhe spiritistët**

Besoj se ndëshkimi më i madh, me të cilin Zoti mund ta ndëshkojë një person, është ai kur e braktisë një person dhe e len të bëjë atë që nuk guxon. “Mbasi e çmuan se për ta nuk vlen të jetojnë si mëson Hyji, vetë Hyji lejoi që ta ndjekin mendjen e tyre të prishur, e kështu të bëjnë çka nuk u ka hije” (Rom 1, 28). Sikur është lodhur Zoti duke e ofruar dashurinë e vet, e cila nuk është pranuar dhe, e tërheqë dhuratën e vet.

“Ai njeri që t’usillet shortarëve dhe magjistarëve... unë do të jem kundër tij dhe do ta zhbij nga gjiri i popullit të vet” (Lev 20, 6).

“Idhujtaria, magjia... nuk do ta trashëgojë Mbretërinë e Hyjit” (Gal 5, 20-21).

“Kurse frikacakët...shortarët...trashëgimin e kanë në liqenin që digjet me zjarr dhe me sulfur. Kjo është vdekja e dytë” (Zb 21, 8).

Fragmente tjera që kanë lidhje me këtë dhe do të ishte mirë të lexohen janë: Dal 22, 17; 1 Kro 10, 13; Is 47, 9; 2 Mbr 21, 6; 23, 26.

## **Lutja për të vdekurit**

Është i madh dallimi në mes të përshpirtshmërisë ndaj të vdekurve dhe praksës spiritiste. Spiritistët e thërrasin të ndjerin dhe, madje i imitojnë disa veçori të tij, siç janë zëri, karakteri ose personaliteti. Përshpirtshmëria ndaj të vdekurve në Kishën Katolike nuk qëndron në atë që t’i thërrasim të kthehen, por t’i kujtojmë në lutjet tona dhe të kërkojmë



ndërmjetësimin e tyre.

“Mandej ai e kishte parasysh se një shpërblim tepër i bukur i priste ata që vdesin në hirin e Zotit: mendim ky i shenjtë e i përshpirtshëm” (2 Mak 12, 45).

Ky fragment bën aluzion për purgatorin, ku gjenden shpirtat e të ndjerëve, që kanë vdekur në hirin e Zotit, por akoma nuk janë mjaft të pastër për të hyrë në lumturinë e Zotit; bën aluzion për suksesin e lutjeve dhe flijimeve, që i bëjmë për ta. Këtë besim e hasim edhe te shumë fise autoktone dhe në religjione e raca tjera, të cilët, ndonëse nuk janë të krishterë, megjithatë i nderojnë të vdekurit e tyre dhe luten për ta.

## **Lirimi dhe shërimi**

Nuk dëshiroj të flas këtu për atë se si duhet lutur egzorvizmin, kush mund ta lutë dhe në kend duhet zbatuar. Për këtë, tanimë janë shkruar shumë libra. Pajtohem me mendimin e Richard McAllier-it, i cili thotë se shërbesa e liritit është pjesë e shërbesës së shërimit dhe, prandaj, nuk duhet t'i ndajmë.

Në lutjet e mia për shërim të brendshëm, shpeshherë kam përjetuar zhdukjen e vështirësive, që më janë dukur me prejardhje djallëzore, ndonëse nuk jam lutur për egzorvizem. Kjo gjë vërtetohet se duhet të sillemi me kujdes dhe me arsye të shëndoshë ndaj personave që u ndihmojmë kur gjenden në vështirësi. Nuk duhet t'ia mveshim Djallit të gjitha të këqijat.

## Emri i Jezusit

“Që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju i atyre që janë në qiell, në tokë e në nëntokë” (Fil 2, 10).

“Në emër tim do t’i dëbojnë djajtë” (Mk 16, 17).

Fragmente tjera të rëndësishme për fuqinë e Emrit të Zotit, që do të ishte mirë për t’u lexuar, janë: Zan 4, 26; Dal 3, 13-15; 20, 7; Lev 24, 10-16; Lp 6, 13; 1 Mbr 18, 7-40; Ez 36, 20-23; Dan 3, 26; 3, 43; 3, 51-90; Jl 3, 5; Mt 6, 9; 7, 21-23; 12, 21; 28, 16-20; Mk 9, 38-40; Lk 11, 2; Vap 2, 21; Rom 10, 13; Kol 3, 16-17.

Viteve të fundit të shërbesës time, e kam shfrytëzuar fuqinë e Emrit të Jezusit dhe mund të dëshmoj se fitorja që arrihet, është e shpejtë dhe e suksesshme. Djalli nuk mundet të durojë thirrjen e Emrit të Jezusit Shëlbues. Prandaj i nxis të gjithë që të thërrasin Emrin e shenjtë të Jezusit për t’u liruar nga ndikimet satanike. Është e udhës që Emri i Jezusit, të thirret me zë dhe me nderim të lartë.

Një i ri, pasi pati përjetim të gjallë të Hyjit, i la të gjitha, për t’i shkuar pas. Pas një muaji, përsëri i ndjeu nevojat e trupit, të cilat nuk mundi t’i kundërshtojë dhe shkoi ta gjejë një prostitutë. Rrugës e tha këtë lutje: “Hyji im, ti e din se i kam lënë të gjitha për të Të shkuar pas, por këtë nuk mund ta rezistoj. Të lutem më përcjell. Ndoshta pranë Teje nuk do të mëkatoj.”

Derisa lutej kështu, e dëgjoi një zë femre, i cili i thoshte: “Thirre emrin e Birit tim”, kurse i riu u përgjigj: “Po jam duke e thirrur.” Zëri insistonte: “Jo, thirre Emrin e tij. Atë Emër që ma tha engjëlli, Ditën e Nunciatës.”

Atë çast, i riu vërejti se thoshte “Hyj”, e jo “Jezus”. Atëherë filloi të lutet: “Jezu Nazarenas, Biri i Virgjërës Mari, më ndihmo.”

Kështu luti disa herë, derisa, në mënyrë të pashpjegueshme, nuk u gjend para shtëpisë së vet. Ai vetë nuk dinte të shpjegonte se ç’kishte ndodhur. I riu e kaloi atë natë në lutje, duke e falënderuar Jezu Krishtin për ndihmën që i kishte dhënë.

Ata që i kushtohen kësaj lutjeje delikate të lirimit, do ta zbatojnë me sukses:

A. – nëse janë të përgatitur për këtë shërbesë të rëndë;

B. – nëse e dëgjojnë ipeshkvin;

C. – nëse jetojnë dhe punojnë në bashkësi të krishterë, e jo vetëm;

D. – nëse e zbatojnë shërbesën e tyre duke ungjillëzuar;

E. – nëse janë persona që e çojnë jetën në lutje, nëse janë të përvujtur dhe nëse nuk kërkojnë lëvdata dhe mirënjohje.

## **8. Kongregata e Shenjtë për mësimin e Fesë**

Kongregata e Shenjtë për Mësim të Fesë, më 29 shtator 1958 e ka botuar dokumentin me të cilin shpjegohet pozita e laikëve lidhur me lutjet për lirim nga shpirtat e këqij. Në mes tjerash, në këtë dokument, thuhet:

1. Kanoni 1172 i Kodit të së Drejtës Kanonike thotë se askush nuk mund të zbatojë egzorcizëm ndaj të “djallosurve” pa leje të posaçme dhe eksplicite

të ipeshkvit lokal (paragrafi 1); pastaj përcakton që ipeshkvi, këtë leje, t'ia jep vetëm meshtarit që dallohet me devotshmëri, dituri, arsye të shëndoshë dhe me jetë pa vese (paragrafi 2). Ipeshkvijtë janë të ftuar me përzemërtësi, që në mënyrë konsekuente t'i përmbahen kësaj urdhërese.

2. Nga këto urdhëresa rrjedh se besimtarëve nuk u lejohet të shfrytëzojnë, as formulën e egzorcizmit, kundër Satanit dhe engjëjve të rebeluar, të shkëputur nga ajo që është publikuar sipas urdhërit të Meshtarit Suprem Leonit XIII; po ashtu nuk guxojmë të shfrytëzojmë tekstin e plotë të atij egzorcizmi. Ipeshkvijtë do të kujdesen që t'ua tërheqin vërejtjen besimtarëve, kudo të jenë.

3. Së fundi, për të njëjtat shkaqe, kërkohet nga ipeshkvijtë që të kanë kujdes të madh, që edhe në ato raste, në të cilat është përjashtuar djallësia e vërtetë, kurse duket se do të mund të ishte ndonjë ndikim djallëzor, t'i ndalojnë ata persona që nuk kanë leje të nevojshme, nga udhëheqja e lutjeve, në të cilat lutet për lirim, duke i emërtuar drejtpërdrejt djajtë dhe duke e vërtetuar identitetin e tyre.

Deklarimi i këtyre normave nuk guxon të shpie kah përmbajtja e besimtarëve nga lutjet drejtuar Zotit që të na lirojë nga i keqi, ashtu si na ka mësuar Jezu Krishti (Mt 6, 13). Është me rëndësi që Barinjët t'i shfrytëzojnë këto rrethana dhe t'ua paraqesin besimtarëve atë që tradita e Kishës mëson për rolin, që në luftën shpirtërore kundër shpirtëve të këqij e kanë sakramentet dhe rekomandimi i Zojës së Bekuar, engjëjve dhe shenjtërve.

Kardinali Joseph Ratzinger, prefekt, mons.

Rogelio Mahony, kryepeshkëv i Los Angeles-it dhe mons. Donald V. Montrose, ipeshkëv i Stockton-it, i kanë botuar normat të cilat duhen përmbajtur në rastet kur është e nevojshme lutja për lirim nga shpirtrat e këqij, ashtu që në praksë t'i zbatojmë urdhëresat e Kongregatës së Shenjtë, të paraqitura më parë:

1. Të mënjanohet situata mëkatore, nëse në të gjendet personi ose familja e goditur me të keqen. Sakramenti i pajtimit është mjet që vepron fuqishëm në këtë drejtim.

2. Edhe Eukaristia është mjet shumë i fuqishëm. Nëse personi është në disponim të duhur, duhet të merr pjesë për çdo ditë në meshën shenjte dhe të kungohet. Mundësia tjetër është që t'i rekomandohet këtij personi që çdo ditë të qëndron në kishë, para Sakramentit Shenjt, të paktën një orë, derisa nuk arrihet shërimi.

3. Agjërimi i shpeshtë me njet për personin e caktuar.

4. Lutjet e shpeshta të ruzares për personin e caktuar, si dhe lutjet tjera për nder të Zojës së Bekuar. Fundi i Atnës “na liro nga i keqi” është tejet i fuqishëm. Edhe lutjet e drejtuara engjëjve (posaçërisht shën Mihillit Kryeengjell) janë tejet efikase.

5. Të shfrytëzohet uji i bekuar.

Në rastet më të rënda, të gjitha këto mjete duhen shfrytëzuar bashkërisht. Zoti i plotëson lutjet tona, që i themi me qëndrueshmëri. Në rastet, në të cilat është me të vërtetë i pranishëm ndikimi djallëzor, janë të nevojshme shumë lutje dhe pendesa. Duhet të ndiejmë dëshirën që ta bëjmë këtë përpjekje, nga dashuria për të afërmin.

Do të ishte mirë që të lajmërohet famullitari lidhur me personin që duket se vuan nga ky problem.

Rogelio Mahony  
kryeipeshkëv i Los Angeles-it

Donald Montrose  
ipeshkëv i Stockton-it

Mendoj se lutja e shën Mihillit Kryeengjell, për të cilën flasin ipeshkvijtë në nr. 4, është ajo e cila më parë, para ripërtëritjes së liturgjisë, është thënë në fund të meshës:

“Shën Mihill Kryeengjell, mbrona në luftë: kundër shpirtkeqësisë dhe prej pritave të djallit na streho! Le t’i urdhërojë Zoti, lusim me përvujtëri: edhe ti, Komandant i ushtrisë qiellore, djallin dhe shpirtrat tjerë të këqij, që shkojnë rreth e rrotull nëpër botë dhe shkaktojnë rrënimë të shpirtave, me virtyt hyjnor ndjeki në ferr! Amen.”

Kur bëhet fjalë për ujin e bekuar në nr. 5, mendoj se mund të nënkuptohet përdorimi i të gjitha bekojsave tjera që kanë marrë fuqinë përmes bekimit të Kishës.

### **Gjërat që sjellin fat**

Më befason fakti se si njerëzit, në mënyrë opesive, i tërheqin gjërat që kinse “sjellin fat”. Kështu, shpesh, në dyer të shtëpive dhe lokaleve shihen p. sh.: hudhurat, patkojtë, kallamboqet etj.

Njerëzit mbajnë rreth qafës veriga nga fildishi, nga koralet, nga qilibari i zi (?), nga dhëmbët, pastaj duar të zeza, shenja të zodiakut etj. , kurse nuk vërehet se mbas këtyre shenjave fshehet djalli.

Zoti na premtun se do të na jep lumturinë. Në librin e Jozuehut lexojmë: “Veçse ji burrë i fortë e ki shumë guxim që të ruash e të bësh gjithçka sipas ligjit që të urdhëroi shërbëtori im Moisiu. Mos iu shmang as djathtas as majtas që të shkojë për së mbari gjithçka që të ndërmarrësh. Libri i këtij ligji të mos hiqet kurrë prej gojës sate, por kujtoje me mendje ditë e natë, që të zbatosh e të kryesh pikë për pikë gjithçka është shkruar në të: vetëm atëherë do të marrin fund me nder udhët e tua e do të kesh sukses (Joz 1, 7-8).

“Sepse, po bëre të vërtetën, do të shkojë mbarë gjithçka që të veprosh sikurse atyre që vënë në veprim drejtësinë” (Tob 4, 6).

“Mbaji urdhërimet e Zotit, Hyjit Tënd! Ec udhëve të tija! Mbaji ligjet e tija, urdhërimet e tija, porositë dhe dëshmitë...që të të shkojë mbarë gjithçka të ndërmarrësh, kudo që të sillesh” (1 Mbr 2, 3).

“Biri im, ... zemra jote le t’i mbajë urdhërimet e mia, sepse do t’i bëjnë të shumta ditët e tua, vjetët e jetës sate plot mirëqenie” (Fu 3, 1-2).

Fuqia bindëse që ka Satani, është më e madhe se që mund të paramendojmë:

Njëherë e kam vizituar një shitore në të cilën shiteshin gjëra religjioze. Me të hyrë, së pari e vërejta pikturën e Virgjërës Mari të zbukuruar me ndriçim fluorescent. E urova pronarin e shitores për devotshmërinë e posaçme ndaj shën Marisë, sepse më

tha se në lutje e thërret për mbrojtje.

- Në të dalur nga shitorja e vëreja një varg hudrash dhe patkoin. E pyeta pronarin:

- E ç' do të thotë kjo?

- Këto janë gjërat që “sjellin fat”, përgjigji njeriu.

- Duke e shikuar pikturën e shën Marisë, i thashë:

- Pse e mbanë këtë këtu?

- Që ta forcoj dhe ta arrij “fatin” më të madh.

- Raste të këtilla ka shumë. Djalli dëshiron ta shpërkëndejë popullin e Hyjit dhe me mashtrim e detyron që uzdajën e vet ta mbështetë në krijesa e jo në Zotin.



## KAPITULLI XI.

### SI DUHET LUTUR PËR SHËRIM

Dr Villiam Parker, në librin e vet “Lutja në psikoterapi”, e ka dëshmuar shkencorisht vlerën e lutjes. Ai ka ardhur deri në përfundimin se shumë lutje që i bëjmë, i bëjmë në mënyrë të gabuar. Apostulli Jakob thotë: “Lutemi e nuk fitoni, pse luteni keq që t’i shpenzoni në plotësimin e ëndjeve tuaja” (Jak 4, 3). Ndërsa shën Augustini shton: “Lutemi për gjëra të këqija, kurse nëse lutemi për gjëra të mira, atëherë lutemi në mënyrë të keqe” (shën Augustini e ka përmbledhur këtë thënie në latinishte: “mali, male mala”, që do të thotë: të këqijtë, në mënyrë të keqe, për gjëra të këqija).

Atëherë, si duhet lutur mirë, nëse lutja jonë është e keqe?

Përgjigje ka shumë. Përgjigje ka aq sa ka edhe metoda të lutjes. Besoj se hapi i parë kah lutja e mirë është lutja e ngadalshme. Lutja e thënë shpejtë, vetvetiu është e keqe.

Dr. Eilliam Parker thotë se lutjet që thuhet në mënyrë të përshtatshme, d. m. th. , që iu përshtaten rasteve të ndryshme, janë më të suksesshme. Kur lutemi “përgjithësisht”, na duket se përgjigja e Zotit vërehet më pak. P. sh.: nëse lusim për “shërimin e të sëmurëve në spitale”, nuk do të vërejmë frytin e kësaj

lutjeje në mënyrë të qartë, ndonëse lutja jonë është e mirë dhe Zoti e dëgjon. Personi që lutet kështu dhe shpreson të sheh rezultate imediat, rrezikon që besimi i tij të mos rritet, sepse i duket se Zoti “nuk i përgjigj” lutjes së tij.

### **Lutja për shërim të brendshëm**

Nuk dëshiroj të shqyrtoj tani çështjen e shërimit të brendshëm. Për këtë çështje ekzistojnë libra të shumtë dhe të mirë, siç janë p. sh.: “Shërimi i brendshëm” i ipeshkvit Alfonso Uribe Jaramillo-s dhe “Shërimi nga kujtimet” i autorëve Matev dhe Deniss Lynn. Do t’i paraqes vetëm ca mendime mbi këtë çështje.

Sipas dr. Villiam Parker, ekzistojnë shumë sëmundje psikike, por të gjitha mund të redukohen në këto katër kategori: frika, urrejtja, brejtja e ndërgjegjes dhe ndjenja e vlerës më të ulët – kompleksi i inferioritetit. (Sipas mendimit të tij, kompleksi i superioritetit nuk ekziston).

### ***Si zbatohet lutja për shërim të brendshëm***

Këtu po i paraqesim disa pika të cilat na duken të rëndësishme që lutja për shërim të na sjellë frytet, të cilat shpresojmë se do t’i gëzojmë.

### ***I sëmuri duhet ta kërkojë atë***

Personi që e kërkon këtë lutje duhet t’i çelet kësaj lutjeje dhe duhet të merr pjesë në këtë lutje me personin që lutet për të. Prandaj, kjo lutje nuk mund të lutet për personat që nuk janë të pranishëm.

### ***Duhet përdorur imagjinatën***

Kjo lutje duhet të jetë e pasur me fotografi në imagjinatë dhe njëherësh tejet pozitive. Shën Tereza e Jezusit rekomandon që të paramendojmë pranë vetes Jezusin në trajtën njerëzore. Këshillon që të shohim Krishtin me plagët prej gozhdave, si u drejtohet apostujve, me plot lumturi, ditën e ngjalljes.

### ***Duhet kthyer në të kaluarën***

Duhet lutur Jezusin që të kthehet me ne në atë çast kur jemi plagosur nga plaga nga e cila vuajmë. Kështu, Ai, me pranishmërinë e vet do t'i shërojë të gjitha plagët tona, një nga një. Plagët shpirtërore janë porsì vrimëzat, për të cilat, Satani (figurativisht i vështruar si merimangë me shumë këmbë), kapet dhe nuk lejon të dëbohet. Prandaj duhet shëruar çdo plagë veçanërisht, ashtu që djalli të mos ketë më, për çka të kapet. Dhe në prani të Jezusit, kur e pranojmë në kungimin shenjt, përfundimisht duhet ta dëbojmë djallin.

### ***Duhet të zbulojmë shkaktarin e plagës***

Është tejet e rëndësishme që të zbulohet shkaktari i plagës shpirtërore, që Jezusi të mundet të shërojë dhe kështu, të zhduket plaga si rezultat i shkaktarit. Për këtë gjë mund të na ndihmojnë këto pyetje: “Që kur je i sëmurë? Ç’ka ndodhur atëherë?”

### ***Disa sëmundje***

Disa sëmundje, siç janë: alergjitë, astma, gastriti,

ulceret, pezmatimi i nyjeve, artroza, sëmundjet e lëkurës, pagjumësia...mund të jenë pasojë e sëmundjeve shpirtërore. Prandaj, sëmundjet e tilla, më me sukses shërohen me lutjen për shërim të brendshëm.

Në të shumtën e rasteve, te personat e sëmurë hasim në urrejtje dhe hidhërim, prandaj, duhet lutur për falje.

Një rregulltare e ka pasur një egzemë në vesh dhe njëherë erdhi në lutje për shërim. Na tha se tanimë katër vite vuan nga kjo sëmundje dhe tha se të parën herë është lajmëruar me rastin e një grindjeje me eproren, e cila, me padrejtësi, ia kishte refuzuar njëfarë leje. Prej atij momenti janë lajmëruar egzemet, kurse urrejtja u vendos në zemrën e saj. Gjatë lutjes për shërim kuptoi se duhet ta falë eproren. Me përvujtëri e fali dhe egzemi u zhduk.

### ***Shembulli i lutjes për shërim të brendshëm***

Zonja Barbara Shlemon e ka përpiluar këtë lutje për shërim të brendshëm:

“O Zot, kthehu me mua në ditët e lashta të fëmijërisë time, deri në vetë momentin e mbarsimit. Më ndihmo o Zot, më pastro dhe më liro nga të gjitha gjërat që kanë mundur të shkaktojnë vështirësi në çastin e mbarsimit tim. Ti ke qenë i pranishëm gjatë formimit tim në barkun e nënës time: më liro dhe më shëro nga të gjitha prangat dhe zingjirët që i kam trashëguar nga nëna ose përmes rrethanave të jetës së prindërve të mi. Të falënderoj për këtë!

Të falënderoj, gjithashtu, o Jezus, që më shëron nga trauma e lindjes (shumë nëna tona, kanë pasur

lindje të vështira, të dhembshme dhe të gjata, pasojat e të cilave i ndiejnë fëmijët). Të lutem o Zot, që të më shërosh nga dhembjet e lindjes dhe vuajtjet e shtatzanisë. Të falënderoj o Zot, që ke qenë aty, të më pranosh në duart tua, në çastin e lindjes time. Në të njëjtin çast më kushto shërbesës hyjnore. Falemnderit Jezus që e ke bërë këtë!

Jezu Krisht, falemnderit për atë që ke qenë pranë meje në muajt e parë të jetës time. (Ekzistojnë shumë persona që kanë pasur nevojë për më shumë dashuri se që kanë pranuar nga nënat e tyre, sepse kanë qenë të ndarë nga nënat, për shkak të rrethanave të ndryshme dhe, nuk kanë mundur ta pranojnë atë dashuri që do t'u ndihmonte për të fituar fuqinë dhe sigurinë). Ka pasur momente kur e kam ndier nevojën që nëna të më merr në krah dhe të më lëkund, të më shtrëngojë në gjirin e saj dhe të më tregojë tregime fëmijërore, ashtu si dinë të bëjnë vetëm nënat. O Zot, bën që ta ndiej dashurinë e fortë amtare në thellësinë e qenies time dhe bën që askush të mos mundet të më shkëput nga ajo. Të falënderoj o Zot dhe të bekoj, për atë se në këtë çast më shëron!

*(Ekzistojnë persona që në jetën e tyre kanë pasur më shumë nevojë për dashuri atërore). O Zot, pa marrë parasysh shkaqet për atë se e kam ndier veten të lënë pas dore dhe të braktisur, më mbush me dashuri të thellë atërore, të cilën vetëm babai mund ta jep. Ndonëse nuk jam e vetëdijshme se kam pasur nevojë për përqafimin e një "babai" që do të më puthte dhe do të më jepte siguri dhe mbështetje, ma jep këtë tani! Falemnderit o Zot, për atë se këtë e bën tani!*

*(Shumë prej nesh janë rritur në familje, në të cilat nuk janë konsideruar si persona). Kurrë nuk e kam ndier dashurinë e të tjerëve. Sot të lus që t'i mi largosh kujtimet e mia, plot dhembje, për këtë. O Zot, bën që ta njoh faktin se jam fëmija yt, person i rëndësishëm në familjen tënde, person i veçantë, të cilin e don në mënyrë të posaçme.*

Më shëro o Zot, nga të gjitha plagët që janë shkaktuar nga marrëdhëniet me familjen time, vëllain, motrën, të cilët nuk më kanë kuptuar ose nuk më kanë dashur sa duhet. Më jep fuqi që të fali vëllain ose motrën. Me vite nuk kam mundur t'i pranoj, sepse ata mua nuk më kanë pranuar. Bën që t'i dua dhe në dashurinë e madhe ndaj tyre, ajo që ka qenë të zhdukët. Falemnderit o Zot, për atë se më ripërtëritë!

(Shumë prej nesh, ndoshta kanë përjetuar traumën e parë kur kanë filluar të shkojnë në shkollë. Ka qenë kjo hera e parë kur jemi ndarë nga familja dhe nga të gjitha, që ajo familje, ka paraqitur për ne. Për disa prej nesh, që kemi qenë të ndijshëm, të frikësuar e të pasigurt, ai çast ka qenë tejet i vështirë: takimi me mësuesen e panjohur, me shokët e ri, në mjedis të panjohur).

O Zot, kurrë nuk jam përtëritur nga kjo përvojë, sepse nga unë është pritur shumë dhe shumë më kanë plagosur: mosafrueshmëria e mësueseve dhe e fëmijëve, të cilët nuk më kanë shfaqur as dashuri as kuptim. O Zot, të lutem më shëro nga këto kujtime plot dhembje të viteve të mia shkollore. Me atë rast kam fituar komplekse dhe prej atëherë frikësohem të flas para ndonjë grupi njerëzish, sepse më kujtohen rastet kur kam qenë e përulur dhe e përqeshur nga

shokët e mi. Jam tërhequr në vete dhe kam rënë në heshtje, sepse kjo gjë më ka shkaktuar dhembje të mëdha. O Zot, të lutem hape derën e zemrës time dhe bën që të sillem në mënyrë të hapët dhe të lirë ndaj shoqërisë, e jo si deri tani. Pas këtij shërimit do të kam besim dhe vendosmëri që t'i bëj të gjitha ato që i kërkon prej meje, në çdo rast. Falemnderit o Zot, sepse besoj se më shëron qysh tani.

O Zot, duke hyrë në moshën rinore, kam pasur përvoja të shumta, të cilat më frikësojnë, turpërojnë dhe më shkaktojnë dhembje. Kurrë nuk kam mundur t'i mposhti plotësisht përvojat e këqija nga koha kur kam filluar ta njoh veten, kur e kam zhvilluar personalitetin tim. Të lutem o Jezu Krisht, më shëro nga të gjitha këto përvoja rinore, hyn në zemrën time dhe shlyej të gjitha përvojat që më shkaktojnë dhembje dhe turp. Nuk të lus o Jezus, që këto përvoja t'i shlyesh nga kujtimi im, por që t'i transformosh, ashtu që të mos turpërohem nga ato dhe të të falënderoj për këtë.

Bën që përmes përvojës së rinisë së sotme, të kuptoj kohën e dikurshme timen, të hulumtimit dhe të konfliktit; të kuptoj si më shëron me ngadalë. Bën që t'u ndihmoj të tjerëve për të gjetur rrugën e shërimit.

O Zot, duke dalur nga kjo pjesë e jetës dhe duke hyrë në thirrjen që ma ke besuar, kam pasur vështirësi (disa janë ftuar që të lidhin kurorë, disa në celibat, të tjerët e kanë zgjedhur vetminë ose janë bërë të vejë ose të shkukurëzuar: ka pasur dhembje dhe mundime; nuk ka krijesë në tokë që nuk e ka ndier mundimin e adaptimit dhe të zgjidhjes së problemeve në jetën e vet). Të lutem o Jezus, shëro të gjitha këto dhembje

në thirrjen time, në të cilën gjendem tani.

*(Bashkëshortët mbartin ndonjë problem nga e kaluara: plagë dhe mundime të jetës së përbashkët intime).* O Zot, më liro nga këto mundime. Ripërtërite bashkëshortësinë time dhe bën që ajo të jetë sipas vullnetit tënd! Merri në duart tua plagët e të kaluarës, ashtu që bashkëshortësia të më bëhet e pastër, e ripërtëritur dhe e shëndoshë! Falemnderit o Atë, që përmes këtij shërimi po bëhemi burrë e grua, ashtu si na don Ti!

(Meshtarët, rregulltarët dhe rregulltaret, kanë pësuar plagë, të cilat i largojnë nga Jezusi). O Zot, bën që të ndiej aq forcë dhe ngrohtësi të dashurisë tënde, sa që kurrë të mos dyshoj se Ti më ke thirrur. Më jep vendosmëri dhe besim në veprën që ma ke besuar. Më udhëheq më tutje, me vendime dhe caqe të reja.

Falemnderit o Atë, sepse e di se këtë je duke e bërë!”

### ***Efektet e shërimit***

Efekti i lutjes për shërim të brendshëm nuk përbëhet nga të harruarit e ngjarjeve ose problemeve që na kanë munduar, por nga ajo se nuk varemi nga ato: ajo që na ka shkaktuar vuajtje përpara, tani nuk na shkakton dhembje, në ne nuk ka më urrejtje e pikëllim dhe, nuk mendojmë të hakmerremi për plagët e fituara, ndërsa kur mendojmë në këto plagë, kemi ndjenjën e qetësisë, paqes së madhe. Kjo është shenja e shërimit autentik të brendshëm.

Personi i shëruar, shëron të tjerët.

Prandaj:



- mbjellë paqe, e jo përçarje;
- shuan zjarrin;
- dëgjon dhe heshtë;
- në ofendim përgjigjet me lutje;
- në shpifje përgjigjet me bekim;
- nëse është i përndjekur, nuk sulmon.

Personi i shëruar jeton ashtu siç na thotë Jezusi: “Doni armiqtë tuaj, bënu mirë atyre që ju urrejnë, bekonin ata që ju mallkojnë, lutuni për ata që dijekeqas ju mendojnë” (Lk 6, 27-28).

## **Lutja për shërim trupor**

### ***Katër metoda***

Ekzistojnë shumë mënyra se si mund të lutet lutja për shërim trupor. Mendoj se është me vend që t'i paraqes këtu disa metoda që i shfrytëzojnë personat që kanë përvojë në këtë shërbesë.

**A.** Agnes Sanford, e cila është tejet e angazhuar në shërbesën e shërimit, thotë se duhet paramenduar çdo pjesë e sëmurë e trupit dhe duhet shikuar si depërton drita hyjnore e Jezusit në çdo qelizë të tijën dhe e shëron. Shembull: të paramendohet se çdo qelize të mëlqisë ose të stomakut të sëmurë nga kanceri, i vjen drita e Jezusit dhe, ajo i shkatërron qelizat e kancerit dhe i shëron ato.

**B.** Shën Dominik de Guzman ka pasur zakon të lutet për të sëmurët, duke e prekur çdo pjesë të trupit të të sëmurit dhe është lutur për të deri në shërim.

**C.** Francis MacNutt i kushtohet Krishtit të Vuajtur. Kur p. sh. , lutet për sëmundjet e kokës, e lut Jezusin që përmes meritave të kurorës së ferrave, ta shërojë atë pjesë të trupit. Nëse personi ka sëmundje gjaku, ai e lut Jezusin që atë sëmundje ta shërojë me meritat e Gjakut të çmuar të tij, të cilin e ka derdhur për shëlbimin tonë.

**D.** Duhet përqendruar në Jezu Krishtin. Mendoj se shembull i mirë i lutjes për shërim trupor është shembulli i të verbërit prej Jerihos, i cili me bërtime iu drejtua Jezusit: “Jezus, Biri i Davidit, ki mëshirë për mua!” (Lk 18, 38).

Në shërbesën time, kur lutem për të sëmurët, përqendrohem në Shëlbuesin tonë. Duke mos hyrë në imtësira, e lus që ta shërojë pjesën e sëmurë, posaçërisht që ta mënjanojë shkakun e sëmundjes, të cilin vetëm Ai e njeh.

## **Si zbatohet lutja për shërim trupor?**

Kur lutemi për shërim trupor, s'bën të mungojnë këto elemente:

### ***Shikimin duhet drejtuar kah Zoti***

Në Librin e Siracidit (38, 9) lexojmë: “Biro, në sëmundjen tënde mos ji i prishur, por lutju Zotit e ai do të shërojë” (Sir 38, 9). Ky është elementi i parë i rëndësishëm në lutje: të drejtohet shikimi kah Zoti. Edhe i sëmuri edhe ata që luten për të, le të paraqiten

me përvujtëri para Zotit dhe le ta njohin për Hyj të vetin. Në Ungjill, shohim si kanë ardhur shumë njerëz tek Jezusi, duke ra përmbys para tij dhe, u shëruan.

### ***Duhet lutur për falje***

Në Librin e Siracidit, gjithashtu lexojmë: “Nga çdo mëkat pastroje zemrën tënde!” (Sir 38, 10). Nuk është lehtë të fitohet diçka nga dikush, nëse jemi në grindje me të. Është e qartë se së pari duhet të lidhim miqësi, ashtu që të mund ta lusim për diçka. Të gjithë duhet të luten për falje. Jo vetëm i sëmuri, por edhe ata që luten me të dhe për të.

### ***Duhet thirrur emri i Atit ose i Jezu Krishtit***

“Ju nuk më zgjodhët mua, por unë ju zgjodha ju dhe ju caktova të shkoni e të jepni fryt e fryti juaj të qëndrojnë; dhe që Ati t’ju japë çkado të kërkonti në Emër tim” (Gjn 15, 16). Lutja është e drejtuar Atit qiellor nëpër Jezu Krishtin përmes fuqisë së Shpirtit Shenjt.

### ***Plagët dhe Gjaku i Jezu Krishtit***

“Me plagët e të cilit jeni shëruar” (1 Pjt 2, 24). Duhet thirrur fuqinë e Plagëve dhe Gjakut të Jezu Krishtit, që të na shërojë përmes meritave që i ka fituar me dhembjet e plagëve të veta. Nuk ka dhembje që nuk e ka ndier për ne dhe që nuk e ka marrë me vete në kryq.

***Vajimi i shenjtë dhe vënja e duarve mbi të sëmurët***

Pranë lutjes mund të shfrytëzohet edhe vajimi i shenjtë si sakramental (shih librin “Burimet e shërimit” – Izvori ozdravljenja) dhe vënja e duarve mbi të sëmurët, si shenjë e jashtme e dashurisë dhe simpatisë ndaj vëllait të sëmurë. Jezu Krishti ka thënë: “Do t’i vënë duart mbi të sëmurë, e këta do të shërohen” (Mk 16, 18). (Nëse vënja e duarve mbi të sëmurin sjellë më shumë trazira se dobi, mund të mos përfillet).

### ***Duhet falënderuar***

Kur shohim se personi i caktuar është shëruar sipas lutjes që është lutur, duhet të falënderojmë Hyjin! Këtë duhet theksuar. Shumë herë e lusim Zotin, kurse pak herë e falënderojmë. Lutjet tona në të shumtën janë kërkim lëmoshe, kurse rrallë falënderime. Falënderohemi duke iu kushtuar Zojës Virgjër Mari dhe shenjtërve.

### **Një shembull i lutjes për shërim trupor**

“Ati Shenjtë, po të drejtohem me Birin tënd të dashur, Jezu Krishtin, Shëlbuesin dhe Hyjin tonë. Na i fal dobësitë dhe mosmirënjohjet tona. Me fuqinë e Gjakut të Çmuar të Krishtit, na pastro dhe na liro nga të gjitha mëkatet dhe, bën që Plagët e tij të shenjta të shërojnë shkaktarin e sëmundjes sonë.

Jezus i dashur, vëri duart tua të shenjta në këtë vëlla tonin. E dimë se e don dhe e viziton. Të falënderojmë duke iu kushtuar Virgjërës Mari, nënës tënde, nënës tonë dhe nënës të të gjithë shenjtërve.”

Kjo lutje është vetëm shembull dhe nuk duhet të përsëritet fjalë për fjalë. Lutja më e mirë është

lutja spontane, e cila i përfillë të gjitha elementet e përmendura më parë.

### ***Lutja për personat me të cilët është vështirë të jetohet***

Këtë lutje mund ta lutim për ata që nuk janë të pranishëm dhe për këtë nuk na nevojitet leja e tyre. Më së miri është të lutemi për ta, derisa ata flejnë. Me fjalë tjera, lutja jonë, në gjumë, depërton lehtë deri në nënvetëdije, të cilën pjesa e vetëdijshme nuk e pengon, meqenëse nuk është aktive. Dhe kjo lutje ndikon në nënvetëdije.

Ky lloj i lutjes është shumë efikas edhe për personat që vuajnë nga alkoolizmi dhe narkomania.

Në qytetin Culiacan, në Meksikë, një familje ka pasur vështirësi të mëdha me birin që ishte tetëmbëdhjetë vjeç. Gjatë natës jemi lutur për të, në dhomën fqinje. Të nesërmen, derisa hanim mëngjesin, djali erdhi dhe filloi të sjellet mirë ndaj prindërve të vetë (gjë që moti nuk e kishte bërë) dhe tha: “Mbrëmë e kam parë një ëndërr të mrekullueshme. Kam parë ëndërr se keni ardhur me atin Dario dhe më keni ftuar në shëtitje, gjatë së cilës kemi parë shumë gjëra dhe kemi kaluar për mrekulli.” Prej asaj dite, marrëdhëniet në mes prindërve dhe të riut janë normalizuar dhe të gjitha vështirësitë kanë pushuar.

### ***Lutja për foshnjat e posalindura***

Është mirë që prindërit të lutën kur vendosin të bashkëpunojnë me Zotin në krijimin e jetës së re. Lutja e tillë ka efekt të mrekullueshëm në mendjen dhe jetën e qenies së re, në fushën e sigurisë, lumturisë

dhe ndjeshmërisë së tij.

Pastaj, do të ishte nevoja që të lutemi për ata fëmijë, nënat e të cilëve, kur e kanë vërejtur se janë shtatzëne, kanë menduar në abort ose kanë pasur frikën se do ta humbin fëmijën ose se do të vdesin gjatë lindjes. Atëherë duhet të lutemi që dashuria shëlbuese hyjnore të përfshijë mendjen e këtij fëmije dhe ta shërojë nga refuzimi i nënës dhe nga mosbesimi ndaj jetës, derisa ka qenë në bark të nënës.

Edhe në këtë rast mund të lutemi derisa fëmija flen, ose nga dhoma tjetër.

Një anëtar i bashkësisë sonë, i cili e ka njohur Zotin pas lindjes së fëmijës së parë të tij, na ka thënë se ky fëmijë, për nga natyra është i ndijshëm dhe shumë shpejtë sëmuret, derisa fëmijët tjerë që kanë lindur më vonë dhe për të cilët është lutur pas lindjes së tyre, janë të shëndoshë dhe rrallë sëmuren.

### ***Lutja për fëmijët e hendikepuar***

Kur prindërit luten për fëmijët që kanë lindur me ndonjë hendikep, fizik ose shpirtëror, jo vetëm që ndiejnë dashuri më të madhe ndaj njëri-tjetrit, por, gjithashtu shërohen nga kompleksi se fëmija i hendikepuar është ndëshkim i Zotit. Lutja e shëron fëmijën në nivele të ndryshme, posaçërisht nëse ajo bëhet si “terapi me lutje” (shih kreun VII).

Njëherë, në grupin tonë të lutjes erdhi një çift bashkëshortor duke kërkuar ndihmë për birin e tyre të retarduar, të cilin tejet vështirë e kontrollonin dhe i cili i kafshonte njerëzit që u vinin në vizitë. Për këtë arsye këtij çifti iu desht të izolohej nga kushërinjtë dhe miqtë, i cili izolim u shkaktoi vuajtje.

Bashkëshorti ishte mysliman nga Irani, kurse bashkëshortja ishte katolike nga Kolumbia.

I ati i djaloshit më tha:

- Nëse fëmija im shërohet, unë do të bëhem i krishterë.

I përgjigja:

- Nuk e di nëse do të shërohet biri juaj, por do t'i lutemi Jezusit që të bëjë atë që mendon se është më së miri.

Ka kaluar shumë kohë dhe nuk kam dëgjuar gjë për këtë familje. Disa vite më vonë i takova në tren, në Nev York dhe gruaja, të cilës iu kujtua rasti, më tha:

- Kemi bërë atë që na keni thënë të bëjmë: për çdo natë, nga disa minuta jemi lutur mbi birin tonë dhe kemi vërejtur ndryshim të madh. Tani nuk e kafshon askend, mund t'i pranojmë në shtëpi kushërinjtë dhe miqtë, mund të dalim me të në rrugë.

Dhe me dorë ma tregoi birin, një të ri 18 vjeç, i cili rrinte urtë.

### ***Lutja për fëmijët e adoptuar***

Prindërit e fëmijës së adoptuar mund të luten për të gjitha periudhat e jetës së fëmijës së adoptuar: mbarsimi, shtatzania, lindja, vitet e para të jetës dhe të kërkojnë shërim nga sëmundjet, eventualisht të trashëguara.

Për fëmijën e adoptuar është shumë e rëndësishme “terapia me dashuri” (kreu II, 2), që të shërohen ato

plagë, të cilat janë fryt i refuzimit dhe braktisjes së këtij fëmiu. Thelbi i shërimit është edhe ai që prindërit e fëmijës së adoptuar duhet të lutën për prindërit e vërtetë të tij.



## KAPITULLI XII.

### SI DUHET VIZITUAR I SËMURI

Pastorali i të sëmurit nuk përfundon me sakramentin e vajimit të të sëmurit. Fushëveprimi i apostullatit të të sëmurit është tejet i madh. Shtrihet nga takimi miqësor me të sëmurët, deri në bisedimin me ata më të largët në të njëjtën bashkësi.

Pyetjet, që i sëmuri ia shtron vetes kur është i sëmurë, në psikologjinë e të njëjtit krijojnë një moment të volitshëm për takim me Zotin. Personat që e vizitojnë të sëmurin, gjatë bisedës duhet të kenë kujdes, ashtu që mos ta frikësojnë ose mos t'ia prishin disponimin të sëmurit.

Shumë herë nuk dimë për çka të bisedojmë. Në bisedë e sipër me të sëmurin, është tejet e rëndësishme që t'ia bëjmë me dije se Zoti e don dhe se sëmundja e ka qëllimin e vet, të cilin, ndoshta ne, në momentin e caktuar, nuk e kuptojmë, por të cilin, kur të vjen koha, do ta kuptojmë. Është e udhës që me të sëmurin t'i shqyrtojmë tre shkaqe të mundshme të vuajtjes dhe dhembjes, për të cilat Papa Gjon Pali II flet në vegimin e tij "Vuajtja shpëtimtare" (shih kreun II), duke e theksuar vuajtjen si sprovë të fesë, e cila na çon drejt kthimit dhe përkushtimit të plotë Zotit, e jo vuajtjen si ndëshkim për shkak të mëkatit. Është shumë me rëndësi që të jemi të ndijshëm ndaj këtij

aspekti të fundit, sepse traumës së sëmundjes do të mund t'ia shtonim traumën e mëkatit.

Grupet e posaçme të personave që formohen dhe mësojnë si të luten dhe si t'i vizitojnë të sëmurët, duhet t'i kushtojnë kujdes punës dhe kontakteve që duhet lidhur:

- *me personelin e spitalit: me mjekët dhe infermierët, me personelin administrues dhe me ata të rangut më të ulët, siç janë portierët, rojet, pastrueset;*

- *me të afermit e të sëmurit, të cilit duhet kushtuar kujdes të veçantë;*

- *me vet të sëmurin, të cilit duhet ndihmuar më së pari.*

Të analizojmë çdo pikë veçanërisht.

## **Shërbesa në spital**

Para së gjithash duhet pasur nderim të madh ndaj bindjeve fetare të të sëmurit ose të personelit të spitalit. Duke bashkëpunuar me ta, duhet përpiluar “programet për promovimin njerëzor dhe religjioz”.

Sa i përket promovimit njerëzor, duhet ndihmuar të sëmurin që të syzohet me ardhmërinë e tij, me problemet personale, familjare dhe sociale.

Sa i përket promovimit religjioz, duhet dëftuar emrin e Jezu Krishtit përmes shërbesave eukaristike, nëntësheve, festave lokale etj, nëpër dhoma, sallone dhe godina të spitaleve. Të sëmurët janë të parët që do të shfaqin dëshirën për të bashkëpunuar dhe për të marrë pjesë, sikur edhe kushërinjtë e tyre, si dhe ata

që u ndihmojnë së spital.

Posaçërisht duhet programuar dhe me katehezë të mirë duhet përgatitur ditën dhe vendin për kremtimin e sakramentit të vajimit, duke vënë theksin në atë se ky është sakrament i shërimit. Këto kremte të përbashkëta, jo vetëm që u ndihmojnë të sëmurëve që të shërohen nga izolimi, nga i cili në të shumtën e rasteve vuajnë, por, janë të dobishme edhe për personat që u vijnë në vizitë dhe kështu e përjetojnë praninë e Zotit në atmosferën e vëllazërisë dhe dashurisë.

### **Shërbesa në familjën e të sëmurit**

Mendoj se të afermit të të sëmurit duhet thënë haptas për cilën sëmundje është fjala dhe për afërsinë eventuale të vdekjes.

Është ky rast përshtatshëm që familja të nxitet për ta lutur *lutjen zemërgjerë*. Ndoshta, në këtë drejtim, do të ishte e nevojshme kateheza për nevojën e lutjes (shih kreun VI, mbi “Lutjen zemërgjerë”).

Lutja të cilën familja e lut për të sëmurin e dashur, shpeshherë është burim i shërimit të madh! Prandaj, duhet të udhëzohen që për çdo ditë ta praktikojnë lutjen zemërgjerë. Pastaj, është me rëndësi që në karizmë të hapen lutjet, në të cilat lutemi për njëri-tjetrin. Grupi i mirë i lutjes, jo vetëm që do të lutet me ta, por edhe do t’i mësojë si të vazhdojnë me lutje. Ngjashëm sikurse mjeku i jep të sëmurit ndihmën e parë dhe e mëson të sëmurin që vetë të vazhdojë me terapi.

Roli kryesor i kësaj shërbese është që të pajtohen

të afermit me të sëmurin. Me fjalë tjera, shpesh ndodh që anëtarët e familjes nuk pajtohen sepse e kanë ofenduar njëri-tjetrin. Sëmundja është rast i volitshëm që të pajtohen njëri me tjetrin. Anëtarët e familjes që e kanë falur njëri-tjetrin, do të duhet të vëzhgohet, që të arrijnë shërimin e brendshëm në tërësi.

## **Shërbesa të sëmurit**

Gjatë vizitës së të sëmurit duhet llogaritur me këto pika, si vijojnë.

### ***Duhet krijuar atmosfera për lutje***

Të kujtohem si veprimi Jezusi me rastin e ngjalljes së bijës së Jairit:

“Jezusi nuk lejoi ta përcjellë askush tjetër, përveç Pjetrit, Jakobit e Gjonit, vëllait të Jakobit. Arritën te shtëpia e kryetarit të sinagogës. Jezusi vuri re një pështjellim të madh e njerëz që qanin e vajtonin me zë të madh. Hyri dhe u tha: ‘Pse bërtitni e vajtoni? Fëmija nuk ka vdekur, por fle!’ Ata e përqeshën. Jezusi atëherë i qiti përjashta të gjithë. Me vete mori të atin e t’ëmën e fëmijës e përcjellësit e vet dhe hyri atje, ku ishte fëmija” (Mk 5, 37-40).

Jezusi i ka zgjedhur vetëm disa persona, e jo të gjithë të pranishmit, që të luten për vajzën, ndersa të tjerët i qiti përjashta kur pa se bëjnë zhurmë, qajnë dhe bërtasin. Me fjalë tjera, Jezusi ka krijuar atmosferë për lutje, soditje dhe heshtje.

Kur e vizitojmë të sëmurin, duhet të krijojmë atmosferë të përshtatshme për lutje, duke i ftuar me

kujdes, anëtarët e familjes që ta ndalin televizorin, radion dhe të pushojnë së punuari çfarëdo pune që pengon soditjen. Njëkohësisht duhet të ftojme kushërinjtë që të marrin pjesë në lutje, duke filluar nga më të afërmit, siç janë: gruaja (burri), fëmijët, miqtë dhe shokët e punës; le të marrin pjesë edhe fëmijët e vegjël. E gjithë kjo duhet zhvilluar në atmosferë fetare dhe soditëse.

### ***Kateheza mbi vuajtjen***

Katehezën për vuajtje duhet mbajtur edhe të sëmurit edhe farefisit, por ndamas. Natyrisht se asnjë person nuk do të merr lirinë që të lutet për vdekjen e qenies së dashur. Të gjithë dëshirojmë që të shërohet. Kjo katehezë duhet t'i nxitë pjesëmarrësit që të luten për përbushjen e vullnetit të Zotit në të sëmurin: qoftë jeta, përmes shërimit të mrekullueshëm, qoftë vdekja, duke lënë paqe të madhe në të gjithë.

Kur personat që i vizitojnë të sëmurët, kufizohen vetëm në lutjen për shërim trupor ose shpirtëror, kurse nuk llogarisin edhe në mundësinë se i sëmuri, për shkak të sëmundjes së rëndë, mund të vdes, nuk i bëjnë mirë as të sëmurit, as farefisit të tij, sepse kështu, njëanësisht shpresojnë se i sëmuri do të shërohet. Nëse ky nuk shërohet, atëherë do të mbushen me dëshpërim dhe ndoshta, me hidhërim ndaj Zotit, i cili, sipas mendimit të tyre, nuk e ka dëgjuar lutjen e tyre.

Njëherë, e kemi vizituar në spital një rregulltare e cila vuante nga kanceri. Pasi ishte fjala për rregulltare, e bindëm lehtë që ta thotë lutjen zemërgjerë. E luti Zotin që të bëjë atë që Ai dëshiron.

Kur erdhi çasti që të thotë: “O Zot, nëse don të

më merr, më jep vdekjen, e nëse don që edhe më tej të jetoj, më jep shëndetin”, ajo tha kështu:

- “O Atë, nuk dëshiroj të jetoj, jam e gatshme të vij tek Ti. Dëshiroj të vdes!” Atëherë i thashë:

- “Motër, ne nuk e dimë ç’ dëshiron Zoti për ju në këtë çast. Luteni që të jetoni, sepse ndoshta, Zoti dëshiron ta lëvdojë Emrin e vet me diçka të mrekullueshme.”

- Atëherë ajo shtoi: “U bëftë vullneti i Zotit!”

Kjo rregulltare u shërua nga kanceri. Kanë kaluar shumë vite nga kjo lutje zemërgjerë, kurse rregulltarja është e shëndoshë.

### ***Duhen paraqitur përvojat personale***

Në takim me të sëmurin është me rëndësi që të paraqitet ndonjë dëshmi për ndonjë shërim që Zoti e ka bërë në jetën tonë, qoftë shpirtëror apo trupor, që ta trimërojmë dhe t’ia forcojmë besimin në Jezu Krishtin.

Dëshmitë që i paraqesim duhen të jenë tonat dhe jo të huajat, sepse duke folur për to, me siguri dhe besim më të madh do t’ia bartim dashurinë që na e ka treguar Zoti. Unë e bëj këtë gjë kur flas për aksidentin e komunikacionit në Panama.

### ***Duhet lexuar Fjalën e Zotit***

Leximi i fragmenteve biblike, në të cilat shihet se Zoti dëshiron të jemi të shëndoshë dhe i atyre në të cilat shihet se si Jezusi i shëron, fizikisht dhe shpirtërisht, të gjithë ata që i afrohen, ndihmon shumë në forcimin e fesë së sëmurit.

Po i përmendim disa fragmente që janë të

përshtatshme për lexim, kur vizitohet i sëmuri:

Dal 15, 23-26; 23, 20. 25;

Nr 21, 4-10;

Lp 7, 12-15;

Ps 103, 3; 107, 17-21;

Is 53, 4-5;

Jer 17, 14;

Mt 4, 23; 8, 16-17; 10, 7-8; 12, 15; 15, 29-31;

Mk 6, 55-56; 16, 15-20;

Lk 4, 16-21; 10, 5-17;

Gjn 10, 10-11; 14, 12-14;

Vap 3, 1-10; 10, 38;

Jak 5, 14-16.

### ***Duhet penduar për mëkatet e bëra***

Fjala e Zotit, me kembgulje kërkon që të pastrojmë zemrën nga çdo mëkat (Sir 38, 10). Apostulli Jakob, gjithashtu përkujton: “Rrëfeni mëkatet njëri-tjetrit dhe lutuni për njëri tjetrin që të shëroheni!” (Jak 5, 16).

Për falje duhet të lutet jo vetëm i sëmuri, por edhe të gjithë ata që luten për të dhe me të. Apostulli Pal, ka theksuar qartë se duhet qenë i pastër në brendësi, ashtu që Zoti të mund të na përdorë si mjet të vetin: “Ai që pastrohet prej këtyre ndyrësive do të jetë enë bujare, e shenjtëruar, e dobishme për zotërinë, e përshtatshme për çdo vepër të mirë” (2 Tim 2, 21).

Nëse në mesin e të pranishëmve është edhe meshtari, atëherë, ai duhet me kujdes ta këshillojë të sëmurin që të rrëfëhet. Nëse kjo gjë nuk është e mundur, atëherë le ta bën aktin e pendimit të përsosur,

me kusht se do të rrëfëhet sapo të ketë mundësi. Për këtë qëllim mund të shërbejë cilado lutje që përmban pendim të sinqertë dhe të përsosur.

Gjithashtu duhet t'u bijmë mohit, konkretisht dhe emër për emër, të gjitha grackave satanike: magjisë, spiritizmit dhe bestytnisë. Duhet t'u bijmë mohit edhe më shumë herë, nëse në ato gracka, kemi ra më shumë herë. Shembull për këtë na ka dhënë vetë Jezusi, kur ia dhe rastin Pjetrit që pasi i ra mohit tre herë, ta dëshmojë tre herë fenë dhe dashurinë e tij (Gjn 21, 15-19).

### ***Shërimi trupor***

Vizita e të sëmurit përfundon me lutjen për shërim trupor. Për këtë më mirë shih kreun VII dhe kreun XI të këtij libri.



## KAPITULLI XIII.

### DISA PREMTIME TË JEZUSIT

Gjatë këtyre viteve, derisa kam vepruar në shërbesën e shërimit, kam pasur mundësi që edhe më thellësisht të kuptoj thelbin e premtimit të Jezusit, drejtuar të gjithëve që besojnë në të: “Lutuni e do t’ju jepet!”

Ekzistojnë shumë persona që , përkundër vullnetit të mirë, nuk i kuptojnë dhe nuk i zbatojnë në mënyrë të drejtë premtimet e Jezusit. Këta, janë të demoralizuar kur nuk marrin përgjigjen e dëshiruar. Feja e tyre shkapërderdhet dhe ata ndihen të mashtruar, sepse besimin e kanë mbështetur në Zotin dhe nuk kanë arritur atë për çka janë lutur.

Mirëpo, problemi është se nuk e kanë kuptuar planin e Zotit dhe thelbin e premtimeve të tij.

#### **Besimi në besnikërinë e tij**

Së pari, Jezusi prej nesh kërkon që tërë besimin tonë ta mbështesim në Të:

“Lëshoja kujdesin tënd Zotit e Ai do të të japë fuqi” (Ps 55, 23).

“Lëshoni në dorën e tij të gjitha kujdeset tuaja, sepse Ai kujdeset për ju!” (1 Pjt 5, 7).

“Tashti, nëse Hyji e vesh kështu barin e tokës, që sot është e nesër qitet në furrë, vallë, a nuk do t’ju vesh më me ëndje ju, o besimpakët? Mos u brengosni, prandaj, duke thënë: ‘Çka do të hamë?’ e ‘çka do të pimë?’ ‘Me çka do të vishemi?’ – këto gjëra i kërkojnë paganët – sepse Ati juaj qiellor e di mirë se ju keni nevojë për të gjitha këto. Kërkoni, pra, më së pari Mbretërinë dhe drejtësinë e tij e të gjitha këto do t’ju jepen si shtesë! Prandaj, mos u brengosni për të nesërmen, sepse e nesërmja do të kujdeset vetë për vete. Secilës ditë i del mjaft pikëllimi i vet!” (Mt 6, 30-34).

Në këtë pjesë Jezusi na quan “besimpakët”, sepse nuk kemi besim të plotë në të. Ky besim është dhuratë dhe rritet sipas rritjes sonë në njohjen e fjalëve të tij. Feja, me fjalë tjera, është pranimi dhe qëndrimi i plotë pranë Fjalës së shpallur të Zotit.

Një ditë, një meshtar më tha: “Kam filluar të besoj se është e vërtetë ajo që Zoti më thotë në Shkrimin Shenjt, se më don porsì fëmijën e vet dhe se më jep premtime të njëjta porsì Birit të vet, Jezusit.”

U çudita nga këto fjalë, se tek tani fillon të besojë. Pastaj vazhdoi:

“Po t’i besoja unë me të vërtetë Fjalës së Zotit, vetëm aq sa u besoj premtimeve njerëzore, do të vdisja nga gëzimi. A dëshiron ende dëshmi se feja jonë nuk është as sa kokrra e sinapit? Megjithatë, ky është mëkati i vetëm për të cilin nuk akuzohemi para Zotit, por jemi të aftë të themi: ‘Unë kam besim të fortë!’ Gëzohemi shumë kur njerëzit na duan, posaçërisht njerëzit e rëndësishëm. Kurse Jezusi na

thotë se Ati i tij na don porsì atë vetë dhe, Ai na don sikurse e don Atin e vet. Ne i dëgjojmë të gjitha këto dhe e vazhdojmë jetën tonë të plogësht. A të befason atëherë kur them se tek tani po filloj të besoj?”

### **Besimi në mëshirën e tij**

“Mirësia jote qoftë mbi ne, o Zot, sikurse ne shpresojmë në ty” (Ps 33, 22).

Rreshti i fundit i këtij psalmi përmban një mësim të mrekullueshëm: sikurse Zoti na falë mëkatet tona ashtu si i falim ne fajtorët tanë, ashtu Ai na shfaqë mëshirën sipas besimit tonë. Këtë kuptim e gjejmë edhe në fjalët e Jezusit: “U bëftë sipas besimit tuaj!” (Mt 9, 29).

Prej këtu rrjedh rëndësia e besimit në mëshirën e Zotit, e cila është fryt i dashurisë së tij ndaj nesh. Është vështirë të besohet në këtë dashuri nëse nuk e njohim Ungjillin. Prandaj shën Gjoni, shprehimisht thotë: ‘Ne e njohëm dashurinë që Hyji ka kundrejt nesh dhe i besuam asaj’ (1 Gjn 4, 16).

Nuk mund të besohet në dashurinë e Zotit nëse më parë nuk e kemi ndier, shijuar dhe njohur këtë dashuri plot hire. Një fjalë e urtë thotë: “Dashuria është në vepra, e jo në fjalë të bukura.”

Nëse një person kurrë nuk pranon dëshmi të dashurisë së ndokujt që thotë se e don, kurrë nuk do të besojë në këtë dashuri të fjalëve boshe. Kurse Zoti na ka dhënë shumë dëshmi të dashurisë së tij:

“Por Hyji e dëftoi dashurinë e vet kundrejt neve kështu: ndërsa ne ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq

për ne” (Rom 5, 8).

Shenjtërit dhe mistikët e Kishës na kanë lënë përvojën e dashurisë dhe mëshirës së Zotit. Shën Tereza e Jezusit, shenjtëresha ime më e dashur, na ka lënë këtë vjershë të mrekullueshme:

ASGJË mos të bezdisë,  
ASGJË mos të frikësojë,  
TË GJITHA kalojnë,  
ZOTI nuk ndryshon.  
ME DURIM arrihen të gjitha:  
KUSH e ka Zotin,  
Asgjë nuk i mungon;  
VETËM Zoti mjafton.

Motra Jozefa Menendez, rregulltare spanjolle që ka vdekur në zë të shenjtërisë, në librin e saj “Thirrja e dashurisë”, na tregon se si më 29 gusht 1923, i është dëftuar Zemra e Krishtit dhe i ka thënë:

“Jozefa, nuk më shkakton më së shumti plagë mëkati, por indiferenca dhe rehatia në të cilën jetojnë mëkatarët pas mëkatit, në vend se të gjejnë strehim në mëshirën time.”

Vetëm ai që e ka shijuar dhe që e ka ndier dashurinë e Zotit duke kërkuar mëshirë prej tij, denjohet të klithë me psalmistin:

“Madhëroje mbi mua dashurinë tënde, ti që i shpëton nga armiku ata që shpresojnë në të djathtën tënde. Më ruaj porsì bebëzën e syrit, më fsheh nën hijen e krahëve të tu” (Ps 17, 7-8).

Vetëm ai që ka ndjenjën se Zoti e don, denjohet të lutet që “Zoti ta ruaj porsì bebëzën e syrit, nën hijen

e krahëve të tij”.

Në aksidentin, tanimë të përmendur, në Panama, pas ndihmës së parë në spitalin e Chorrera-s, na transferuan në spitalin e shën Tomës, në qytetin e Panamasë, ku na dhanë ndihmën e duhur mjekësore. Gjatë udhëtimit më mundonin shumë dyshime për mundësinë që motra ime Luz Helena të mbeste gjallë.

Atëherë më është dukur se e dëgjova një zë të largët që më tha: “Motra jote është e sëmurë rëndë, nuk do të mbijetojë, do të vdes.” Por atëherë e dëgjova një zë tjetër që më tha: “Merri me seriozitet premtimet e Jezusit. Ato kanë të bëjnë me ty. Pranoji tani.”

Ndërsa nga njëra anë më ngacmonte dyshimi, nga ana tjetër mu kujtuan fjalët e apostullit Jakob: “Por le ta kërkojë me fe të gjallë, pa farë dyshimi; sepse ai që dyshon i përngjan valës së detit që e çon peshë era dhe e përplasë. Njeriu i tillë të mos mendojë se do të marrë gjë prej Zotit – njeriu me dy mende, i paqëndrueshëm në të gjitha udhët e veta” (Jak 1, 6-7).

Atëherë me zë të lartë i urdhërova frymës së dyshimit, e qortova dhe i urdhërova që të tërheqet para fuqisë së Gjakut, Plagëve dhe Emrit të shenjtë të Jezusit. Me ne, në autoambulancë, ishin edhe disa mjekë, infermiere dhe disa policë. Kur i hapa sytë, pashë se të gjithë më vështronin me frikë dhe me çudi, sepse mendonin se po flas përçart, për shkak të tronditjes së trurit.

## **Duhet kuptuar seriozisht premtimet e tij**

Duhet kuptuar seriozisht premtimet e Zotit. Kur

premtion Zotit, atë edhe e bën. E vetmja gjë që ne duhet ta bëjmë, ashtu që Ai të veprojë, është ajo që të pranojmë me mirësi këtë veprim, duke mos i vënë kufij ose pengesa planeve të tij.

Mund të na ndihmojë shumë kjo rregull: me plot besim, besojmë në përmbushjen e premtimeve të Zotit, të cilat me siguri do të përmbushen atëherë kur don Zoti, e jo kur dojmë ne. Duhet të mësojmë të ecim hap për hap me Zotin.

Shkrimi Shenjt ka plot shembuj të burrave dhe grave që kanë besuar me shpresë.

### ***Abrahami***

Do të mjaftonte të përmendet ati i fesë tonë, Abrahami, të cilit Zoti ia premtoi birin, por e la të pret shumë kohë para se ia dha me të vërtetë. Kurse pastaj, kërkoi nga ai që ta flijojë dhe Abrahami e dëgjoi, sepse me sigurinë e fesë, e ka ditur se Zoti mundet edhe ta ngjallë. E dimë si ka vepruar Zoti me të: për shkak të këtij akti të besimit, Abrahami është bekuar.

### ***Tre të rinj në furrën e skuqur me zjarr***

Libri i profetit Daniel, në kreun e tretë, na tregon për trimërinë e mrekullueshme të tre të rinjve, të cilët nuk i janë përlur urdhërit të mbretit Nabukodonozor, që t'i përkulen në adhurim trupores së artë, që ky e kishte bërë. Pas kërcënimit se do t'i hedhë në furrën e skuqur me zjarr, ata i përgjigjën: “Në qoftë se Hyji ynë, të cilin e adhurojmë, mund të na shpëtojë nga furra e skuqur me zjarr e nga dora jote, o mbret, Ai do të na lirojë” (Dan 3, 17).

## ***Maria***

Shembull të përsosur për atë se si duket kuptuar seriozisht premtimi i Zotit, na jep Maria, Nëna e Jezusit. Ajo i besoi engjëllit. Besoi në të pamundshmën: se do të bëhet nënë pa u bërë bashkë me njeriun dhe se biri i saj do të jetë Biri i Hyjit. Ajo është e bekuar veçanërisht për atë se ka besuar (Lk 1, 43), gjë që ka arritur kulminacionin kur Biri i saj është kryqëzuar në Kalvar.

## ***Shembuj nga Letra drejtuar Hebrenjve***

Letra drejtuar Hebrenjve në kreun e njëmbëdhjetë, përmend persona të shumtë nga Besëlidhja e vjetër, që kanë shpresuar duke besuar në premtimet e Zotit. Besimi dhe shpresa e tyre në këto premtime ka qenë e tillë, sa që ata kanë vdekur me një siguri se lutjet e tyre janë plotësuar, megjithëse këtë nuk e kanë përjetuar. Kanë qenë të mbushur me gëzim, duke e shikuar tërë këtë prej së largu.

“Të gjithë këta vdiqën në fe pa marrë çka u qe premtuar. Ata vetëm e vërejtën prej së largu dhe e përshëndetën duke pranuar se janë të huaj dhe udhëtarë përmbi tokë” (Heb 11, 13).

Zoti kurrë nuk lejon që dikush ta mundë në zemërgjerësi. Nëse i jepemi në fe, Ai do të na kthejë sipas forcës së fesë sonë dhe do të tejkalojë atë që ne presim prej tij.

## Premtimet dhe shërimi

E tërë Bibla është libër premtimesh për ata që besojnë. Megjithatë, është interesant të vërehet se Jezusi, çkado na ka thënë lidhur me shërimin, në secilin premtim janë të përmbajtura dy elemente:

- i pari që menjëherë vërehet është besimi në Jezu Krishtin: “Ata që do të besojnë”;

- pastaj: fryti i këtij besimi që ka të bëjë me ardhmërinë: “do t’i marrin”, “do t’i vënë duart”, “do të flasin”, “do të shërohen” (krah Mk 16, 17-18).

Jezusi nuk i premtim dikujt se për shkak të fesë do të arrijë menjëherë diçka, drejtpërdrejt, por premtim se “do të fitojë” (në futur). Vërejtja e këtij detaji është me rëndësi të posaçme për të evituar teprimet, fanatizmin dhe rrënimin e fesë.

*“Kush beson në mua, veprat që i bëj unë edhe ai do t’i bëjë. Madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto” (Gjn 14, 12).*

Ky është njëri nga premtimet më të mrekullueshme që Jezusi ia bën atij që ka fe të gjallë. Këtu shihen dy elemente: besimi në Jezu Krishtin dhe efekti që do të realizohet në të ardhmen.

*“Nëse do të më kërkoni ndonjë send në Emër tim, do ta bëj” (Gjn 14, 14).*

Jezu Krishti na premtim se do të dëgjojë dhe do t’i bëjë të gjitha, për çka do të lutemi në emër të tij. Edhe këtu i hasim dy elementet e lartpërmendura.

*“Përnjëmend, përnjëmend po ju them: çdo gjë që t’i kërkoni Atit në emër tim, do t’jua japë” (Gjn 16, 23).*

Në këtë premtim, Jezusi na garantim se Ati do të



na jep (fatur) çdo gjë që kërkojmë (prezent) në emër të Jezusit.

Shën Augustini shtjellon se lutja jonë nuk do të jetë efikase, përderisa nuk e kuptojmë dashurinë e pamasë të Atit ndaj Birit të tij të vetëm, e cila dashuri është në gjendje të realizojë çdo gjë. Ne, në të vërtetë, lutemi në emër të Jezusit të deformuar, i cili nuk është Biri i vërtetë i Hyjit.

“Dhe urata e fesë do ta shpëtojë të sëmurin dhe Zoti do ta ripërtëritë” (Jak 5, 15).

Hyji do ta shpëtojë dhe do ta ripërtëritë të sëmurin dhe, kështu do t’i përgjigj lutjes së fesë.

“Shenjat që do t’i përcjellin ata që do të besojnë, janë këto: në emër tim do t’i dëbojnë djajtë...nëse do të pijnë ndonjë send që sjell vdekjen, nuk do t’u bëjë keq. Do t’i vënë duart mbi të sëmurë, e këta do të shërohen” (Mk 17-18).

Dhuratat me të cilat Zoti i dhuron ata që besojnë, vijnë pas besimit në Jezu Krishtin (krah Rom 10, 17). Edhe këtu janë dy elemente të përbashkëta:

a) besimi në Jezu Krishtin dhe b) efekti në ardhmëri:

“Çkado që të kërkonte me uratë, besoni se e morët, e do ta fitoni me siguri” (Mk 11, 24).

Feja e gjallë që nuk luhetet në zemër, është e suksesshme dhe efikase. Marku na tregon se si Jezusi i qortoi ashpër nxënësit sepse janë të pafë (Mk 9, 19). Ai është plotësisht i qartë sa i përket lutjes, sepse kërkon që tani të besohet dhe me këtë kusht “do t’ju jipet!” Prej nesh kërkon aktin e fesë sipas të cilit do të jemi të bindur se kemi pranuar atë për çka jemi

lutur dhe kështu do të bëhet. Kur dhe si, për këtë do të vendosë Ai. Vetë na e shpjegon këtë premtim:

“Duke e ditur se na e plotëson uratën për gjithçka kërkojmë, atëherë e dimë se i kemi ato që i kërkuam prej tij, shi ashtu si t’i kishim në dorë” (1 Gjn 5, 25).

Kurse Psalmi 37 thotë: “Vëre gëzimin tënd në Zotin e ai do t’i plotësojë dëshirat e zemrës sate” (Ps 37, 4).

Sikur në të gjitha premtimet e mëparshme, këtu lajmërohen dy elemente të përbashkëta: besimi në Jezu Krishtin dhe efekti në ardhmëri.

### **Feja – karizmë dhe feja – virtyt**

Njëherë, kam qenë i pranishëm gjatë një lutjeje për të sëmurë. Personi që e udhëheqte lutjen iu afrua personit të sëmurë që ishte në karrocë invalidësh dhe i tha: “Në emër të Jezu Krishtit, aleluja! Ngritu, aleluja! Mu tani, aleluja!” Këtë e përsëriti disa herë dhe gjithnjë me zë më të lartë. Ndërkohë populli bërtiste, qante dhe e detyronte të sëmurin që të ngritet dhe të ecë. Histeria ishte kolektive. Atëherë, udhëheqësi i lutjes, duke e shikuar të sëmurin, e pyeti:

- *“Përse nuk ecë?”*

- I sëmuri iu përgjigj:

- *“Nuk di. Dëshiroj, por nuk mundem!”*

Besoj se nganjëherë vjen deri te teprimet e tilla, sepse ekzistojnë persona që besojnë se mund të bëjnë atë që kanë bërë Gjoni dhe Pjetri, të cilët, me një urdhër të thjeshtë, e shëruan çalamanin para “derës së Tempullit” (Vap 3).

Shumë njerëz nuk e dallojnë karizmën e fesë dhe virtytin e fesë. Karizma e fesë është hir i Zotit, të cilin Zoti e jep në momentin e caktuar për një qëllim të caktuar.

*Karizma e fesë* vjen, vepron dhe kalon. Kjo është siguria dhe qetësia që i ndijmë kur duhet vepruar në emër të Jezusit në momentin dhe rastin e caktuar. Këtë hir, Zoti e jep në mënyrë diskrete dhe të jashtëzakonshme. Nëse dëshirojmë të shërbehemi me të, kurse nuk e kemi pranuar nga Zoti, mund të shkaktohet dëm i madh. Karizma e fesë është më e njohur me termin feja aktuale.

*Virtyti i fesë*, feja habituale, siç na thotë vet emri, është feja që qëndron në personin, kurse pranohet në pagëzim dhe zhvillohet gjatë tërë jetës, përmes veprave të mira dhe veprimtarisë fetare. Ky është virtyti i fesë. Mendoj se Jezusi ka folur për virtytin e fesë atëherë kur ka kërkuar nga njerëzit që të besojnë në Të. Njëherë, apostujt e pyetën Jezusin, se çka duhet të bëjnë për t'i kryer veprat që i kërkon Hyji. Ai përgjigji:

*“Vepra që Hyji kërkon është kjo: besoni në Atë që Ai e dërgoi” (Gjn 6, 29).*

Ajo që Ati dëshiron të bëjmë është vepra në mënyrën më të theksuar: besimi në të dërguarin e Tij, në Jezu Krishtin.

### *Përfundim*

Jemi të ftuar që të jemi të shenjtë dhe të papërllyer në praninë dhe dashurinë e tij. Këtu qëndron shërimi i përsosur dhe ç'është më e mira, mund të jemi mjet përmes të cilit, të njëjtin do ta marrin edhe të tjerët.

Jezu Krishti ka ardhur që të shërojë. Ai këtë e bën tanimë dymijë vite dhe vazhdon të shërojë gjithkund, anekënd botës. Unë jam dëshmitar se Ai i shëron të sëmurët edhe sot.

*LAVDI I QOFTË EMRIT TË TIJ!*

\*\*\*\*\*

*Kushdo që me leximin e këtij libri merr ndonjë bekim nga Hyji, mund t'ia kumtojë të njëjtin autorit në këtë adresë:*

*Dario Betancourt  
86-29 55<sup>th</sup> Avenue Elmhurst  
N. Y. 11373-4338  
USA*

# PËRMBAJTJA

Parathënie

Hyrje

## **I. Zoti dëshiron që të jemi të shëndoshë**

1. Besëlidhja e Vjetër
2. Besëlidhja e Re
3. Mjekët

## **II. Vuajtja dhe vdekja**

Vizioni i Gjonit Palit II

Sherimi me dashuri (terapia me dashuri)

Gëzimi në vuajtje

Tre qëllime të vuajtjes

A thua Zoti dëshiron që ne të vuajmë

Vdekja

## **Katër hapa deri në shërim**

1. Mbështetja në Zotin
2. Pendesa
3. Kushtimi i flive
4. Kërkimi i ndihmës mjekësore

## **Falja shëron**

1. Ç' është falja?
2. Çka nuk është falja?
3. Tri falje
4. Disa udhëzime praktike për falje
5. Hapat që duhen ndërmarrur për falje
6. Të falim që të shërohemi
7. A kemi me të vërtetë armiç?

## **Lutja për falje**

### **Banja me dritë**

1. Ç' është ajo?
2. Dallimi në mes banjës me dritë dhe sherimit të brendshëm
3. Tekstet Biblike
4. Si bëhet kjo gjë
5. Të shkruajmë në vend se të flasim
6. Sa herë
7. Efektet

### **Lutja zemërgjerë**

1. Ç' është lutja zemërgjerë
2. Themelet biblike
3. Dëshmitë

### **“Terapia” me lutje**

1. Aftësia e të degjuarit
2. Shembulli i Jezusit
3. Dëshmitë

Fjala e të njohurit

Ç' është fjala e të njohurit (dijes)

Emri tjetër i kësaj dhuratë

Si vërehet kjo dhunti

Kur duhet shfrytëzuar këtë

Si të njihet autenticiteti i dhuntisë

Themeli biblik

Dhurata e urtisë

Dëshmitë

### **Si shëron Zoti?**

1. I shfrytëzon mjetet që gjenden në ne
2. Zoti shfrytëzon mjetet që janë jasht nesh

3. Zoti shëron edhe drejtpërdrejt pa perdorim të mjeteve

### **A mund të shërojë djalli?**

Egzistmi dhe fuqia e djallit

Magjistarët dhe falltarët nuk e flasin të vërtetën

Zoti na paralajmëron që të kemi kujdes

Ndëshkimi për magjistarët dhe spiritistët

Lutja për të vdekurit

Lirimi dhe shërimi

Emri i Jezusit

Kongregata e shenjtë për mësim të fesë

Gjërat që sjellin fat

### **Si duhet lutur për shërim?**

1. Lutja për shërim të brendshmëm

2. Lutja për shërim trupor(fizik)

### **XII. Si duhet vizituar të sëmurët?**

1. Shërbesa në spital

2. Shërbesa në familjen e të sëmurit

3. Shërbesa të sëmurit

### **XIII. Disa premtime të Jezusit**

1. Besimi në besnikërinë e Tij

2. Besimi në mëshirën e tij

3. Duhet kuptuar seriozisht premtimet e tij

4. Premtimet dhe shërimi

5. Feja – karizma dhe feja – virtyt

\* \* \* \* \*

*Ati Dario Betancourt u lind në Medellin (Kolumbi), më 1939. Studimet teologjike i mbaroi në Romë ku edhe u doktorua në teologjinë morale. Në New York u doktorua në psikologji.*

*Mban shumë kurse dhe seminare të përshtirtshmërisë, anëmbanë botës katolike, posaçërisht për mjekët dhe anëtarët e Ripërtëritjes së Shpirtit.*

*Ati Dario posedon karizmën e shërimit dhe flet nga përvoja e vet personale: “Pashë, dëgjova, preka atë për çka shkruaj”. Ai e din nga përvoja se Zoti edhe sot shëron. Në bazë të kësaj përvoje, ai vjen deri në përfundimin se Zoti nuk e dëshiron as sëmundjen as vuajtjen tonë. Mirëpo, kur sëmundja, tanimë, është këtu, në rrjedhën e tanishme të historisë, ajo do të duhej të na shërbejë për pastrimin dhe rritjen tonë, zatën për lavdërimin e Zotit.*